

IRZ



Makavej, 2016



Republic of Macedonia
Ministry of Justice
Republika e Maqedonisë
Ministria e Drejtësisë

FONDACIONI GJERMAN PËR
BASHKËPUNIM NDERKOMBËTARË
JURIDIK



Publikationen zur rechtlichen Zusammenarbeit 2016

1992

1997

2002

2007

2012

2016

Buletini i praktikës gjyqësore të GJEPD

Publikationen
zur rechtlichen Zusammenarbeit

Buletini i praktikës gjyqësore të
Gjykatës Evropiane për të drejtat e
njeriut

botuar nga
Enti për përfaqësim të Republikës së
Maqedonisë para GJEPD
dhe
Fondacioni gjerman për bashkëpunim
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e
regjistruar (IRZ)

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2016

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 7 – 50)

Behar Dalipi (faqe 50 – 71)

Koordinimi i redaksisë së edicionit në gjuhën shqipe: Dr. Shtefan Pirner, avokat dhe mr. Kostadin Bogdanov, v.d. Drejtor i Entit për përfaqësim të RM-së para GJEDNJ – Agjent i Qeverisë.

Bashkëpunimi i redaksisë së edicionit në gjuhën shqipe: Dragana Radisavlleviq, jurist i diplomuar me provimin e dhënë të judikaturës dhe Dana Trajçev – Bozhiq, V.A., studime për media dhe komunikime.

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ndërkombëtarë juridik, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Përmbajtja

I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

<i>Helhal kundër Francës</i> - 10401/12 Vendim 19.2.2015 (Seksioni V)	7
<i>Identoba dhe Të tjerë kundër Gjeorgjisë</i> - 73235/12 Vendimi 12.5.2015 (Seksioni IV)	8
<i>Mehdiyev – Azerbajjan/Azerbaxhan</i> - 59075/09 Vendimi /Arrkt 18.6.2015 (Seksioni I)	11
<i>S.Z. kundër Bullgarisë</i> - 29263/12 Vendimi 3.3.2015 (Seksioni IV)	12
<i>Gallardo Sanchez kundër Italisë</i> - 11620/07 Vendimi 24.3.2015 (Seksioni IV)	14
<i>Bochan kundër Ukrainës (nr 2)</i> - 22251/08 Vendimi 5.2.2015 (GC)	15
<i>Zavodnik kundër Sllovenisë</i> - 53723/13 Vendimi 21.5.2015 (Seksioni V)	18
<i>Volkov dhe Adamskiy kundër Rusisë</i> -7614/09 dhe 30863/10 Vendimi 26.3.2015 (Seksioni I).....	20
<i>Kapetanios dhe të tjerë kundër Greqisë</i> - 3453/12, 42941/12 dhe 9028/13 Vendimi 30.4.2015 (Seksioni I)	21
<i>Rohlena kundër Republikës Çeke</i> - 59552/08 Vendimi 27.1.2015 (GC)	23
<i>Dzhugashvili kundër Rusisë</i> - 41123/10 Vendimi 9.12.2014 (Seksioni I)	25
<i>Vinci Construction dhe GTM Génie Civil et Services kundër Francës</i> - 63629/10 dhe 60567/10 Vendimi 2.4.2015 (Seksioni V)	26
<i>Apostu kundër Rumanisë</i> - 22765/12 Vendimi 3.2.2015 (Seksioni III)	28
<i>Penchevi kundër Bullgarisë</i> - 77818/12 Vendimi 10.2.2015(Seksioni IV)	29
<i>Dragojević kundër Kroacisë</i> - 68955/11 Vendimi 15.1.2015(Seksioni I)	30

Fuchs kundër Gjermanisë - 29222/11 dhe 64345/11 Vendimi 27.1.2015 (Seksioni V)	31
Delfi AS kundër Estonia - 64569/09 Vendimi 16.6.2015 (GC)	32
Guseva kundër Bullgarisë - 6987/07 Vendimi 17.2.2015 (Seksioni IV)	34
Morice kundër Francës - 29369/10 Vendimi 23.4.2015 (GC)	35
Kuppinger kundër. Gjermanisë - 62198/11 Vendimi 15.1.2015 (Seksioni V)	40
S.L. dhe J.L. kundër Kroacisë - 13712/11 Vendimi 7.5.2015 (Seksioni I).....	41
Neshkov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë - 36925/10 et al. Vendimi 27.1.2015 (Seksioni IV)	43
Razzakov kundër Rusisë - 57519/09 Vendimi 5.2.2015 (Seksioni I)	46
Varga dhe të tjerët kundër Hungarisë - 14097/12 et al. Vendimi 10.3.2015 (Seksioni II)	48

II. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Ilievska kundër Republikës së Maqedonisë - 20136/11 (Vendimi 7.5.2015 Seksioni I)	49
Nikolova kundër Republikës së Maqedonisë , 31154/07 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 21 maj të vitit 2015)	50
Eftimov kundër Republikës së Maqedonisë , 59974/08 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 2 korrik të vitit 2015)	51
Andonovski kundër Republikës së Maqedonisë , 24312/10, (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 23 korrik të vitit 2015)	54
Andonoski kundër Republikës së Maqedonisë , 16225/08 (aktgjykimi i datës 17.09. të vitit 2015)	58

<i>Mitkova kundër Republikës së Maqedonisë</i> , 48386/09 (aktgjykimi i datës 15.10. viti 2015)	60
<i>Hajrullahu kundër Republikës së Maqedonisë</i> , 37537/07 (aktgjykimi i datës 29.10. të vitit 2015)	64
<i>Asllani kundër Republikës së Maqedonisë</i> , 24058/13 (aktgjykimi i datës 10.12. viti 2015)	67

I. AKTGJYKIME MË TË REJA TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NENI 3

Trajtimi poshtëruës

Mungesa e fizioterapisë dhe e aksesit të përshtatshëm tek mjetet sanitare për të burgosurin me paaftësi të theksuar: *shkelje*

Helhal kundër Francës - 10401/12 Vendim 19.2.2015 (Seksioni V)

Faktet – Kërkuesi, i cili qysh nga viti 2006 është i sëmurë paraplegjik në gjymtyrët e poshtme dhe nga inkontinenca e dyfishtë, tashmë po vuan një dënim tridhjetë-vjeçar me heqje lirie. Në gusht të vitit 2010, ai bëri kërkesë tek gjyqtari përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve për pezullimin e dënimit të tij për arsye mjekësore. Ai u ankua që mjediset e burgut nuk ishin të përshtatshme për paaftësinë e tij, ku si rezultat ai jo vetëm nuk mund të lëvizte me karrige me rrota, por ai duhej edhe të ndihmohej për të bërë dush nga një i burgosur tjetër i caktuar atij për këtë qëllim, dhe se fizioterapia që ai merrte nuk ishte e përshtatshme. Në shkurt të vitit 2011, gjykata përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve e refuzoi kërkesën e tij, duke marrë parasysh edhe dy ekspertiza mjekësore pohuese, që gjendja shëndetësore e kërkuesit e duronte burgimin. Megjithatë, gjykata vuri re që ai burg nuk ishte i përshtatshëm për nevojat e të burgosurit dhe që ekzistonin institucione të tjera që do të ishin të pajisura më mirë për ta sistemuar atë. Ankimet e paraqitura nga kërkuesi ndaj vendimit u refuzuan.

Ligji – Neni 3. Meqenëse kërkuesi kishte një paaftësi që e detyronte atë në një masë të madhe të përdorte karrigen me rrota – megjithëse ai ndonjëherë mund të ecte me ndihmën e shkopinjve ose një strukture ndihmëse – ankesat e tij u shqyrtuan në dritën e parimeve që rregullojnë detyrimin e Shtetit të tregonte kujdes për individët me paaftësi, duke patur parasysh pamundësinë e tyre kur bëhej fjalë për të kaluar vështirësitë e ndalimit. Në lidhje me cilësinë e kujdesit të dhënë kërkuesit gjatë ndalimit, dhe veçanërisht çështjen nëse autoritetet vendase kishin bërë gjithçka që mund të pritej normalisht prej tyre për t'i ofruar atij një trajtim rehabilitues që i duhej atij dhe t'i jepej atij një mundësi përmirësimi të gjendjes së tij, asnjë lloj fizioterapie nuk i ishte dhënë në burg në tre vite. Gjatë gjithë asaj periudhe, asnjë masë specifike nuk ishte marrë dhe asnjë përpjekje nuk ishte bërë që ti mundësohej kërkuesit të merrte seanca fizioterapie të përshtatura me gjendjen e tij, megjithë rekomandimet e vazhdueshme të mjekut që ai ishte trajtuar në një kontekst të specializuar. Qëndrimi i kërkuesit, i cili kishte hezitur të kërkonte një

transferim për shkak të distancës me familjen e tij, nuk ishte i mjaftueshëm për të justifikuar mosveprimin e autoriteteve të burgut dhe kujdesit shëndetësor.

Në lidhje me kushtet e ndalimit dhe aksesin tek mjediset sanitare, dhe veçanërisht dushet, kërkuesi nuk ishte në gjendje të shkonte tek këto mjedise pa ndihmë, meqenëse ato nuk ishin brenda qelisë, dhe nuk mund të shkohej me karrige me rrota. Për më tepër, në lidhje me gjendjen e kërkuesit, i burgosuri që ishte caktuar për ta ndihmuar atë me detyrat e përditshme duhej ta ndihmonte të lahej, një situatë e cila konsiderohej e papranueshme nga Inspektori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Megjithëse legjislatori kishte parashikuar në vitin 2009 që të gjithë të burgosurit me paaftësi të caktonin një kujdestar sipas zgjedhjes së tyre, një masë e tillë - megjithëse në rastin konkret mendohej që kriteret përkatëse të ishin përmbushur – nuk ishte e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e kërkuesit, i cili e kishte bërjen e dushit të vështirë për shkak të inkontinencës së tij, mungesës së privatësisë dhe faktit që një i burgosur tjetër kishte detyrën për ta ndihmuar atë. Kjo ndihmë nuk jepej si shtesë ndaj kujdesit të dhënë nga profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe i burgosuri i caktuar për të ndihmuar kërkuesin nuk kishte marrë trajnimin e kërkuar për të ndihmuar një person që vuan nga paaftësia. Në këtë kontekst, Gjykata kishte konstatuar në shumë raste që atje ku jepej ndihmë, edhe në mënyrë të vullnetshme, nga një i burgosur tjetër, kjo nuk do të thoshte që nevojat e veçanta të kërkuesit ishin përmbushur ose që Shteti kishte përmbushur detyrimet e tij në këtë aspekt sipas Nenit 3 të Konventës. Përfundimisht, ndërsa vazhdimi i mbajtjes së kërkuesit të ndaluar nuk ishte në papajtueshmëri me Nenin 3 të Konventës, autoritetet vendase nuk i kishin ofruar atij ndihmën e kërkuar për ta mbrojtur atë nga trajtimi në kundërshtim me atë dispozitë. Në lidhje me paaftësinë e tij të rëndë dhe faktin që ai ishte me inkontinencë të dyfishtë, afati kohor që ai kishte kaluar i ndaluar pa asnjë trajtim rehabilitues, në një institucion ku ai mund të bëjë dush vetëm me ndihmën e një të burgosuri tjetër, e kishte vendosur kërkuesin në një vështirësi që e kalon nivelin e paevitueshëm të vuajtjes shpirtërore gjatë ndalimit. Ato rrethana sillnin si pasojë trajtimin poshtëruës në shkelje të Nenit 3. Fakti që nuk ka patur asgjë që mund të tregonte që autoritetet kishin vepruar me synimin e poshtërimit ose uljes së kërkuesit nuk ka asnjë efekt në ndryshimin e atij konstatimi.

Përfundimi: shkelje (njëzëri)

Neni 41: 7.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Detyrime pozitive (aspekti lëndor / aspekti procedural)

Dështimi i shtetit në mbrojtjen e demonstruesve nga dhuna homofobike dhe në fillimin e hetimit të efektshëm: *shkelje*

Identoba dhe Të tjerë kundër Gjeorgjisë - 73235/12 Vendimi 12.5.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Kërkuessit ishin një organizatë jo-qeveritare e ngritur për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njerëzve lesbikë, gei, biseksualë dhe transgender (LGBT) në Gjeorgji dhe 14 individë. Më 17 maj 2012, në Tbilisi u zhvillua një demonstratë paqësore për të shënuar Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, e organizuar nga kërkuessi i parë dhe u ndoq nga afërsisht 30 njerëz, duke përfshirë 13 kërkuess individualë. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit LGBT gjatë marshimit u ofenduan, u kërcënuan dhe u sulmuan nga një grup më i madh kundër-demonstruesish të cilët ishin anëtarë të dy grupeve fetare. Policia eventualisht arrestoi katër nga kërkuessit dhe i ndaloi ata për kohësisht dhe/ose i transportoi në automjetet e policisë, duke pretenduar mbrojtjen e tyre nga kundër-demonstruesit. Pas këtyre ngjarjeve, kërkuessit bënë shumë kallëzime penale, duke kërkuar veçanërisht që hetimet penale të filloheshin në lidhje me sulmet e kundër-demonstruesve ndaj tyre, të cilat ishin kryer me synime diskriminuese, dhe në lidhje me veprimet ose mosveprimet e punonjësve të policisë, të cilët dështuan në mbrojtjen e tyre nga sulmet. Dy hetimet në lidhje me dëmet e pësuar nga dy kërkuess u filluan në vitin 2012 dhe nuk u përfunduan.

Ligji – Neni 3 i lexuar në lidhje me Nenin 14 (kërkuessit nga i dyti tek i katërmbëdhjeti)

(a) *Nëse sulmi mbi kërkuessit arriti pragun minimal të ashpërsisë sipas Nenit 3 të marrë në lidhje me Nenin 14 të Konventës* – Në vlerësimin e incidentit, Gjykata pati parasysh situatën delikate në të cilën u gjendën personat LGBT në Shtetin e akuzuar në momentin e sulmeve dhe raportet e ndryshme që dokumentonin qëndrimet negative ndaj anëtarëve të komunitetit LGBT që mbizotërojnë në disa pjesë të shoqërisë gjeorgjiane. Kundrejt këtij sfondi, Gjykata fillimisht vuri re që gjatë marshimit kërkuessit ishin rrethuar nga një turmë e egërsuar që ishte më i madh se numri i tyre dhe që kishin shprehur kërcënime me vdekje dhe në disa raste ishin zbatuar edhe dhunë fizike ndaj tyre. Kjo sjellje ishte e motivuar nga një paragjykim i qartë homofobik, i demonstruar nga gjuha tepër ofenduese dhe kërcënuese e përdorur nga dy grupet fetare dhe nga aktet e rrëmbimit të flamujve dhe posterave LGBT të pasuara nga sulmet faktike fizike ndaj disa kërkuessve. Qëllimi i këtij abuzimi verbal dhe fizik ishte dukshëm frikësimi i kërkuessve në mënyrë që ata të hiqnin dorë nga shprehja publike e tyre për mbështetjen ndaj komunitetit LGBT. Ndjenja e dhimbjes e kërkuessve duhet të jetë përkeqësuar nga fakti që mbrojtja policore e cila iu ishte premtuar atyre para marshimit nuk iu ofrua në kohën e duhur ose si duhet. Kjo dhunë e kishte çuar frikën, ankthin dhe pasigurinë e përjetuar nga të 13 kërkuessit deri në atë pikë sa të arrinte pragun përkatës sipas Nenit 3 i lexuar në lidhje me Nenin 14 të Konventës.

(b) *Nëse autoritetet u kishin dhënë mbrojtjen e duhur kërkuessve* – Qysh nga momenti kur organizatori i marshimit kishte paralajmëruar specifikisht policinë në lidhje me mundësinë e abuzimit, autoritetet ligj-zbatuese ishin nën detyrimin e fortë pozitiv për të mbrojtur demonstruesit nga dhuna. Megjithatë, punonjësit e policisë ishin të pranishëm tek demonstrata vetëm në numër të kufizuar dhe ishin distancuar pa paralajmërim paraprak nga skena kur filluan sulmet verbale, duke lejuar kështu që tensioni të degjeneronte në dhunë fizike. Në momentin kur ata përfundimisht

vendosën të ndërhyjnë, kërkuesit ishin ngacmuar, ofenduar ose sulmuar. Për më tepër, në vend që të fokusoheshin në kufizimin e kundër-demonstruesve agresivë me synim lejin e vazhdimit të protestës paqësore, ndërhyrja e vonuar e policisë kishte kaluar në arrestimin dhe evakuimin e disa kërkuesve, pikërisht viktimat që ata kishin dalë të mbronin. Në këtë mënyrë, autoritetet vendase kishin dështuar në dhënien e mbrojtjes së përshtatshme për kërkuesit nga sulmet e individëve privatë gjatë marshimit.

- (c) *Nëse për këtë incident është zhvilluar një hetim i efektshëm* – Autoritetet nuk kishin përmbushur gjithashtu detyrimin e tyre procedural për të hetuar atë që kishte ndodhur gjatë incidentit të datës 17 maj 2012, duke theksuar veçanërisht zbulimin e paragjykimet si një motiv dhe identifikimin e personave përgjegjës. Megjithë ankesat e përsëritura të bëra nga kërkuesit menjëherë pas incidentit, në lidhje me trajtimin e tyre të parregullt dhe mosveprimin e pretenduar të policisë, autoritetet vendase nuk kishin filluar asnjë hetim të plotë dhe të qenësishëm në rrethanat në lidhje me incidentin për sa u takon të gjithë kërkuesve. Në vend të kësaj, ato kishin ngushtuar në mënyrë të pakuptimtë objektin e hetimit në dy raste të veçanta në lidhje me dëmtimet fizike të shkaktuar në vetëm dy kërkues të veçantë dhe që kishin përfunduar vetëm me sanksione administrative për dy kundër-demonstrues me gjobë për rreth 45 Euro secili. Kjo nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve procedurale të Shtetit sipas Nenit 3, duke patur parasysh nivelin e dhunës dhe agresionit ndaj kërkuesve.

Në këto rrethana ishte e domosdoshme që autoritetet e brendshme të ndërmerren të gjitha hapat e arsyeshme të zbulonin të gjitha motivet e mundshme homofobike për aktivitetin në fjalë. Në mungesë të një hetimi të tillë të qenësishëm nga autoritetet ligjzbatuese, krimet e motivuara nga paragjykimet do të trajtoheshin në mënyrë të paevitueshme në të njëjtën shkallë si dhe çështjet e zakonshme pa patur këto ngjyime, dhe indiferenca përkatëse do të ishte e njëjtë më njohjen zyrtare ose edhe me miratimin heshturazi të krimeve të urrejtjes. Për më tepër, do të ishte e vështirë që Shteti i akuzuar të zbatonte masat që synonin përmirësimin e ruajtjes policore të demonstratave të ngjashme paqësore në të ardhmen, duke minuar kështu besimin publik në politikën antidiskriminuese të Shtetit. Nën dritën e këtyre konsideratave, autoritetet vendase kishin dështuar në kryerjen e një hetimi të përshtatshëm në pretendimet e trembëdhjetë kërkuesve për keqtrajtim.

Përfundim: shkelje (gjashtë vota me një).

Gjykata konstatoi gjithashtu një shkelje të Nenit 11 të lexuar në lidhje me Nenin 14 që Shteti i akuzuar, në shkelje të detyrimeve të tij pozitive, nuk mundi të garantojë që marshimi i datës 17 maj 2012 të zhvillohej paqësisht duke kufizuar në masën e mjaftueshme kundër-demonstruesit homofobikë dhe të dhunshëm.

Neni 41: shumat brenda gamës nga 1.500 Euro deri në 4.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Mosmarrja e masave në përgjigje të ankimeve në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar të një gazetare: shkelle

Mehdiyev – Azerbajjan/Azerbaxhan - 59075/09 Vendimi /Arrkt 18.6.2015 (Seksioni I)

Faktet – Në vitin 2007 kërkuesi, një gazetar, publikoi dy artikuj kritikë në lidhje me situatën në Republikën autonome të Nakhchivanit (NAR). Ngjarjet pasuese janë të debatueshme. Sipas kërkuesit, më 22 shtator 2007, kreu i departamentit të rrethit të Ministrisë së Sigurisë Kombëtare (MNS) e akuzoi atë për publikimin e artikujve shpifës, he pas kësaj ai u arrestua dhe u shoqërua në mjediset e MNS-së ku ai u godit me shkelma dhe grushte nga shumë punonjës të MNS-së. Pas lirit të tij, në orën 2 të ditës pasuese, ai njoftoi menjëherë gazetën në lidhje me arrestimin e tij. Meqenëse ishte shumë herët dhe nuk mund të vizitohej tek ndonjë mjek, ai u kërkoi të afërmeve që të bënin fotografi të dëmtimeve të tij trupore. Më vonë atë mëngjes ai u ri-arrestua nga policia e cila donte të dinte se pse kishte njoftuar shtypin në lidhje me arrestimin e tij. Sipas Qeverisë, kërkuesi u arrestua për shkak se kishte qenë i zhurmshëm dhe kishte përdorur gjuhë abuzive me policinë. Më vonë gjatë asaj dite, një Gjykatë Rrethi e dënoi kërkuesin me pesëmbëdhjetë ditë ndalimi administrativ për pengim të punës së policisë. Pastaj ai u vizitua nga një mjek por nuk iu dha raport mjekësor. Sipas kërkuesit, atij nuk iu dha ushqim dhe ujë dhe nuk iu dha as edhe shtrat gjatë ndalimit të tij. Ai u detyrua të kalonte natën jashtë në trotuarin prej betoni, mbahej gjithmonë me pranga dhe vuante shumë nga pickimet e mushkonjave. Më 27 shtator 2007, ai u lirua dhe u trajtua në spital, por nuk iu dha ndonjë certifikatë mjekësore zyrtare. Kërkuesi paraqiti një raport mjekësor të pafirmosur me datë 1 tetor 2007, i cili bën të ditur që ai kishte një brinjë të thyer, por nuk jepte asnjë informacion tjetër.

Më 3 tetor 2007, kërkuesi bëri një kallëzim penal në Zyrën e Prokurorit të Rrethit në mbështetje të Neneve 3, 5 dhe 10 të Konventës. Më vonë ai paraqiti ankime të tjera tek Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe tek Ombudsmeni, Gjykatën e Rrethit, Gjykatën e Lartë të NAR-it, Gjykatën e Lartë të Azerbaxhanit dhe Këshillin Ligjor Gjyqësor. Megjithëse ai u informua që ankimet e tij i ishin paraqitur autoritetit kompetent hetimor, nuk u mor asnjë masë.

Ligji – Neni 3 (*aspekte procedurale*): Gjykatës iu kërkua të përcaktonte nëse autoritetet e brendshme kishin dështuar të zhvillonin një hetim zyrtar të efektshëm në lidhje me një pretendim të bazuar të keqtrajtimit nga policia në shkelle të Nenit 3. Ajo vuri re qysh në fillim që ankesat që kërkuesi i kishte paraqitur tek organet e brendshme nuk kishin sjellë për pasojë hetime penale dhe nuk ishte ndërmarrë asnjë masë nga gjykatat e brendshme edhe pse ishte dhënë informacion i mjaftueshëm në lidhje me identitetin e kundërvajtësve të akuzuar dhe datën, vendin dhe natyrën e keqtrajtimit të pretenduar. Kërkuesi kishte një pretendim të bazuar që të kërkonte që autoritetet të zhvillonin një hetim të efektshëm në pretendimet e tij.

Megjithë informacionin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme që ankimet e kërkuarit i ishin paraqitur autoriteteve hetimore për shqyrtim, asnjë hetim penal nuk u fillua.

Autoritetet e ndjekjes penale nuk kishin urdhëruar vizitën mjekësore të kërkuarit dhe nuk e kishin dëgjuar kërkuarin, kundërvajtësit e akuzuar për keq-trajtim ose ndonjë dëshmitar tjetër të mundshëm. Përfundimisht, Qeveria nuk kishte dhënë asnjë shpjegim për mos-zhvillimin e një hetimi. Për pasojë, nuk ka patur hetim të efektshëm në pretendimin e kërkuarit për keq-trajtim.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 3 (*aspekti lëndor*): Në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar të kërkuarit nga punonjësit e MNS-së, Gjykata duhej të vlerësonte nëse akuzat e tij mbështeteshin nga prova të përshtatshme. Kërkuari kishte paraqitur një përshkrim të hollësishëm të keqtrajtimit të tij, fotografi të marra nga familja e tij që thuhet se ishin drejtpërdrejt pas lirimimit nga ndalimi i tij dhe një raport mjekësor i panënshkruar i datës 1 tetor 2007. Megjithatë, këto prova nuk ishin të mjaftueshme që Gjykata të përcaktonte “te j çdo dyshimit të arsyeshëm” që kërkuari i ishte nënshkruar trajtimit të pretenduar nga punonjësit e shtetit.

Përfundimi: nuk ka shkelje (gjashtë vota me një).

Gjykata ishte e mendimit, në raportin gjashtë vota me një, që nuk ka patur shkelje të Neneve 5 dhe 10 të Konventës.

Neni 41: 10.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar refuzohet.

Hetimi i efektshëm

Vonesat e panevojshme në çështjet penale dhe moshetimi i duhur i akuzave për përdhunim dhe sulm fizik: *shkelje*

S.Z. kundër Bullgarisë - 29263/12 Vendimi 3.3.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Në shtator të vitit 1999 kërkuarja e çuan tek një apartament dhe e mbajtën kundër vullnetit të saj; u rrah dhe u përdhunua në mënyrë të përsëritur nga disa burra para se të mund të arratisesh.

Prokuroria nisi një hetim penal. Kërkuarja identifikoi disa prej keqtrajtuarëve të saj dhe dy punonjësit e policisë që ata thuhet se e kishin takuar para se ta mbanin atë kundër vullnetit të saj. Hetimi u mbyll katër herë dhe çështja u kthye për hetim të mëtejshëm për shkak se nuk ishin marrë masat e nevojshme hetimore ose që ishin kryer parregullsi procedurale. Në vitin 2007, shtatë të pandehur u çuan për gjykim në Gjykatën e Rrethit në lidhje me akuzat e burgosjes së paligjshme, përdhunimit, nxitjes së prostitucionit ose

rëmbim për qëllime të detyrimit me dhunë për ushtrim prostitucioni. U zhvilluan njëzet e dy seanca, dhjetë prej të cilave u shtynë për shkaqe të parregullsive në thirrjen e të akuzuarve ose dëshmitarëve. Në një vendim të marsit 2012, pesë nga të akuzuarit u dënuan dhe iu nënshtruan vendimeve me burgim dhe gjoba, një u shpall i pafajshëm, dhe gjykimi ndaj të pandehurit të shtatë u ndërpre për shkak se ishte parashkruar. Të pesë të akuzuarit të cilët u dënuan dhe kërkuesja bënë ankim. Shtatë seanca para Gjykatës Rajonale u shtynë për shkak të mungesës së një prej të akuzuarve ose të avokatëve të tyre. Në një vendim përfundimtar të shkurtit 2014, gjykata shfuqizoi një prej dënimeve të fajësisë dhe ndërpreu gjykimin për shkak të parashtrimit. Dënimet me burgim për disa prej të akuzuarve u ulën.

Ligji – Neni 3 (*aspekti procedural*): Veprimet e përdhunimit dhe sulmit fizik të ushtruar mbi kërkuesen përfshiheshin në objektin e Neni 3 të Konventës. E gjithë kohëzgjatja e gjykimit penal të zhvilluar pas ankimit të kërkueses arriti në më shumë se katërbëdhjetë vjet për hetimin paraprak dhe dy nivelet e juridiksionit. Kjo periudhë ekstremisht e gjatë nuk duket se justifikohet për shkak të kompleksitetit të çështjes. Vonesat e shkaktuara ishin për shkak të mungesës së kujdesit nga ana e autoriteteve dhe, ndërmjet të tjerash, autoritetet hetimore kishin dështuar në hetimin e aspekteve të caktuara të çështjes, veçanërisht angazhimin e individëve që kërkuesja i kishte identifikuar që kishin marrë pjesë në sulmin fizik.

Kohëzgjatja e tepërt e gjykimit kishte pa diskutim pasoja negative për kërkuesen, e cila ishte në një situatë tepër delikate psikologjike pas sulmit fizik. Ajo kishte mbetur në një situatë të pasigurt në lidhje me mundësinë e garantimit të gjykimit dhe dënimit të kundërvajtësve, i ishte dashur të shkonte disa herë në gjykatë dhe ishte e detyruar të përjetonte ngjarjet gjatë disa marrje në pyetje nga gjykata. Për pasojë, gjykimi nuk mund të konsiderohej sikur përmbushte kërkesat e neni 3 të Konventës. Për pasojë, Gjykata e refuzoi kundërshtimin paraprak të Qeverisë se kërkesa ishte e parakohshme.

Përfundim: *shkelje (njëzëri)*.

Neni 46: Në më shumë se 45 vendime Gjykata ka konstatuar shkelje të detyrimit për të kryer një hetim të efektshëm në kërkesat në lidhje me Bullgarinë. Për më tepër, disa kërkesa në lidhje me çështjet e përdhunimeve janë hequr nga lista pas një zgjidhjeje me pajtim ndërmjet palëve ose deklaratave të njëanshme nga Qeveria e cila njeht një shkelje të Neni 3. Në shumicën e këtyre çështjeve Gjykata kishte konstatuar që ka patur vonesa thelbësore në fazën e hetimeve paraprake dhe që nuk ishte kryer hetim i hollësishëm dhe objektiv. Në disa situata, vonesat kishin rezultuar në pushimin e çështjes për shkak se ato ishin parashkruar, ndërsa personat e dyshuar, megjithëse ishin identifikuar, nuk ishin akuzuar formalisht ose, megjithëse kundërvajtësit e dyshuar u çuan në gjyq dhe gjykimi ishte zhvilluar, afati i kufizimit të të ashtuquajtur ‘absolut’ kishte skaduar. Për më tepër, në disa raste autoritetet nuk kishin marrë parasysh prova të caktuara ose nuk ishin përpjekur të sqaronin rrethana të caktuara faktike ose angazhimin e individëve të caktuar në veprat penale, ose prokurori kishte refuzuar në mënyrë konsistente të përmbushte udhëzimet e gjykatës në lidhje me hetimin paraprak. Për pasojë kishte një problem sistematik të

mungesës së hetimeve në Bullgari. Megjithatë, kompleksiteti i problemit strukturor që konstatohej të ekzistonte e bënte të vështirë identifikimin e shkaqeve reale të mangësive të konstatuara ose identifikimin e masave specifike që duhej të zbatoheshin për të përmirësuar cilësinë e hetimeve. Në këto rrethana, Gjykata nuk e konsideronte veten e vet të ishte në gjendje për të treguar se cilat masa konkrete dhe të përgjithshme duhej të zbatoheshin për qëllimet e zbatimit të këtij vendimi. Autoritetet e brendshme, në bashkëpunim me Komitetin e Ministrave, ishin më mirë në gjendje të identifikonin shkaqet e ndryshme të problemit dhe të vendosnin se cilat masa të përgjithshme kërkoheshin – në terma praktike – si pengesë për shkeljet e ngjashme në të ardhmen, me synim luftimin e padënueshmërisë dhe respektimin e shtetit ligjor dhe besimit të publikut dhe viktimave në sistemin e drejtësisë.

Neni 41: 15.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Ekstradim

Vonesa të panevojshme në ekstradimin e kërkuesit për t'u gjykuar në Shtetin kërkues: shkelje

Gallardo Sanchez kundër Italisë - 11620/07 Vendimi 24.3.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Kërkuesi është një shtetas venezuelas. Në prill të vitit 2005, pasi u akuzua për zjarrvënie nga autoritetet greke, ai u ndalua në pritje të ekstradimit nga policia italiane, në pajtim me një urdhër arresti të nxjerrë sipas Konventës Europiane për Ekstradimin. Ai u ekstradua në Greqi në tetor të vitit 2006. Kërkuesi u ankuar para Gjykatës Evropiane për kohëzgjatjen e ndalimit të tij në pritje të ekstradimit.

Ligji – Neni 5 § 1 (f): Ndalimi i kërkuesit në pritje të ekstradimit ishte në pajtim me ligjin e brendshëm dhe ishte i justifikuar në bazë të detyrës së Shtetit për të përbushur angazhimet ndërkombëtare dhe ekzistencës së rrezikut që kërkuesi mund të arratisë. Megjithatë, kërkuesi ishte ndaluar në pritje të ekstradimit me qëllim që t'u jepej mundësia autoriteteve greke ta ndjekin atë penalisht. Në këtë kontekst, ishte e nevojshme të bëhej dallimi ndërmjet dy formave të ekstradimit me qëllim që të specifikoheshin niveli i kujdesit që kërkoheshin për secilin. Këto ishin ekstradim me qëllim ekzekutimin e një vendimi dhe ekstradim për t'i dhënë mundësi shtetit kërkues të gjykonte personin përkatës. Në rastin e fundit, meqenëse procedimi penal nuk kishte përfunduar, personi që i nënshtrohej ekstradimit duhej të prezumohej i pafajshëm; për më tepër, në këtë fazë zotësia e tij për të ushtruar të drejtat e mbrojtjes në gjykimin penal për qëllimet e provimit të pafajësisë së tij ishte kufizuar së tepërmi, ose nuk ekzistonte; së fundmi, autoritetet e Shtetit të kërkuar ishin të penguar në ndërmarrjen e shqyrtimit të themelit të çështjes. Për të gjitha këto shkaqe, mbrojtja e të drejtave të personit përkatës dhe funksionimi i duhur i procedimit të ekstradimit, duke përfshirë

detyrën e ndjekjes penalisht të individit përkatës brenda një afati të arsyeshëm, bënte që Shteti i kërkuar të vepronte me kujdes të veçantë.

Në këtë rast, ndalimi në pritje të ekstradimit zgjati afërsisht një vit dhe gjashtë muaj dhe vonesa të konsiderueshme nga ana e autoriteteve italiane kishin ndodhur në faza të ndryshme të procedimit të ekstradimit, megjithëse çështja nuk ishte tepër komplekse. Për pasojë, duke patur parasysh natyrën e procedimeve të ekstradimit, të filluara me qëllim ndjekjen penale të kërkuesit në një Shtet të tretë, natyra e pajustificuar e vonesave nga gjykatat italiane, ndalimi i kërkuesit nuk ishte i 'ligjshëm' brenda kuptimit të Nenit 5 par 1 (f) të Konventës.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: nuk është ngritur pretendim në lidhje me dënim. (Shih Pasqyrën e Fakteve mbi Dënimet dhe Ekstradimet dhe Manualin mbi të drejtën europiane në lidhje me azilin, kufijtë dhe imigrimin.)

NENI 6

Neni 6 § 1 (civil)

Të drejtat dhe detyrimet civile Gjykimi i drejtë

Interpretimi haptazi arbitrar i Vendimit të Gjykatës Evropiane nga Gjykata e Lartë në rastin e refuzimit të ankimit të veçantë: *Neni 6 § 1 i zbatueshëm; shkelje*

Bochan kundër Ukrainës (nr 2) - 22251/08 Vendimi 5.2.2015 (GC)

Faktet – Kërkuesja u përfshi në një gjykim të gjatë por në fund të pasuksesshëm në lidhje me të drejtën e pronësisë mbi tokën në gjykatat e brendshme. Në vitin 2001, ajo bëri një kërkesë tek Gjykata Evropiane duke u ankuar për padrejtësinë e gjykimeve të brendshme. Në një Vendim të datës 3 maj 2007 (Bochan kundër Ukrainës, 7577/02), Gjykata konstatoi një shkelje të Nenit 6 par 1 të Konventës për shkak se vendimet e gjykatave të brendshme ishin marrë në gjykime që nuk kishin respektuar Nenin 6 par 1 për garancitë e gjykimit të drejtë, të pavarësisë dhe paanësisë, sigurisë ligjore dhe kërkesës për të dhënë arsye të mjaftueshme. Ajo i dha kërkueses EUR 2,000 në lidhje me dëmin jo-financiar. Në mbështetje të vendimit të Gjykatës Evropiane, kërkuesja bëri “ankim nën dritën e rrethanave të veçanta” (“ankim i veçantë”) në të cilin ajo i kërkonte Gjykatës së Lartë të Ukrainës për të shfuqizuar vendimet e gjykatave të brendshme në çështjen e saj dhe të pranonte plotësisht pretendimet e saj. Në mars të vitit 2008, Gjykata e Lartë e refuzoi ankimin pas konstatimit që vendimet e brendshme ishin të sakta dhe të mirë-bazuara. Në qershor të vitit 2008, ajo deklaroi të papranueshëm një ankim tjetër të veçantë të paraqitur nga kërkuesja. Në kërkesën e saj në Gjykatën Evropiane në këtë çështje, kërkuesja u ankua në bazë të Nenit 6 par 1 i Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit nr. 1 që

në refuzimin e ankimit të saj, Gjykata e Lartë nuk kishte marrë parasysh konstatimet e Gjykatës Evropiane në Vendimin e saj të datës 3 maj 2007.

Ligji – Neni 6 § 1: Gjykatës i duhej të vendoste tre çështje: (a) nëse pengohej nga Neni 46 i Konventës në trajtimin e ankesave të kërkuases duke ditur që Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës po vazhdonte të mbikëqyrte ekzekutimin e Vendimit të datës 3 maj 2007, (b) nëse gjykimi i brendshëm i ankimit të veçantë të kërkuases gëzonte garancitë e Konventës dhe, nëse po, (c) nëse ishin respektuar kërkesat e Nenit 6 par 1.

(a) *nëse Gjykata pengohej nga Neni 46 në trajtimin e ankesave* – Dhoma e Madhe përsëriti që roli i Komitetit të Ministrave në sferën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës nuk e pengon gjykatën nga shqyrtimi i kërkesave të reja në lidhje me masat e marra nga Shteti i akuzuar në zbatim të një vendimi nëse kërkesa përmban informacion të ri përkatës në lidhje me çështjet e pavendosura nga vendimi i parë. Disa prej parashtrimeve të kërkuases në këtë çështje mund të konceptohen si ankime në lidhje me mungesën e ekzekutimit të duhur të Vendimit të Gjykatës të datës 3 maj 2007. Megjithatë, ankesat për moszekutimin e vendimeve të Gjykatës ose për rikuperimin e një shkeljeje të konstatuar nga Gjykata del jashtë kompetencës së Gjykatës. Ankimet e kërkuases në lidhje me mos-korrigjimin e shkeljes fillestare të nenit 6 par 1 në çështjen e saj të mëparshme kanë të papranueshme. Megjithatë, kërkesja ka ngritur një shqetësim të ri në lidhje me sjelljen dhe drejtësinë e gjykimit të vendosur nga Gjykata e Lartë e marsit të vitit 2008. Ajo veçanërisht pretendoi që arsyetimi i bërë nga Gjykata e Lartë në atë vendim ishte haptazi në kundërshtim me konstatimet përkatëse të Gjykatës në vendimin e vitit 2007. Ky shqetësim i ri ishte në lidhje me mënyrën se si ishte marrë vendimi i marsit 2008 në gjykimin në lidhje me ankimin e veçantë të kërkuases, dhe jo në lidhje me rezultatin e atij gjykimi si i tillë ose efektivitetin e zbatimit nga gjykatat e brendshme të vendimit të Gjykatës. Pra, kjo kishte të bënte me një situatë të dallueshme nga ajo e shqyrtuar në vendimin e vitit 2007 dhe përmbante informacionin përkatës të ri në lidhje me çështjet e pavendosura nga ai vendim. Për pasojë, Gjykata nuk pengohej nga Neni 46 i Konventës për të shqyrtuar ankimin e ri të kërkuases në lidhje me drejtësinë e gjykimit që kishte kulmuar me vendimin e Gjykatës së Lartë të marsit 2008.

(b) *Zbatueshmëria e Nenit 6 në gjykimet në lidhje me ankimin e veçantë të kërkuases* – Ndërsa Neni 6 par 1 nuk zbatohet normalisht për ankimet e jashtëzakonshëm që kërkonin rihapjen e gjykimeve të pushuara, natyra, objekti dhe tiparet specifike të gjykimit për një ankim të jashtëzakonshëm në sistemin ligjor të veçantë përkatës mund të jenë të tilla që të hapin gjykime për këto lloje ankimi brenda sferës së zbatimit të Nenit 6 par 1 dhe i garancive për një gjykim të drejtë që ai u ofron palëve në gjykim. Kështu Gjykatës i duhej të shqyrtonte natyrën, objektin dhe tiparet specifike të ankimit të veçantë në fjalë në këtë çështje. Kuadri ligjor i brendshëm i zbatueshëm i ofronte kërkuases një mjet ankimi që mundësonte rishikimin ligjor të çështjes së saj civile nga Gjykata e Lartë nën dritën e konstatimit të Gjykatës Evropiane që vendimet e brendshme fillestare kanë qenë të vesuar. Në sajë të llojit të

rishikimit gjyqësor që ai parashikonte, ankimi i veçantë i ngritur nga kërkuesja mund të shihej si një zgjatje e gjykimit civil fillestar (të pushuar), e ngjashme me një procedurë kasacioni siç përcaktohet në ligjin ukrainas. Duke qenë kështu, ndërsa tiparet e veçanta të këtij lloji të procedurës së kasacionit mund të preknin mënyrën në të cilën operojnë garancitë procedurale të parashikuara në Nenin 6 par 1, Gjykata ishte e mendimit që ato garanci duhej të ishin të zbatueshme për të në të njëjtën mënyrë siç zbatoheshin në gjykimet në kasacion përgjithësisht në çështjet civile. Ky përfundim që rridhte nga dispozitat ligjore të zbatueshme të brendshme përforcohej nëpërmjet referencës tek objekti dhe natyra e 'shqyrtimit' që u krye nga Gjykata e Lartë në mars 2008 para refuzimit të ankimit të veçantë të kërkuesit, duke i lënë vendimet e kontestuara të pandryshuar. Gjykata e Lartë i rishikoi materialet e çështjes dhe vendimet e gjykatës nga gjykimi fillestar në dritën e parashtrimeve të reja të kërkuesit bazuar kryesisht në vendimin e Gjykatës së vitit 2007.

Kështu, në dritën e dispozitave përkatëse të legjislacionit ukrainas dhe të natyrës dhe objektivit të gjykrimeve që kulminuan me vendimin e Gjykatës së Lartë të marsit 2008 në lidhje me ankimin e veçantë të kërkuesit, të pasuar nga vendimi konfirmues i qershorit 2008, Gjykata konsideroi që gjykimet ishin vendimtare për përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave civile të kërkuesit. Për pasojë garancitë përkatëse të Nenit 6 par 1 zbatohen për ato gjykime.

Përfundim: Kundërshtimi paraprak refuzohet (njëzëri).

(c) *Respektimi i Nenit 6 § 1* – Gjykata përsëriti që nuk ishte roli i saj të vepronte si shkallë e katërt dhe të vërë në pikëpyetje vendimet e gjykatave të brendshme sipas Nenit 6 par 1, përveç kur konstatimet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të pabazuara. Në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë, në vendimin e marsit 2008, kishte keq-interpretuar haptazi konstatimet e Gjykatës Evropiane në Vendimin e saj të datës 3 maj 2007. Veçanërisht, ajo ishte shprehur që Gjykata Evropiane i kishte konstatuar vendimet e gjykatave të brendshme të ligjshme dhe të mirë-bazuara dhe kishte dhënë kompensim të drejtë për shkeljen e garancive të 'afatit të arsyeshëm' (kur në fakt ankesa ishte refuzuar si haptazi e pabazuar). Këto afirmime ishin dukshëm të pasakta. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk sillte vetëm një interpretim të ndryshëm të një teksti ligjor. Për Gjykatën, kjo mund të interpretohet vetëm si 'haptazi arbitrare' ose që përbënte 'mohim të drejtësisë', në kuptimin që prezantimi i shtrembëruar i Vendimit të vitit 2007 kishte efektin e mposhtjes së përpjekjes së kërkueses që pretendimi i saj pasuror të shqyrtohej nën dritën e atij Vendimi në kuadrin e procedurës së llojit të kasacionit të parashikuar sipas ligjit të brendshëm. Gjykimi i kundërshtuar nuk kishte plotësuar kërkesën e 'gjykimit të drejtë' sipas nenit 6, par 1.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: 10.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Gjykimi i drejtë

Mosnjoftimi i rregullt i procedurës së falimentimit: *shkelje*

Zavodnik kundër Sllovenisë - 53723/13 Vendimi 21.5.2015 (Seksioni V)

Faktet – Në vitin 1997 një gjykatë pune urdhëroi një shoqëri private ti paguante kërkuessit pagën dhe kontributet përkatëse (afërsisht 8.350 Euro). Në vitin 1999 Vendimi morri formë të prerë. Në vitin 2000 filloi procedura e falimentimit ndaj shoqërisë. Në vitin 2005 pretendimet e kërkuessit u njohën në procedurën e falimentimit. Administratori dhe paneli i falimentimit siguroi kërkuessit që ata do ta njoftonin atë në lidhje me progresin e procedurës, veçanërisht për caktimin e seancave në lidhje me shpërndarjen e sendeve pasurore. Në vitin 2008, një kompleks hotelesh që i përkisnin shoqërisë u shit në ankand publik. Raportet mbi shitjet u publikuan *online* në një faqe interneti për ekonomistët, në faqen Sllovene të Agjencisë së Shtypit dhe në një gazetë financiare ditore. Pas shitjes, në vitin 2008 paneli i falimentimit të gjykatës së rrethit miratoi projekt-propozimin për shpërndarjen e sendeve pasurore të shoqërisë së falimentuar tek 19 kreditorët e mbetur. U propozua që ata duhej të merrnin secili 2.85% të pretendimit të njohur në procedurë, e cila në rastin e kërkuessit ishte 237 Euro. Gjykata caktoi një seancë tjetër në shtator 2008 për të konfirmuar shpërndarjen e sendeve pasurore. Gjykata e rrethit e publikoi vendimin e saj dhe shpalli njoftimin e seancës në këndin e njoftimeve të gjykatës. Njoftimi i seancës, me datën dhe vendin, u publikua në Gazetën Zyrtare. Në seancë gjykata e rrethit konfirmoi propozimin e shpërndarjes së administratorit. Vendimi i saj u shpall në këndin e njoftimit të gjykatës ditën tjetër dhe mund të ankimohej brenda tetë ditëve. Meqenëse nuk u bë ankim ndaj vendimit, ai morri formë të prerë. Në nëntor të vitit 2008 procedura e falimentimit u pushua. Në dhjetor 2008 kërkuessi bëri ankim ndaj vendimit për pushimin e procedurës së falimentimit. Ai argumentoi që ai nuk ishte njoftuar rregullisht në lidhje me seancën e shtatorit për shpërndarjen e sendeve pasurore dhe që atij duhej t'i jepej paga e plotë e pretenduar në procedurën e falimentimit. Në vitin 2009 ankimi i tij u refuzua dhe gjithashtu u refuzua edhe ankimi kushtetues.

Ligji – Neni 6 § 1: Rregullat për njoftimin e ftesave dhe vendimeve duke i shpallur në këndin e njoftimeve të gjykatës dhe publikimi në Gazetën Zyrtare i shërbenin qëllimit legjitim për të siguruar që procedura e falimentimit të jetë e shpejtë dhe efiçente. Arsyeja e heqjes dorë nga dorëzimi personalisht ishte se kjo lloj procedure mund të përfshijë një numër të madh kreditorësh dhe palësh. Dorëzimi personalisht i dokumenteve gjyqësore mund të ishte një shtesë thelbësore për shpenzimet e procedurës dhe, për më tepër, pengonte zhvillimin e saj nëse nuk bëhej. Megjithatë, sipas ligjit të brendshëm, seanca për shpërndarjen e sendeve pasurore përfaqësonte një pikë thelbësore në procedurë. Deri në këtë pikë, kreditorët mund të kundërshtonin propozimin e administratorit zyrtar për shpërndarjen e sendeve pasurore. Ata përjashtoheshin nga një gjë e tillë në fazat e mëvonshme. Në këtë kontekst, afati tetë-ditor për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit për shpërndarjen ishte relativisht i shkurtër. Kërkuessi ishte palë në procedimin i cili kishte

zgjatur më shumë se tetë vjet për t'u caktuar një seancë për shpërndarjen e sendeve pasurore të falimentimit. Në këtë fazë kishin mbetur vetëm 19 kreditorë emrat e të cilëve duhej të ishin të njohur për gjykatën. Përveç kësaj, kërkuesi, i cili nuk përfaqësohej nga një avokat, kishte argumentuar që ai ishte siguruar nga administratori që ai do të njoftohej për çdo zhvillim të procedurës. Duke patur parasysh numrin tepër të vogël të kreditorëve në procedurë, Gjykata nuk pa shkak se pse kërkuesi nuk duhej të besonte administratorin. Së fundmi, megjithëse ligji i brendshëm vërtet nuk parashikonte dorëzimin personalisht të ftesave dhe vendimeve gjyqësore në procedurën e falimentimit, ai parashikonte për mundësinë e publikimit të njoftimit të seancës për shpërndarjen e sendeve pasurore edhe me media. Gjykata me keqardhje shprehet se në rastin konkret, gjykata e brendshme nuk e kishte përdorur këtë mundësi publikimi. Gjykata nuk mund të kuptonte argumentin e Qeverisë që kërkuesi duhej ta kishte ditur shitjen e kompleksit të hoteleve nga raportet e medias *online*. Media përkatëse nuk mund të konsiderohej e destinuar për publikun e gjerë dhe/ose të kishte shkuar deri tek kërkuesi (krahaso *Geffre kundër Francës* (dec.), 51307/99, 23 janar 2003, Shënim Informativ 49), një i moshuar i cili tha që ai nuk ishte në gjendje të përdorte një kompjuter ose të hynte në internet. Nuk do të ishte realiste të pritej që kërkuesi të konsultonte rregullisht këndin e njoftimeve të gjykatës që gjendet në një qytet tjetër nga vendbanimi i tij ose të kishte akses tek çdo numër i Gazetës Zyrtare. Në këto rrethana, Gjykata nuk ishte në gjendje të nxirrte përfundimin që kërkuesi kishte një mundësi normale për të marrë dijeni në lidhje me seancën mbi shpërndarjen e sendeve pasurore dhe mosmarrja pjesë e tij në procedurë ishte për shkak të mungesës së kujdesit nga ana e tij (krahaso me *Cañete de Goñi kundër Spanjës*, 55782/00, 15 tetor 2002, Shënimi Informativ 38). Për më tepër, nuk do të ishte jo-proporcionale që t'i kërkohej Shtetit të merrte masa shtesë për të siguruar që palët e pakta të mbetura në procedurë, duke përfshirë kërkuesin, të njoftoheshin për seancën mbi shpërndarjen dhe vendim-marrjen në seancë. Duke u privuar nga mundësia e marrjes pjesë në seancën e datës 10 shtator 2008, kërkuesi ishte privuar nga kundërshtimi i planit të administratorit për shpërndarjen e sendeve pasurore dhe në këtë mënyrë për realizimin e së drejtës së tij për të marrë një përqindje më të lartë të pretendimit të tij për pagat e papaguara.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Ghykata konstatoi gjithshu një shkelje të Nenit 6 §1 dhe Nenit 13 për shkak të kohëzgjatjes së procedurës dhe mungesës së efektivitetit të mjeteve mbrojtëse në këtë aspekt.

Neni 41: 12.500 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; pretendimi në lidhje me dëmin financiar refuzohet.

Gjykimi i drejtë

Provokimi i pretenduar që solli vendimin e fajësimit për shkelje të së drejtës së autorit: i papranueshëm

Volkov dhe Adamskiy kundër Rusisë -7614/09 dhe 30863/10 Vendimi 26.3.2015 (Seksioni I)

Faktet – Në kontekstin e operacioneve policore që synonin ekspozimin e individëve të përfshirë në shpërndarjen e mallrave të falsifikuar, kërkuesit u kontaktuan nga dy punonjës policie të fshehtë, të cilëve iu kërkua t’iu instalonin programet në kompjuterët e tyre. Kërkuesit gjetën dhe instaluan programet e palicencuara në kompjuterët e punonjësve të policisë. Më pas ata u dënuan për shkelje të së drejtës së autorit. Gjatë gjykimit në bazë të Konventës kërkuesit u ankuan që policia i kishte nxitur ata të kryenin veprën penale, në shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim të drejtë (Neni 6 par 1 i Konventës).

Ligji – Neni 6 § 1 (të dy kërkuesit): Gjykata përsëriti që në rastet e provokimit të pretenduar, Gjykata fillimisht duhet të vërtetojë nëse vepra penale do të ishte kryer edhe pa ndërhyrjen e autoriteteve. Kërkuesit ishin përfshirë në një aktivitet biznesi të ligjshëm dhe policia hyri në kontakt me ta siç do të kishin bërë edhe klientët e zakonshëm. Kërkuesit kishin blerë ose shkarkuar spontanisht dhe pastaj kishin instaluar programin e palicencuar në kompjuterët e punonjësve të policisë së fshehtë, pa ndonjë kërkesë të veçantë ose nxitje të paligjshme nga ana e policisë. Për më tepër, ata informuan haptazi punonjësit e policisë që programi ishte i paligjshëm dhe që do të ishte shumë më i shtrenjtë të instalonin program të licencuar. Kjo çështje dallohej nga çështjet e tjera ruse për provokimin pasi ishte sjellja e qëllimshme e kërkuesve dhe jo veprimet arbitrare ose të paligjshme të policisë që ishin faktori përcaktues në kryerjen e veprave të tyre penale.

Përfundim: e papranueshme (haptazi e pabazuar).

Neni 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c) (Z *Volkov*): Gjatë seancës së tij në apel, Z Volkov nuk ishte asistuar nga një avokat pasi ai nuk mund të mbante avokatin e shkallës së parë apo të caktonte një tjetër sipas zgjedhjes së tij. Duke ditur kompetencat e gjera të gjykatës së apelit për rishikimin e çështjes së tij në tërësi, Z Volkov mund të përfitonte në masë të konsiderueshme nga avokati i tij me qëllim që të paktën të ulte dënimin. Sipas ligjit të brendshëm, e drejt për përfaqësim ligjor shtrihet në gjykimet në apel, nëse, *ndërmjet të tjerash*, i pandehuri nuk ka hequr dorë prej sa me shkrim. Nëse i pandehuri nuk mund të paguajë një avokat, u takonte autoriteteve që t’i caktonin atij një të tillë. Nga dosja e çështjes dukej se Z Volkov nuk kishte hequr dorë nga e drejta e tij për ndihmë juridike në gjykimin në apel. Megjithëse ai nuk kishte kërkuar ti caktohej një avokat mbrojtës, vetë sjellja e tij nuk mund t’i lironte autoritetet nga detyrimi për ti siguruar atij mbrojtje të efektshme. Duke patur parasysh që autoritetet e brendshme ishin në dijeni të faktit që kërkuesi nuk kishte marrëveshje vazhdimi me avokatin e shkallës së parë, ata kishin për detyrë të caktonin një avokat mbrojtës për seancën e apelit ose të shtynin seancën deri në atë kohë që kërkuesi të përfaqësohej në mënyrë të përshtatshme.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: 4.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Prezumimi i pafajësisë

Gjoha administrative për kontrabandë e vendosur mbi bazën e fakteve që më parë kishin sjellë si rezultat pafajësi në gjykimin penal: shkelje

Kapetanios dhe të tjerë kundër Greqisë - 3453/12, 42941/12 dhe 9028/13 Vendimi 30.4.2015 (Seksioni I)

Faktet – Gjykimi penal filloi në ngarkim të tre kërkuesve me akuzën e kontrabandës. Ata morën pafajësi me vendimet që morën formë të prerë në vitin 1992, 1998 dhe 2000. Ndërkohë, ata ishin urdhëruar të paguanin gjoha administrative. Këto ishin afërsisht 130 000 Euro në rastin e një kërkuesi dhe disa qindra mijë Euro në rastin e kërkuesve të tjerë. Gjykimet administrative u përmbyllën me vendimet e Gjykatës së Lartë Administrative të vitit 2011 dhe 2012. Në refuzimin e ankimeve të kërkuesve për shkaqe të ligjit, Gjykata e Lartë Administrative vuri re që autoritetet administrative nuk i nënshtroheshin asnjë vendimi pafajësie të dhënë nga gjykatat penale, meqenëse sipas ligjit të brendshëm vetëm vendimet përfundimtare detyruese të gjykatave kishin efektin *res judicata* për gjykatat administrative.

Gjykimet penale dhe administrative ndaj kërkuesit të parë kishin të bënin me importimin, në vitin 1985 dhe 1986, të dymbëdhjetë pajisjeve elektronike, një pushke gjahu, një vinç dhe një video-kamera pa paguar detyrimet përkatëse doganore. Të dyja gjykimet ndaj kërkuesit të dytë kishin të bënin me shitjen, ndërmjet viteve 1993 dhe 1995, të benzinës dhe naftës pa patur certifikatat e blerjes. Të dyja gjykimet ndaj kërkuesit të tretë kishin të bënin me importimin në Greqi në vitin 1992 të dy automjeteve luksoze pa paguar tatimet dhe detyrimet doganore dhe përdorimi i tyre pa patur zhdoganimin paraprakisht nga autoritetet doganore.

Ligji – Neni 4 i Protokollit nr. 7: Gjobat administrative në fjalë ishin të natyrës penale, duke ditur rëndësinë e gjobave të vendosura dhe efektit të tyre parandalues. Akuzat e ngritura ndaj kërkuesve para gjykatave administrative dhe penale i referoheshin specifikisht të njëjtës sjellje që ka ndodhur në të njëjtën periudhë. Qysh nga momenti që vendimet e pafajësisë të dhëna në gjykimin e parë u bënë *res judicata*, kërkuesit duhej të konsideroheshin sikur të 'kishin marrë përfundimisht pafajësi', brenda kuptimit të Nenit 4 të Protokollit nr. 7. Duke patur parasysht që kërkuesit ishin mbështetur në vendimet e pafajësisë të dhënë, të cilët tashmë ishin *res judicata*, si në gjykatat që shqyrtonin themelin e çështjes ashtu edhe në shkallën e fundit të Gjykatës Administrativ Supreme, i takonte gjykatës administrative që të konsideronte kryesisht efektin që mund të kishin vendimet e pafajësisë në kontekstin e gjykimeve administrative të papërfunduara, pasi

mosmarrja parasysh e ekzistencës së ‘gjykimit penal’ të parë do të ishte përcaktuese në tolerimin me qëllim të një situatë brenda sistemit të brendshëm juridik që mund të jetë në shkelje të parimit *ne bis in idem*.

Neni 4 i Protokollit nr. 7 në parim nuk e ndalon vendosjen e një afati burgimi dhe një gjobe për të njëjtën situatë faktike, me kusht që të respektohet parimi *ne bis in idem*. Kështu në kontekstin e parandalimit të kontrabandës, ky parim nuk do të ishte shkelur nëse të dy format e dënimit, me heqje lirie dhe një dënim me gjobë, do të ishin vendosur si pjesë e një gjykimi të vetëm. Për më tepër, fakti që, në rastin e dy kërkuesve, gjykimi penal nuk kishte përfunduar akoma kur filloi gjykimi administrativ në vetvete ishte problematik në lidhje me parimin e *ne bis in idem*. Ky parim do të ishte respektuar nëse gjykata penale do të kishte pezulluar gjykimin pas hapjes së gjykimit administrativ dhe pastaj të përfundohej ndjekja penale pasi Gjykata Administrative Supreme të kishte konfirmuar gjobën në fjalë në shkallë të fundit.

Në vendimin e saj Åklagaren kundër Hans Åkerberg Fransson, Gjykata e Bashkimit Europian (GJBE) kishte specifikuar që sipas parimit *ne bis in idem*, një Shtet mund të vendosë një dënim të dyfishtë (tatimor dhe penal) për të njëjtët veprime vetëm nëse dënimi i parë nuk ka qenë e një natyre penale. Në vlerësimin e natyrës penale të një gjobe tatimore, GJBE-ja ishte mbështetur në tre kriteret e përdorura nga Gjykata në vendimet *Engel dhe të Tjerë*. Për pasojë, Gjykata vuri re konvergjençën në praktikën gjyqësore të të dy gjykatave në lidhje me vlerësimin e natyrës penale të gjykimeve të çështjeve tatimore dhe, *a fortiori*, zbatimin e parimit *ne bis in idem* në çështjet tatimore dhe penale.

Në dritën e sa më sipër, gjykimi administrativ në fjalë kishte të bënte me një ‘vepër penale’ të dytë që rrjedh nga të njëjtat veprime me ato që ishin objekti i vendimeve të pafajësisë të para dhe përfundimtare.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 6 § 2 i Konventës: Kjo çështje ishte qartësisht e dallueshme nga çështjet e shqyrtuara më parë nga Gjykata në të cilat një organ administrativ me kompetenca disiplinore kishte vendosur një gjobë si rezultat i akuzave ndaj një punonjësi të shtetit pas pafajësisë së tij ose saj në gjykimin penal. Në ato raste, procedimet disiplinore kishin një autonomi të caktuar kundrejt gjykimit penal, veçanërisht në lidhje me termat e kushteve për zbatimin e tyre dhe qëllimin jo-ndëshkëimor. Për hir të kësaj autonomie, caktimi i një gjobe administrative për punonjësin në fjalë nuk ishte konsideruar të përbënte një shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, në masën që vendimi i organit administrativ nuk përmbante ndonjë deklaram që i vishte përgjegjësi penale kërkuesit.

Në çështjen në fjalë, pas vlerësimit të materialit në dosjen e çështjes në një mënyrë të ndryshme nga gjykatat penale, gjykatat administrative kishin konsideruar që kërkuesit kishin kryer të njëjtat vepra penale të kontrabandës nga të cilat ata më parë kishin marrë pafajësi në gjykatat penale. Këto përfundime kishin mbetur në fuqi në shkallën e fundit nga Gjykata Administrative Supreme. Duke ditur natyrën e ngjashme të dy gjykimeve në fjalë, veprimet e debatueshme dhe elementet përbërës të veprave përkatëse, ky

konstatim nga gjykatat administrative kishte shkelur të drejtën e kërkuësve për t'u prezumuar të pafajshëm, gjë që ishte vendosur tashme nga pafajësia e dhënë nga gjykatat penale.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi gjithashtu, në lidhje me një prej kërkuësve, një shkelje të Nenit 6 par 1 dhe Nenit 13 të konventës në lidhje me tejzgjatjen e gjykimit dhe mungesën e një mjeti të efektshëm mbrojtjeje në atë aspekt.

(Shih gjithashtu *Engel dhe të Tjerë kundër Holandës*, 5100/71 et al., 8 qershor 1976; *Moulet kundër Francës* (dec.), 27521/04, 13 shtator 2007, Shënimi Informativ 100; *Vagenas kundër Greqisë* (dec.), 53372/07, 23 gusht 2011; *Vanjak kundër Kroacisë*, 29889/04, 14 janar 2010; dhe *Hrdalo kundër Kroacisë*, 23272/07, 27 shtator 2011.)

NENI 7

Neni 7 § 1

Nullum crimen sine lege

Dënim më i rëndë

Fajësi për veprën penale 'në vazhdim' që përbëhet nga veprimet e kryera para se të futej në Kodin Penal: *nuk ka shkelje*

Rohlena kundër Republikës Çeke - 59552/08 Vendimi 27.1.2015 (GC)

Faktet – Kërkuesi u akuzua për abuzim fizik dhe mendor në vazhdimësi të bashkëshortes ndërmjet vitit 2000 dhe 8 shkurtit 2006. Në vitin 2007 gjykata e faktit e shpalli të fajshëm për veprën penale në vazhdimësi të abuzimit të një personi me të cilin banon nën të njëjtën çati sipas përcaktimit të Nenit 215a të Kodit Penal sipas tekstit të datës 1 qershor 2004. Ajo ishte e mendimit që përkufizimi shtrihej mbi veprimet e kryera para kësaj date në masën që në atë kohë, në çështjen e kërkuësit, të jenë kualifikuar në një vepër tjetër. Fajësia u la në fuqi nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore, Gjykata e Lartë vuri re që në rastet kur vepra penale ishte në vazhdimësi dhe që konsiderohej si një veprimi vetëm, natyra penale e atij veprimi duhej të vlerësohej bazuar në ligjin që ishte në fuqi në kohën e veprimit të fundit që përbënte veprën penale. Ligji zbatohet gjithashtu edhe për veprimet e mëparshme me kusht që këta të ishin veprime penalisht të dënueshëm edhe sipas ligjit të mëparshëm. Në rastin në fjalë veprimet e kërkuësit para ndryshimit të Kodit Penal të datës 1 qershor 2004 kualifikoheshin si dhunë ndaj një individi ose grupi individësh brenda kuptimit të Nenit 197a të 12 Nenit 7 par 1 – Neni 8 i Kodit Penal dhe sulm fizik në kuptimin e Nenit 221 të këtij Kodi.

Në vitin 2008 Gjykata Kushtetuese rrëzoi si haptazi të pabazuar një ankim kushtetues të paraqitur nga kërkuesi, duke patur parasysh që vendimet e gjykatave në këtë çështje nuk kishin efekt prapaveprues të ndaluar nga Kushtetuta. Në një Vendim të datës 18 prill 2013 (shih Shënim Informativ 162), një Dhomë e Gjykatës Evropiane konstatoi njëzëri që vendimi i gjykatave të brendshme nuk e kishin shkëlur Nenin 7 të Konventës.

Ligji – Neni 7: Kërkuesi ishte dënuar për një vepër penale sipas Nenit 215a të Kodit Penal që ishte futur me ndryshimet e vitit 2004 të këtij Kodi edhe në lidhje me veprimet e kryera edhe para asaj date. Gjykatat e brendshme konstatuan që një vepër penale në vazhdimësi duhej të konsiderohej si një veprim i vetëm kualifikimi ligjor i së cilës duhej të vlerësohej sipas ligjit në fuqi në momentin e përfundimit të kryerjes së fundit të veprës penale, me kusht që veprimet e kryera sipas çdo ligji të mëparshëm të ishin të dënueshme sipas atij ligji. Kështu, Neni 215a zbatohet edhe për sulmet fizike të kryera nga kërkuesi para vitit 2004 pasi ato kualifikoheshin si veprim i dënueshëm penalisht sipas ligjit të mëparshëm. Në interpretimin e ligjit të brendshëm, gjykatat e brendshme i ishin referuar konceptit të një vepre penale në vazhdimësi, që përbëhej nga veprime të veçantë të kryer nga i njëjti qëllim, duke përbërë të njëjtën vepër penale dhe që bashkoheshin në sajë të kryerjes në një mënyrë të ngjashme ose identike, që ishin kryer në afërsi kohore dhe ndiqnin të njëjtin qëllim. Sjellja e kërkuesit para datës 1 qershor 2004 kategorizohej si vepra penale të dënueshme sipas ligjit të brendshëm në fuqi në atë kohë dhe kështu përfshinin elementet ligjore të veprës penale sipas Nenit 215a. Kështu, duke e konsideruar kërkuesin përgjegjës sipas kësaj dispozite edhe në lidhje me veprimet e kryera para asaj date nuk përbente zbatimin me prapaveprim të një ligji penal më të ashpër gjë që ndalohet nga Konventa.

Në këto rrethana dhe duke patur parasysh edhe qartësinë me të cilën ishin formuluar dhe interpretuar dispozitat përkatëse të brendshme nga gjykatat e brendshme, kërkuesi kishte qenë në gjendje të parashikonte që ai mund të mbahej penalisht përgjegjës për një vepër penale në vazhdimësi edhe në lidhje me periudhën para vitit 2004 dhe për të rregulluar sjelljen e tij përkatësisht. Kështu, vepra për të cilën kërkuesi ishte dënuar kishte bazë në 'ligjin e brendshëm përkatës në momentin kur ishte kryer', i cili nga ana tjetër e kishte përkufizuar qartazi në masën e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat cilësore të parashikueshmërisë sipas Nenit 7 të Konventës. Përfundimisht, Gjykata e rrëzoi argumentin e kërkuesit që caktimi i një dënimi sipas dispozitës së vitit 2004 kishte rezultuar në një dënim më të rëndë nga sa do të ishte vendosur ndryshe. Asgjë nuk tregonte që qëndrimi i gjykatave të brendshme kishte efektin e rritjes së ashpërsisë së dënimit për kërkuesin. Përkundrazi, nëse veprimet e kryera prej tij para datës 1 qershor 2004 do të ishin vlerësuar veçmas nga ato që ai kishte kryer më vonë, kërkuesi mund të kishte marrë të paktën të njëjtin dënim si ai që ishte vendosur, ose mbase më të ashpër.

Përfundim: nuk ka shkelje (njëzëri).

(Shih gjithashtu *Del Rno Prada kundër Spanjës* (GC), 42750/09, 21 tetor 2013, Shënim Informativ 167; dhe *Maktouf and Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës* (GC), 2312/08 dhe 34179/08, 18 korrik 2013, Shënim Informativ 165).

Neni 8

Prëzimi i pretendimit të shpifjes ndaj gjyshit të kërkuesit, ish-udhëheqësi sovjetik Josif Stalin: e papranueshme

Dzhugashvili kundër Ruisë - 41123/10 Vendimi 9.12.2014 (Seksioni I)

Faktet – Kërkuesi është nipi i ish udhëheqësit sovjetik, Josif Stalin. Në vitin 2009 ai paditi gazetën *Novaya Gazeta* për shpifje pasi ajo botoi një artikull që akuzonte udhëheqësit e Byrosë Politike Sovjetike, duke përfshirë Stalinin, me qenien “të lyer me shumë gjak” në urdhrin për ekzekutimin e të burgosurve polakë të luftës në Katyn 1940. Artikulli e kishte përshkruar Stalinin si një ‘kanibal gjakësor’ dhe gjithashtu pretendonte që udhëheqësit sovjetikë ‘i ishin shmangur përgjegjësisë morale për këtë krim tepër të rëndë’. Gjykata e Rrethit e rrëzoi padinë duke konstatuar që artikulli kontribuonte në një debat faktik në lidhje me një çështje me rëndësi të thellë historike dhe rolin e Stalinin si një figurë e famshme botërore duke bërë thirrje për një shkallë më të lartë të tolerancës ndaj vëzhgimit dhe kritikës publike. Më vonë gazeta publikoi një artikull tjetër duke dhënë informacione në lidhje me gjykimin mbi shpifjen. Kërkuesi ngriti përsëri padi, por pretendimi i tij u rrëzua për shkak se artikulli përbënte një shprehje të mendimit të autorit në lidhje me gjykimin e parë mbi shpifjen.

Ligji – Neni 8: Gjykata riafirmoi parimin që publikimet në lidhje me reputacionin e një anëtarit të vdekur të familjes së një personi, në rrethana të caktuara, mund të ndikojë në jetën private dhe identitetin e atij personi dhe në këtë mënyrë të futet në sferën e zbatimit të Nenit 8 (shih *Putistin kundër Ukrainës*, 16882/03, 21 nëntor 2013, Shënim Informativ 168). Megjithatë, ajo bënte dallimin ndërmjet shpifjes së një individi privat (si tek *Putistin*), reputacioni i të cilit si pjesë e pandarë e reputacionit të familjeve të tyre mbetet brenda sferës së zbatimit të Nenit 8 dhe kritikës legjitime të figurave publike të cilat, duke marrë përsipër role drejtuese, ekspozohen ndaj vëzhgimeve të jashtme. Në rastin e kërkuesit, publikimi nga gazeta e artikullit të parë kishte kontribuar në një debat historik me rëndësi publike, në lidhje me Josif Stalinin dhe rolin e tij të pretenduar në vrasjet e Katynit. Artikulli i dytë kishte të bënte me interpretimin e autorit të konstatimeve të gjykatave të brendshme dhe, në këtë mënyrë, mund të shihej si vazhdim i të njëjtit diskutim. Për më tepër, tragjedia e Katynit dhe rolet dhe përgjegjësitë e pretenduara të figurave historike mbeteshin në mënyrë të paevitueshme të hapura ndaj vëzhgimeve dhe kritikës publike, pasi ato përfaqësonin një çështje me rëndësi të përgjithshme për shoqërinë. Duke ditur që çështjet si kjo në fjalë kërkonin që e drejta e respektimit të jetës private të balancohej me të drejtën e lirisë së shprehjes, Gjykata përsëriti që ishte pjesë e pandarë e lirisë së shprehjes, e garantuar nga neni 10 i Konventës, të kërkohet e vërteta historike. Në pajtim me parimet e mishëruara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, gjykatat e brendshme ishin të mendimit të artikujt kontribuonin në një debat faktik mbi ngjarje me interes dhe rëndësi të veçantë publike, kishin konstatuar që roli historik i Stalinin kërkonte një shkallë të lartë tolerance ndaj vëzhgimit dhe kritikës publike për këtë personalitet dhe

veprimet e tij, dhe kishin marrë parasysh prezantimin tepër emocional të mendimeve të shprehura në artikuj, duke konstatuar që ata gjendeshin brenda kufijve të kritikës së pranueshme. Kështu gjykatat e brendshme kishin gjetur një balancë të drejtë ndërmjet të drejtave të kërkuarit për jetën private dhe lirisë së shprehjes së gazetarëve.

Përfundim: e papranueshme (haptazi e pabazuar).

Respektimi i banesës Respektimi i korrespondencës

Kontrolli dhe sekuestrimi i të dhënave elektronike duke përfshirë postën elektronike që i nënshtrohet raportit konfidencial avokat-klient: *shkelje*

Vinci Construction dhe GTM Génie Civil et Services kundër Francës - 63629/10 dhe 60567/10 Vendimi 2.4.2015 (Seksioni V)

Faktet – Në tetor 2007, gjyqtari i masave të sigurisë tek *tribunal de grande instance* autorizoi Departamentin e Konkurrencës, Çështjeve të Konsumatorit dhe Parandalimit e Mashtrimit (DGCCRF) të kryente inspektime dhe sekuestrime në mjediset e disa shoqërive, duke përfshirë ato të shoqërive kërkuese, si pjesë e një hetimi i praktikave të paramenduara dhe të paligjshme. Gjatë inspektimeve u sekuestruan shumë dokumente dhe skedarë të në kompjuterë, si dhe e gjithë përmbajtja e adresave të postës elektronike të individëve të caktuar të punësuar nga shoqëritë kërkuese. Shoqëritë kërkuese paraqiti secila një kërkesë tek gjyqtari i masave të sigurisë tek *tribunal de grande instance* për të mënjeluar inspektimet dhe, nëse kjo nuk realizohet, për të kërkuar rikthimin e dokumenteve të sekuestruar në mënyrë të paligjshme. Ndërmjet argumenteve të tjerë, ata pretenduan që sekuestrimet në kompjuterë ishin në masë të gjerë dhe pa dallime, dhe shumë nga dokumentet e sekuestruar nuk kishin të bënin me hetimin ose mbuloheshin nga marrëdhënia profesionale konfidenciale avokat-klient dhe në asnjë rast nuk ishte bërë një inventar me hollësitë e mjaftueshme. Ata gjithashtu parashtuan që ata nuk ishin në gjendje të inspektonin përmbajtjen e dokumenteve para sekuestrimit dhe në këtë mënyrë nuk ishin në gjendje t'i kundërshtonin ato. Gjyqtari i masave të sigurisë (JLD) i rrëzoi të gjitha pretendimet e shoqërive kërkuese dhe Gjykata e Kasacionit rrëzoi ankimet e tyre në pikëpamje ligjore.

Ligji – Neni 8: Kontrolli dhe sekuestrimi i të dhënave elektronike, që përbëheshin veçanërisht nga mesazhet elektronike që mbroheshin nga marrëdhënia konfidenciale avokat –klient kualifikoheshin si ndërhyrje në të drejtat e mbrojtura nga Neni 8 i Konventës. Kjo ndërhyrje në mjediset e shoqërive kërkuese dhe konfidencialiteti i korrespondencës së tyre kishte qenë ‘në pajtim me ligjin’ dhe kishte për synim të gjente prova dhe tregues në lidhje me ekzistencën e marrëveshjeve të paligjshme në interesin e ‘mirëqenies ekonomike të vendit’ dhe ‘parandalimit e parregullsisë ose krimi’. Inspektimet synonin marrjen e provave të praktikave të mundshme anti-konkurrese nga

shoqëritë kërkuese dhe si të tilla nuk dukeshin sikur ishin jo-proporcionale për qëllimet e Nenit 8. Përveç kësaj, procedura vendase kishte parashikuar një numër garancish.

Hetuesit ishin përpjekur të kufizonin kontrollet e tyre dhe të sekuestronin vetëm materiale që kishin të bënin me objektin e hetimit të tyre. Përveç kësaj, ishte përpiluar një inventar me hollësi të mjaftueshme, duke treguar emërtimet e dosjeve, referencat e tyre, origjinën dhe shenjat digjitale të gishtave dhe kjo u ishte dorëzuar shoqërive kërkuese, si dhe një kopje e dokumenteve të sekuestruara. Sekuestrimet nuk mund të përshkruhen si ‘masive dhe pa dallim’.

Megjithatë, sekuestrimet kishin të bënin me një numër të madh dokumentesh elektronike, duke përfshirë të gjitha adresat profesionale të postës elektronike të disa punonjësve të shoqërive kërkuese. Ishte e padiskutueshme që këto dokumente dhe adresa të postës elektronike përmbanin një numër dosjesh dhe informacioni të mbuluar nga raporti konfidencial avokat-klient. DGCCRF-ja kishte treguar në mënyrë specifike në parashtrimet e saj tek gjyqtari i masave të sigurisë që nuk kishte kundërshtim për rikthimin e materialeve të mbuluar nga marrëdhënia konfidenciale profesionale.

Për më tepër, ndërsa operacionet në fjalë ishin në kryerje e sipër, shoqëritë kërkuese nuk ishin në gjendje të shihnin përmbajtjen e dokumenteve që sekuestronin ose të diskutonin përshtatshmërinë e sekuestrimit. Duke mos qenë në gjendje të mënjanonin sekuestrimin e dokumenteve që nuk kishin të bënin me hetimin dhe veçanërisht ato që mbuloreshin nga raporti konfidencial avokat-klient, shoqëritë kërkuese duhej të kishin qenë në gjendje të merrnin, *a posteriori*, një vështrim konkret dhe efektiv të ligjshmërisë së tyre. Një ankim si ai i parashikuar nga Neni L.4504 i Kodit Tregtar duhej t’u kishte mundësuar atyre të përftonin, sipas rastit, rikthimin e dokumenteve përkatëse ose një garanci, në lidhje me skedarët kompjuterikë, që ata ishin fshirë në tërësinë e tyre.

Në këtë aspekt, kur një gjyqtari i kërkohet të shqyrtojë pretendimet e arsyetuara që ishin marrë dokumente të identifikuar në mënyrë specifike megjithëse ato nuk kishin të bënin me hetimin ose mbuloreshin nga raporti konfidencial avokat-klient, ai ose ajo duhej të merrte vendim mbi fatin e tyre pas kryerjes së një rishikimi specifik të proporcionalitetit dhe për të urdhëruar, sipas rastit, rikthimin e tyre. Megjithatë, megjithëse shoqëritë kërkuese e kishin ushtruar të drejtën e tyre ligjore për të bërë ankim tek gjyqtari i masave të sigurisë dhe gjyqtari ishte në dijeni që dokumentet e marra nga hetuesit përmbanin korrespondencë nga një avokat, ai kishte shqyrtuar vetëm rregullsinë formale të sekuestrimeve të kundërshtuara, pa shqyrtuar, ashtu siç duhej të kishte bërë, rrethanat faktike në të cilat ato ishin kryer. Në dritën e sa më sipër, sekuestrimet e kryera në mjediset e shoqërive kërkuese, në rrethanat e çështjes, ishin jo-proporcionale me qëllimin që ndiqnin.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi përfundimisht njëzëri që ka patur shkelje të Nenit 6 par 1 i Konventës në lidhje me mungesën e rishikimit gjyqësor efektiv të vendimeve që autorizojnë inspektimet dhe sekuestrimet sipas Nenit 4504, par 6, i Kodit Tregtar.

Neni 41: konstatimi i shkeljes i mjaftueshëm në vetvete në lidhje me çdo dëm jo-financiar; pretendimi për dëmin financiar rrëzohet.

Respektimi i jetës private

Rrjedhja e informacionit nga dosja e hetimeve penale në shtyp: *shkelje*

Apostu kundër Rumanisë - 22765/12 Vendimi 3.2.2015 (Seksioni III)

Faktet – Në vitin 2011, kërkuesi, ish kryetar bashkie, u vendos nën masë arresti për dyshime në lidhje me korrupsion dhe mashtrim. Para nxjerrjes në gjyq, shumë gazeta publikuan informacione dhe dokumente nga dosja hetimore, duke cituar pjesë nga bisedat telefonike dhe duke iu referuar aspekteve të jetës private të kërkuesit që nuk kishin lidhje me gjykimin. Procedimi penal ndaj kërkuesit nuk kishte përfunduar në momentin e Vendimit të Gjykatës Evropiane.

Ligji – Neni 8: Pjesë nga dosja e prokurorisë në lidhje me çështjen e kërkuesit ishin bërë publike para fillimit të fazës së gjykimin me bazë kontradiktoriteti dhe përmbajtja e tyre e kishte vendosur kërkuesin në një pozicion të pafavorshëm, duke dhënë përshtypjen që ai i kishte kryer krimet. Për më tepër, pjesë nga bisedat telefonike ishin të një natyre thjesht private dhe nuk i shërbenin zhvillimit të ndjekjes penale dhe publikimi i tyre nuk përputhej me një nevojë sociale të domosdoshme. Rrjedhja e atij informacioni nga autoritetet përbënte një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private. Sipas ligjit të brendshëm, aksesit publik tek informacioni që gjendet në një dosje të çështjes penale ishte i mundur vetëm pasi çështja të ishte paraqitur në gjykatë, por edhe atëherë ishte i kufizuar dhe i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Megjithatë, në rastin e kërkuesit mundësia që një gjyqtar të vlerësojë nëse një pjesë informacioni duhet t'i deklarohet publikut ishte cenuar pasi ai tashmë i kishte kaluar shtypit. Shteti i paditur kishte dështuar të siguronte ruajtjen e sigurt të informacionit në zotërimin e tij me qëllim që të garantohej e drejta e kërkuesit për të respektuar jetën e tij private ose ti ofroreshin atij mjete mbrojtjeje pas ndodhës së shkeljes së të drejtave të tij.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi gjithashtu një shkelje të aspektit lëndor të Nenit 3 për llogaritë kushteve në të cilat kërkuesi ishte mbajtur në masë arresti.

Neni 41: pretendimi i paraqitur jashtë afatit.

Refuzimi i lejimit të fëmijës për të udhëtuar jashtë shtetit për t'iu bashkuar nënës pa pëlqimin e babait: *shkelje*

Penchevi kundër Bullgarisë - 77818/12 Vendimi 10.2.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Kërkuesi i parë ishte nëna e kërkuetit të dytë, një fëmijë i mitur. Në vitin 2010, pas prishjes së martesës së kërkuetit të parë me babain e fëmijës, kërkuetit e lanë banesën martesore në Bullgari. Kërkuesi i parë më vonë kërkoi pëlqimin e babait për të lejuar të birin e tyre të udhëtonte nga Bullgaria në Gjermani ku kërkuesi i parë po përfundonte një kurs pas-universitar, por ky e refuzoi. Ajo kërkoi një urdhër gjyqësor, por gjykimi, i cili zgjati pothuaj dy vjet dhe dy muaj për të tre shkallët e gjyqësorit, përfundoi me refuzimin e Gjykatës së Lartë të Kasacionit për të lejuar fëmijën të udhëtonte jashtë Bullgarisë vetëm me nënën e tij. Kërkuetit nisën një çështje tjetër në korrik 2012, e cila përfundoi me një vendim në dhjetor 2012, duke e lejuar fëmijën të udhëtonte me nënën e tij.

Ligji – Neni 8: Për kërkuetit, të cilët ishin nëna dhe fëmija, mundësia për të vazhduar të jetonin së bashku ishte një konsideratë themelore që qartazi përfshihej në objektin e jetës së tyre familjare brenda kuptimit të Nenit 8 të Konventës. Refuzimi nga Gjykata e Lartë e Kasacionit dhe koha që iu desh gjykatave për të vendosur në lidhje me çështjen i kishte penguar kërkuetit të qëndronin së bashku ndërsa kërkuesi i parë ndiqte studimet e saj në Gjermani. Kështu kishte patur një ndërhyrje tek e drejta e të dy kërkuetve për mbrojtjen e jetës së tyre familjare. Ndërhyrja ishte ‘në pajtim me ligjin’ pasi kërkohej pëlqimi i të dy prindërve për të gjitha çështjet në lidhje me ushtrimin e të drejtave prindërore, duke përfshirë udhëtimin e fëmijës jashtë shtetit, dhe ajo ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të babait të fëmijës. Kërkesa e pëlqimit të të dy prindërve për çdo lloj dhe kohëzgjatje të udhëtimit jashtë shtetit nga fëmija e tyre nuk dukej se vendoste ndonjë kufizim të paarsyeshëm dhe disproporcional mbi të drejtën e fëmijës për jetën familjare, duke ditur që Shtetit i kërkohet të garantojë një balancë të dejtë ndërmjet interesave konkurruese në fjalë – ato të fëmijës, të të dy prindërve dhe të rendit publik. Gëzimi i ndërsjellë nga fëmija dhe prindërit i shoqërisë së njëri-tjetrit përbën një element thelbësor të jetës familjare sipas Nenit 8 edhe kur raporti ndërmjet prindërve është prishur. Në këtë rast, të dyja gjykatat e shkallëve të ulëta e kishin lejuar udhëtimin e fëmijës jashtë shtetit në mungesë të pëlqimit të babait pas kryerjes së një analize të detajuar të gjendjes familjare dhe pas konstatimit që udhëtimi do të ishte në interesin e lartë të fëmijës.

Vendimet e tyre u prishën nga Gjykata e Lartë e Kasacionit mbi bazën e praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore sipas së cilës leja për udhëtimin e pakufizuar të fëmijës jashtë shtetit me vetëm një prind nuk mund të lejohej. Megjithatë, Gjykata e Lartë nuk mori parasysh rrethanat e çështjes si aftësinë e babait ose të nënës për t'iu kujdesur për fëmijën, elementet e një natyre psikologjike, emocionale, materiale ose mjekësore ose nëse ka patur në ndonjë rrezik real ose specifik për fëmijën, nëse ai udhëtonte me nënën e tij jashtë shtetit. Përveç kësaj, ajo e bazonte vendimin e saj në një gabim teknik të bërë

nga nëna gjatë paraqitjes së kërkesës së saj dhe, në mënyrë më specifike, mos-specifikimin nga ana e saj për të shkruar Gjermaninë si vendin e destinacionit. Përfundimisht, megjithë nxitjen e kërkuesit të parë, ajo refuzoi të përkufizonte kryesisht kufijtë konkretë brenda të cilëve mund të lejohej udhëtimi. Këta faktorë, të marrë së bashku, hedhin dyshim mbi përshtatshmërinë e vlerësimit të Gjykatës së Lartë në lidhje me interesin e lartë të fëmijës. Në këto rrethana, analiza e saj nuk ishte mjaftueshëm e hollësishme dhe qëndrimi i saj ishte tepër formalist. Përveç kësaj, gjykimi i brendshëm kishte zgjatur më shumë se dy vjet dhe tetë muaj. Gjatë gjithë kësaj periudhe, fëmija nuk ishte në gjendje të udhëtonte të bashkohej me nënën e tij. Duke ditur që gjykimi ishte vendimtar për të drejtën për një jetë familjare për të dy kërkuesit sipas Nenet 8 dhe veçanërisht për aftësinë e tyre për të vazhduar jetesën së bashku dhe të gëzojnë praninë e njëri-tjetrit, ai duhej të ishte zhvilluar me një kujdes të veçantë. Duke patur parasysh moshën tepër të re të kërkuesit të dytë dhe lidhjen e tij të ngushtë me kërkuesin e parë, kërkohet një lloj urgjence në trajtimin e kërkesës për udhëtim nga autoritetet e brendshme. Në tërësi, procesi i vendim-marrjes në nivelin e brendshëm ishte vesuar në faktin që Gjykata e Lartë kishte rrëzuar kërkesën për udhëtim për shkak të asaj që dukej shkak formal pa ndonjë analizë të interesave të lartë të fëmijës dhe gjykimi kishte zgjatur shumë.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: 7.500 Euro së bashku për dëmin jo-financiar; 1.101 Euro së bashku në lidhje me dëmin financiar.

Respektimi i jetës private

Respektimi i korrespondencës

Garanci të pamjaftueshme ndaj arbitraritetit të dispozitave të brendshme për përgjimin e fshehtë: *Shkelje*

Dragojević kundër Kroacisë - 68955/11 Vendimi 15.1.2015 (Seksioni I)

Faktet – Në vitin 2007 kërkuesi dyshohej për përfshirje në trafikun e drogës. Me kërkesë të autoriteteve të ndjekjes penale, gjyqtari hetimor autorizoi përdorimin e masave të përgjimit të fshehtë për të monitoruar në mënyrë të maskuar telefonin e kërkuesit. Në vitin 2009 kërkuesi mori fajësi në lidhje me trafikimin e drogës dhe pastrim parash dhe u dënua me nëntë vjet burgim. Dënimi i tij u la në fuqi nga Gjykata e Lartë në vitin 2010 dhe ankimi i tij kushtetues u rrëzua në vitin 2011.

Ligji – Neni 8: Përgjimi i telefonit të kërkuesit përbënte një ndërhyrje tek të drejtat e tij për respektimin e ‘jetës private’ dhe ‘korrespondencës’. Sipas ligjit të brendshëm, përdorimi i mbikëqyrjes së fshehtë i nënshtrohej autorizimit paraprak. Megjithatë, në rastin e

kërkuesit urdhrat e nxjerra nga gjyqtari hetimor bazoheshin vetëm në një deklaram në lidhje me kërkesën e autoriteteve të prokurorisë dhe pohimin që ‘hetimi nuk mund të zhvillohej me mjete të tjera’, pa asnjë informacion nëse ishin të disponueshme mjete më pak ndërhyrëse. Ky qëndrim u miratua nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Në një sferë aq të ndjeshme sa përdorimi i përgjimit të fshehtë, Gjykata e ka të vështirë të pranojë një interpretim të tillë të ligjit të brendshëm, që parashikon një shqyrtim të hollësishtëm paraprak gjyqësor të proporcionalitetit për përdorimin e masave të përgjimit të fshehtë. Anashkalimi i kësaj kërkesë nga gjykatat e brendshme nëpërmjet justifikimit me prapaveprim kishte hapur mundësinë e arbitraritetit dhe nuk mund të parashikonte garanci të përshtatshme dhe të mjaftueshme ndaj abuzimit të mundshëm. Në rastin e kërkuesit, gjykatat penale e kishin kufizuar vlerësimin e tyre të përdorimit të përgjimit të fshehtë në masën përkatëse për pranueshmërinë e provave të marra në këtë mënyrë, pa shkuar tek përmbajtja e kërkesave të Konventës në lidhje me pretendimet për ndërhyrje arbitrare tek të drejtat e kërkuesit sipas Nenit 8. Qeveria nuk kishte dhënë ndonjë informacion për mjetet mbrojtëse që mund të ishin të disponueshme nga një person në situatën e kërkuesit. Kështu, ligji përkatës i brendshëm, siç është interpretuar dhe zbatuar nga gjykatat e brendshme, nuk ishte i qartë në masën e mjaftueshme në lidhje me objektin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit të dhënë autoriteteve publike, dhe jepte garanci të përshtatshme ndaj abuzimit të mundshëm. Për pasojë, procedura për urdhërimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të përgjimit të telefonit të kërkuesit nuk përmbushte kërkesat e ligjshmërisë, dhe nuk ishte e përshtatshme për të realizuar që ndërhyrja tek e drejta e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private dhe korrespondencës të ishte brenda asaj që ishte ‘e nevojshme në një shoqëri demokratike’.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Gjykata nuk konstatoi shkelje të Nenit 6 par 1 në lidhje me mungesën e pretenduar të paanshmërisë të gjykatës së faktit dhe përdorimin e provave të marra nga përgjimi i fshehtë.

Neni 41: 7.500 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Neni 10

Liria e shprehjes

Sanksionet penale dhe disiplinore të vendosura nga avokatin kërkues për shpifje për dëshmitarin ekspert të prokurorisë: e papranueshme

Fuchs kundër Gjermanisë - 29222/11 dhe 64345/11 Vendimi 27.1.2015 (Seksioni V)

Faktet – Kërkuesi është avokat. Gjatë përfaqësimit të një klienti të akuzuar për shkarkimin e materialeve pornografike për fëmijë në kompjuterin e tij ai parashtroi me shkrim para një gjykate të brendshme që eksperti privat i angazhuar nga prokuroria për të deshifruar

skedarët e të dhënave i kishte manipuluar ato me qëllim që të merrte rezultatin e kërkuar nga prokuroria dhe kishte një interes personal në falsifikimin e provave. Eksperti kishte bërë betimin para prezantimit të rezultateve në gjykatë. Eksperti bëri një ankim penal ndaj kërkuarit. Kërkuari u dënua për shpifje dhe u gjobit. Në procedimet disiplinore pasuese, atij iu bë një vërejtje dhe iu vendos një gjobë. Në kërkesën e tij tek Gjykata Evropiane, kërkuari u ankua që masat e marra ndaj tij ishin në shkelje të së drejtave të tij sipas Nenit 10 të Konventës.

Ligji – Neni 10: Gjykata konstatoi që masat kishin qenë në nevojshme në një shoqëri demokratike. Në lidhje me përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e shkaqeve të dhëna nga gjykatat, Gjykata ra dakord me gjykatën penale vendase që mbrojtja e interesave të klientit nuk lejonin që kërkuari të lërë të nënkuptohet, përgjithësisht, që eksperti do të falsifikonte provat. Ajo ra gjithashtu dakord me gjykatën në procedimet disiplinore që deklarimet ofenduese nuk përmbanin ndonjë kritikë objektive për punën e ekspertit në çështjen e klientit të tij, por synonin në zhvlerësimin e punës së tij dhe deklarimin e konstatimeve të tij si të papërdorshme. Gjykata i pranoi përfundimet e gjykatave vendase që deklarimet që përbënin objektin e gjykimit penal dhe disiplinor nuk justifikoheshin nga ndjekja e ligjshme e interesave të klientit. Në lidhje me çështjen e proporcionalitetit, Gjykata vuri re që gjykata penale, në përcaktimin e sanksioneve që duhet të vendosen mbi kërkuarin, mori parasysh faktin që deklarimet e tij nuk ishin bërë publikisht, që ekspertët e betuar duhet të jenë në gjendje të përmbushin detyrat e tyre të lirë nga shqetësimet e panevojshme dhe mund të kërkojë mbrojtjen nga sulmet verbale ofenduese dhe abuzive dhe që gjobat e vendosura në gjykimin penal dhe disiplinor nuk dukeshin si jo-proporcionale.

Përfundim: e papranueshme (haptazi e pabazuar).

Liria për dhënien e informacionit

Detyrimi për dëmshpërblim i portalit të lajmeve në internet për shkak të komenteve ofenduese të postuara në faqen e tij nga palë të treta anonime: *nuk ka shkelje*

Delfi AS kundër Estonia - 64569/09 Vendimi 16.6.2015 (GC)

Faktet – Shoqëria kërkuese kishte në pronësi një prej portaleve më të mëdha të lajmeve në internet në Estoni. Në vitin 2006, pas një publikimi të një artikulli në portal në lidhje me një shoqëri tragetesh, nën këtë artikull u postuan një numër komentesh që përmbanin kërcënime personale dhe gjuhë ofenduese të drejtuar ndaj pronarit të shoqërisë së trageteve. Filloi gjykimi me akuzën e shpifjes ndaj shoqërisë kërkuese, e cila përfundimisht u urdhërua të paguajë 320 Euro dëmshpërblim. Në një Vendim të datës 10 tetor 2013, një Dhomë e Gjykatës konstatoi njëzëri që nuk ka patur shkelje të Nenit 10. Më 17 shkurt 2014, çështja iu paraqit Dhomës së Madhe me kërkesë të shoqërisë kërkuese.

Ligji – Neni 10: Ishte çështja e parë që Gjykatës i duhej të shqyrtonte një ankesë në lidhje me aktivitetin shprehës të gjeneruar nga përdoruesi në internet. Duke njohur përfitimet e rëndësishme që mund të përftohen nga interneti në ushtrimin e lirisë së shprehjes, Gjykata përsëriti që përgjegjësia për shprehje shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme, në parim, duhet të mbahet dhe përbën një mjet efektiv për shkeljen e të drejtave të personalitetit. Për më tepër, Gjykata vuri re që, në këtë çështje, komentet e kundërshtuara përbënin shprehje të urrejtjes dhe nxitje të drejtpërdrejtë për dhunë, që portali i lajmeve të shoqërisë kërkuese ishte një nga mediat më të mëdha të internetit në vend dhe që ka patur shqetësim publik në lidhje me natyrën kontroversale të komenteve që kishte shkaktuar. Kështu, objekti i shqyrtimit të çështjes ishte e kufizuar në vlerësimin e ‘detyrave dhe përgjegjësive’ të portaleve të lajmeve në internet, nën dritën e Nenit 10 par 2, nëse ato ofronin me qëllime fitim-prurëse një platformë për komente të gjeneruara nga përdoruesit mbi informacione të publikuara më parë dhe disa përdorues angazhoheshin në mënyra shprehjeje haptazi të paligjshme. Gjykata ishte e bindur që instrumentet ligjore të brendshëm e bënin të parashikueshme që një publikues i medias që administron një portal lajmesh në internet për qëllime fitim-prurëse, në parim, mund të mbahet përgjegjës sipas ligjit të brendshëm për ngarkimin e komenteve qartësisht të paligjshme në portalin e tij. Si publikues profesionist, shoqëria kërkuese faktikisht ishte në gjendje të vlerësonte rrezikun në lidhje me aktivitetet e saj dhe duhet të ketë qenë në gjendje të parashikonte pasojat ligjore që mund të shkaktonin këto. Kështu, ndërhyrja në fjalë ishte ‘parashikuar me ligj’ brenda kuptimit të Nenit 10 të Konventës. Në lidhje me domosdoshmërinë e ndërhyrjes në lirinë e shoqërisë për dhënien e informacionit, Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë natyrës profesionale dhe tregtare të portalit të lajmeve të kërkuesit dhe faktit që ajo kishte një interes ekonomik në vendosjen e këtyre komenteve. Për më tepër, vetëm shoqëria kërkuese kishte mjetet teknike për të modifikuar ose fshirë komentet e publikuara në portalin e lajmeve. Duke patur parasysh këto, angazhimi i shoqërisë kërkuese në bërjen publike të komenteve mbi artikujt e veta në portal shkoi tej asaj të një ofruesi shërbimi pasiv, thjesht teknik. Ndërsa në lidhje me çështjen nëse detyrimi i autorëve faktikë të komenteve mund të shërbente si alternativë për detyrimin e portalit të lajmeve në internet, Gjykata kujtoi që anonimiteti në internet, megjithëse është një vlerë e rëndësishme, duhej të balancohej me interesat dhe të drejtat e tjera. Në arritjen e këtij përfundimi, ajo kishte parasysh interesat e përdoruesve të internetit që nuk zbulojnë identitetin e tyre, por vuri në dukje edhe efektet tepër negative të një shpërndarjeje të pakufizuar të informacionit të internetit. Në këtë aspekt, Gjykata iu referua një Vendimi në të cilin Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian (GJDBE) kishte konstatuar që të drejtat themelore të individit, si rregull, mbizotëronin mbi interesat ekonomike të operatorëve të makinerive të kërkimit dhe interesat e përdoruesve të tjerë të internetit. Për më tepër, interneti jepte mundësi për shkallë të ndryshme të anonimitetit, dhe ofruesit e shërbimit ndonjëherë janë të vetmit në gjendje të identifikojnë përdoruesit e internetit që dëshirojnë të mbeten anonimë përkundërit publikut. Në këtë çështje, efektiviteti i pasigurt i masave që lejojnë konstatimin e identitetit të autorëve të komenteve, e përforcuar kjo me mungesën e instrumenteve të

ofruara nga portali i internetit për të bërë të mundur që një viktimë e shprehjeve të urrejtjes të paraqesë efektivisht një pretendim ndaj autorëve të komenteve është në mbështetje të mendimit të gjykatave të brendshme që personi i dëmtuar duhet të kishte zgjedhjen e ngritjes së një pretendimi ndaj shoqërisë kërkuese ose autorëve të komenteve. Në lidhje me masat e marra nga shoqëria kërkuese për trajtimin e publikimeve të komenteve të paligjshme në portalin e vet, një detyrim i portaleve të mëdha të lajmeve për marrjen e masave efektive për të kufizuar shpërndarjen e shprehjeve të urrejtjes dhe shprehjeve që nxisin dhunë nuk mund të barazohen me 'censurën private'. Faktikisht, aftësia e një viktime potenciale e këtyre shprehjeve për të monitoruar vazhdimisht internetin ishte më e kufizuar se aftësia e një portali të madh lajmesh në internet për qëllime fitimprurjeje për të parandaluar ose hequr komentet e paligjshme. Pavarësisht mekanizmave të caktuara aktualisht në fuqi për të trajtuar këto komente të cilat kualifikohen si shprehje urrejtjeje ose shprehje që nxisin dhunë në faqen e internetit të shoqërisë kërkuese, të cilat mund të funksionojnë në shumë raste si një mjet i përshtatshëm për balancimin e të drejtave dhe interesave të përfshirë, ato ishin të pamjaftueshme në rrethanat specifike të çështjes, pasi komentet e paligjshme kishin mbetur në këtë faqe për gjashtë javë. Përfundimisht, një sanksion prej 320 Euro i vendosur ndaj shoqërisë kërkuese nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë jo-proporcionale për shkeljen e konstatuar nga gjykatat e brendshme. Po ashtu, nuk duket sikur shoqëria kërkuese duhet të ndryshonte modelin e biznesit të saj si rezultat i gjykimeve të brendshme. Nga sa më sipër rrjedh që caktimi nga gjykatat e brendshme e detyrimin mbi shoqërinë kërkuese është i bazuar në shkaqe të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe nuk përbënte një kufizim jo-proporcional të të drejtës së lirisë së shprehjes.

Përfundim: nuk ka shkelje (pesëmbëdhjetë vota me dy).

Liria për marrjen e informacionit

Liria për dhënien e informacionit

Mosrespektimi nga kryetari i bashkisë i vendimeve përfundimtare që i jepnin kërkuesit të drejtën e aksesit në informacion: *shkelje*

Guseva kundër Bullgarisë - 6987/07 Vendimi 17.2.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Kërkuësja, anëtar dhe përfaqësues i një shoqate aktive në sferën të mbrojtjes së të drejtave të kafshëve, realizoi re vendime përfundimtare të Gjykatës së Lartë Administrative që i kërkoni kryetarit të bashkisë t'i jepte asaj informacion në lidhje me trajtimin e kafshëve pa zot që gjendeshin në rrugët e qytetit ku ai ushtronte detyrën. Kryetari i bashkisë nuk i respektoi vendimet. Në kërkesën e saj në Gjykatën Evropiane, kërkuesja u ankua sipas Nenit 10 të Konventës që sjellja e kryetarit të bashkisë ishte në shkelje të të drejtës së saj për të marrë dhe dhënë informacion.

Ligji – Neni 10: Kërkuësja kishte kërkuar akses në informacionin në lidhje me trajtimin e kafshëve për të ushtruar rolin e saj në informimin e publikut në lidhje me këtë çështje me interes të përgjithshëm dhe për të kontribuar në debatin publik. Ekzistenca e së drejtës së saj për të aksesuar këtë informacion ishte njohur nga legjislacioni i brendshëm dhe në tre vendime të formës së prerë të Gjykatës së Lartë Administrative. Kështu, marrja e informacionit me qëllim dhënien e tij të mëvonshme publikut përfshihej në sferën e lirisë së shprehjes. Megjithëse kërkuësja e kishte paraqitur kërkesën në cilësinë e saj private dhe jo në emër të shoqatës që ajo përfaqësonte, informacioni që ajo kërkonte te merrte ishte në lidhje të drejtpërdrejtë me punën e saj në shoqatë. Për pasojë, ajo ishte përfshirë në mbledhjen legjitime të informacionit për interes publik me qëllim dhënien e kontributit në debatin publik. Kështu, mosveprimi i kryetarit të bashkisë në pajtim me vendimet përfundimtare të gjykatave dhe t'i jepte asaj informacion përbënte një ndërhyrje të drejtpërdrejtë në të drejtën e saj për marrjen dhe dhënien e informacionit. Në momentin përkatës vendimet kishin marrë formë të prerë dhe ishin të ekzekutueshëm sipas ligjit të brendshëm dhe mosrespektimi i tyre nga kryetari i bashkisë ishte i paligjshëm. Megjithatë, praktika gjyqësore e brendshme pranonte që ligji i brendshëm nuk parashikonte ndonjë afat kohor të qartë për ekzekutimin duke ia lënë çështjen vullnetit të mirë të organit administrativ përgjegjës për zbatimin e vendimit. Një mungesë e tillë e një afati të qartë për ekzekutimin krijonte pasiguri në lidhje me momentin e mundshëm të ekzekutimit që, në rastin e kërkuësës, nuk është materializuar asnjëherë. Legjislacioni i brendshëm i zbatueshëm nuk e kishte parashikueshmërinë e duhur që rezulton në ndërhyrje tek të drejtat e kërkuësës sipas Neni 10 të cilat nuk janë “parashikuar me ligj”.

Përfundim: shkelje (pesë vota me dy).

Gjykata konstatoi gjithashtu një shkelje të Neni 13 të lexuar në lidhje me Nenin 10 pasi nuk kishte mjete efektive të përshtatshme për të siguruar zhdëmtim në lidhje me ankesën e kërkuësës dhe për të ofruar mundësi të arsyeshme suksesi.

Neni 41: 5.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Liria e shprehjes

Fajësimi i avokatit për bashkëpunim me një gazetë në shpifjen për një gjyqtar: shkelje

Morice kundër Francës - 29369/10 Vendimi 23.4.2015 (GC)

Faktet – Në vitin 1995 Bernard Borrel, një gjyqtar i cili ishte komanduar në kontekstin e bashkëpunimit ndërmjet Francës dhe Xhibutit, u gjet i vdekur. Hetimi nga xhandarmeria e Xhibutit në ditët që pasuan nxori përfundimin që ai kishte kryer vetë-vrasje. E veja e tij, duke kundërshtuar konstatimin e vetë-vrasjes, bëri ankim si palë civile dhe caktoi kërkuësin ta përfaqësonte atë në gjykim. Dy hetime gjyqësore u hapën në lidhje me

vrasjen me paramendim të kryer nga një person ose persona të panjohur. Hetimi gjyqësor iu caktua gjyqtarëve hetimorë M. Dhe L.L., Në qershor 2000, Divizioni i Akuzave të Gjykatës së Apelit i largoi këta gjyqtarë nga çështja dhe ia kaloi atë një gjyqtari të ri hetimor, Gjyqtari P. Menjëherë pas kësaj, i njëjti Divizion pranoi një kërkesë nga kërkuesi për tërheqjen e çështjes së profilit të lartë “Scientology” nga gjyqtari M.

Në shtator 2000, kërkuesi dhe një prej kolegëve të tij i shkroi Ministrit francez të Drejtësisë në lidhje me hetimin gjyqësor për vdekjen e Gjyqtarit Borrel. Ata deklaruan që po i drejttoheshin Ministrit edhe një herë në lidhje me sjelljen e Gjyqtarëve M. dhe L.L. që ishte ‘tërësisht në kundërshtim me parimin e paanësisë dhe drejtësisë’ dhe ata kërkuan që të kryhej një hetim nga Inspektorati i Përgjithshëm i Shërbimeve Gjyqësore për ‘mangësitë e shumta ... të nxjerra në pah në kuadrin e hetimit gjyqësor’. Ditën tjetër një artikull në gazetën *Le Monde* deklaroi që avokatët e Zj Borrel kishin ‘kritikuar me forcë’ Gjyqtarin M. tek Ministri i Drejtësisë, duke e akuzuar atë veçanërisht për sjelljen që ishte ‘tërësisht në kundërshtim me parimin e paanësisë dhe drejtësisë’ dhe duke shtuar që ajo nuk kishte regjistruar një element të dosjes së çështjes dhe nuk ia kishte transmetuar pasuesit të saj. Të gjyqtarët bënë ankim penal si palë civile kundër drejtorit të publikimeve të *Le Mode*, gazetari i cili kishte shkruar artikullin dhe Z Morice, duke i akuzuar ata për veprën penale të shpifjes publike ndaj një punonjësi të shërbimit publik. Kërkuesit iu dha fajësia e bashkëpunimit në atë vepër penale nga Gjykata e apelit dhe iu caktua të paguante një gjobë prej 4.000 Euro. Shuma prej 7.500 Euro si kompensim dëmi iu dha secili prej gjyqtarëve, e cila duhej të paguhej nga kërkuesi së bashku me dy të pandehurit e tjerë. Në një vendim të datës 11 korrik 2013, një Dhomë e Gjykatës konstatoi, gjashtë me një votë, që nuk ka patur shkelje të Neni 10. Më 9 dhjetor 2013, çështja iu kalua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit (shih Shënim Informativ 169).

Ligji – Neni 10: Fajësimi i kërkuesit përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tij të lirisë së shprehjes, që garantohet nga Neni 10 i Konventës. Ndërhyrja ishte parashikuar nga ligji dhe qëllimi i tij ishte mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve. Në dënimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit ishte e mendimit që thjesht fakti i thënies që sjellja e një gjyqtari hetimor ishte ‘tërësisht në kundërshtim me parimin e paanësisë dhe drejtësisë’ ishte një akuzë vepër shpifëse. Ajo gjykatë kishte shtuar që komentet e kërkuesit në lidhje me vonesën në paraqitjen e video-kasetës dhe referenca e tij e kartës së shkruar me dorë nga prokurori publik i Xhibutit për Gjyqtarin M., në lidhje me të cilën kërkuesi kishte përdorur termin ‘pranim heshturazi’, konfirmonin thjesht natyrën shpifëse të akuzave, ku ‘vërtetësia’ e akuzave nuk është vërtetuar dhe parashtrimi i mirëbesimit nga kërkuesi u rrëzua.

(a) *Statusi i kërkuesit si avokat* – Ndërsa nuk ishte e diskutueshme që vërejtjet e kundërshtuara përfshiheshin në kontekstin e gjykimit, ato kishin si objektivi gjyqtarët hetimorë, të cilët ishin larguar nga gjykimi me formë të prerë në momentin kur ato u bënë. Kështu që deklarimet e tij nuk mund të kishin kontribuar drejtpërdrejt në detyrën e tij për mbrojtjen e klientit të tij, meqenëse hetimi gjyqësor në atë kohë i ishte besuar një gjyqtari tjetër i cili nuk ishte objekt i kritikës.

(b) *Kontribut për një debat për një çështje me interes publik* – Vërejtjet e kundërshtuara të kërkuarit, të cilat kishin të bënin me funksionimin e gjyqësorit, një çështje me interes publik, dhe trajtimi i çështjes Borrel – e cila kishte tërhequr vëmendje të konsiderueshme nga media – ishte përfshirë brenda kontekstit të një debati me interes publik, duke kërkuar kështu një nivel më të lartë mbrojtjeje të lirisë së shprehjes, duke u lënë përkatësisht autoriteteve një marzh tepër të ngushtë diskrecioni.

(c) *Natyra e vërejtjeve të kundërshtuara* – Deklarimet e kundërshtuara ishin më shumë gjykime vlerësimi se sa deklarime fakti, në këndvështrimin e tonit të përgjithshëm të vërejtjeve dhe kontekstit në të cilin ato ishin bërë, pasi ato kishin reflektuar kryesisht një vlerësim të përgjithshëm të sjelljes së gjyqtarëve hetimorë në kuadrin e hetimit.

‘Baza faktike’ e atyre gjykimeve vlerësuese ishte e mjaftueshme. Mosdhënia nga gjyqtari i video-kasetës jo vetëm që ishte vërtetuar por ishte aq e rëndësishme sa që ajo të regjistrohej nga Gjyqtari P. në dosje. Në lidhje me kartën e shkruar me dorë, përveç faktit që ajo tregonte miqësi nga ana e prokurorit publik të Xhibutit kundrejt Gjyqtarit M., akuzonte avokatët e palëve civile ‘me orkestrimin e manipulimit të tyre’.

Po ashtu, ishte një fakt i vërtetuar që kërkuari kishte vepruar në cilësinë e tij si avokat në dy çështje të profilit të lartë në të cilat Gjyqtari M. ishte një gjyqtar hetimor. Në të dy prej tyre kërkuari ia kishte dalë në marrjen e konstatimeve nga gjykata e apelit që kishte patur mangësi në gjykim, duke sjellë për pasojë heqjen e çështjeve nga Gjyqtari M.

Për më tepër, ka patur lidhje mjaft të afërta ndërmjet shprehjeve të përdorura nga kërkuari dhe fakteve të çështjes dhe vërejtjet e tij nuk mund të konsideroheshin si të gabuara ose si një sulm pa bazë.

(d) *Rrethanat specifike të çështjes*

(i) *Nevoja për të marrë parasysh të gjitha të dhënat paraprake* – Të dhënat paraprake të çështjes mund të shpjegoheshin jo vetëm nga sjellja e gjyqtarëve hetimorë dhe nga marrëdhëniet e kërkuarit me një prej tyre, por edhe nga historiku tepër specifik i çështjes, dimensionin e saj ndër-Shtetëror dhe mbulimi thelbësor nga media. Megjithatë, Gjykata e Apelit i kishte kushtuar një mbulim të gjerë vërejtjeve të kundërshtuara të kërkuarit i cili kritikonte një gjyqtar hetimor për ‘sjellje e cila (ishte) tërësisht në kundërshtim me parimet e paanësisë dhe drejtësisë’, ndërsa ky citim duhej të vlerësohej në dritën e rrethanave specifike të çështjes, veçanërisht pasi në realitet nuk ishte një deklaratë e bërë për autorin e artikullit, por një pjesë nga një letër e dërguar nga kërkuari dhe kolegu i tij Ministrit të Drejtësisë. Përveç kësaj, Në momentin kur kërkuari iu përgjigj pyetjeve të tij, gazetari ishte informuar në lidhje me letrën drejtuar Ministrit nga burimet e veta. Autori i artikullit ishte përgjegjës vetëm për referencën tek procedimi disiplinor ndaj Gjyqtarit M. në kontekstin e çështjes “Scientology”. Avokatët nuk mund të bëheshin përgjegjës për gjithçka që shfaqej në një ‘intervistë’ të publikuar

nga shtypi ose për veprimet e shtypit. Gjykatës së Apelit i duhej të shqyrtonte vërejtjet duke marrë parasysh tërësisht të dhënat paraprake të çështjes dhe kontekstin e letrës, të marrë si një e tërë. Përdorimi i termit ‘pranim heshturazi’ nuk mund të përbënte ‘në vetvete’ një sulm serioz mbi nderin dhe reputacionin e Gjyqtarit M. dhe prokurorit publik të Xhibutit.

Përveç kësaj, deklaratimet e kërkuesit nuk mund të reduktoheshin thjesht në një shprehje të një raporti antagonist me Gjyqtarin M. Vërejtjet e kundërshtuara ishin pjesë e një iniciative profesionale të dy avokatëve mbështetur në faktet të cilat ishin të reja, të vërtetuara dhe në gjendje për të treguar mangësi serioze në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë dy gjyqtarë të cilët më parë kishin zhvilluar hetime në një çështje në të cilën klientët e avokatëve ishin palë civile.

Ndërsa vërejtjet e kërkuesit natyrisht që kishin një konotacion negativ, duhej të vihej në dukje që pavarësisht natyrës së tyre disi armiqësore dh seriozitetit, çështja kryesore në deklarime kishte të bënte me funksionimin e hetimit gjyqësor, e cila është një çështje me interes publik, duke lënë kështu pak vend për kufizime për lirinë e shprehjes. Përveç kësaj, një avokat duhet të jetë në gjendje të tërheqë vëmendjen e publikut për mangësi të mundshme në sistemin e drejtësisë dhe gjyqësori mund të përfitojë nga kritika konstruktive.

- (ii) *Ruajtja e autoritetit të gjyqësorit* – Gjyqtarët M. dhe L.L. ishin anëtarë të gjyqësorit dhe në këtë mënyrë iu nënshtroheshin kufijve më të gjerë të kritikës së pranueshme se qytetarët e zakonshëm dhe komentet e kundërshtuara mund të drejtoheshin ndaj tyre në këtë cilësi.

Përveç kësaj, vërejtjet e kërkuesit nuk ishin në gjendje të minonin zhvillimin e duhur të gjykimin, duke patur parasysh faktin që gjykata më e lartë e kishte tërhequr çështjen nga dy gjyqtarët hetimorë të cilët prekeheshin nga kritikata.

Për të njëjtat arsye dhe duke marrë parasysh sa më sipër, dënimi i kërkuesit nuk mund të shërbente për ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit.

- (iii) *Përdorimi i mjeteve të disponueshme* – Referimi tek Divizioni i Akuzave të Gjykatës së Apelit kishte treguar haptazi që synimi fillestar i kërkuesit dhe kolegut të tij ishte zgjidhja e çështjes duke përdorur mjetet ligjore të disponueshme. Në realitet, vetëm pas përdorimit të këtij mjeti kishte ndodhur problemi për të cilën është bërë ankesa, siç është regjistruar nga gjyqtari hetimor P. në dosje. Në këtë fazë, Divizioni i Akuzave nuk ishte më në gjendje të shqyrtonte ankesa të tilla, specifikisht pasi ai e kishte tërhequr çështjen nga Gjyqtarët M. dhe L.L. Sidoqoftë, kishin kaluar katër vjet e gjysmë qysh nga hapja e hetimit gjyqësor, i cili nuk kishte përfunduar akoma në momentin e vendimit të Gjykatës. Nga ana e tyre, palët civile dhe avokatët e tyre kishin qenë aktivë në gjykim.

Për më tepër, kërkesa e Ministrisë të Drejtësisë për një hetim në faktet e reja nuk përbënte një mjet gjyqësor – të tillë që të justifikojë eventualisht heqjen dorë nga

ndërhyrja në shtyp – por thjesht një kërkesë për një hetim administrativ që i nënshtrohet diskrecionit të Ministrit.

Së fundmi, as Kryeprokurori Publik, as Këshilli përkatës i Dhomës së Avokatisë apo kryetari i Dhomës Avokatisë nuk e panë të nevojshme të nisnin procedim disiplinor ndaj kërkuesit në lidhje me deklaratimet e tij në shtyp, megjithëse një mundësi e tillë ishte e hapur për ta.

(iv) *Përfundimi në lidhje me rrethanat e çështjes* – Vërejtjet e kundërshtuara të kërkuesit nuk përbënin ndonjë sulm me dëm serioz apo thelbësisht të pabazuar në lidhje me veprimet e gjykatave, por kritika ishte e përqendruar tek Gjyqtarët M. dhe L.L., si pjesë e një debati për një çështje me interes publik në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe në kontekstin e një çështjeje që kishte tërhequr mbulim të gjerë nga media qysh nga fillimi. Ndërsa pranohet që këto vërejtje mund të konsideroheshin si të ashpra, megjithatë ato konsistonin në gjykime vlerësuese me ‘bazë faktike’ të mjaftueshme.

(e) *Sanksionet e vendosura* – Kërkuesi ishte urdhëruar të paguante një gjobë prej 4.000 Euro dhe, së bashku me dy të pandehurit e tjerë, 7.500 Euro si zhdëmtim për secilin prej dy gjyqtarëve të cilët kishin paraqitur ankim si palë civile. Kështu, sanksioni i vendosur mbi të nuk ishte ‘më i lehti i mundshëm’, por, përkundrazi, i konsiderueshëm, dhe statusi i tij si avokat ishte përdorur për të justifikuar ashpërsi më të madhe.

Parë sa më sipër, Vendimi ndaj kërkuesit për bashkëpunim në shpifje mund të konsiderohej si një ndërhyrje jo-proporcionale në të drejtën e tij të shprehjes dhe nuk kishte qenë ‘e nevojshme në një shoqëri demokratike’ në kuptimin e Nenit 10 të Konventës.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Gjykata konstatoi gjithashtu një shkelje të Nenit 6 par 1 në lidhje me ankimin e kërkuesit që, para Gjykatës së Kasacionit, çështja e tij nuk i ishte nënshtuar një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e paanshme, duke patur parasysh praninë në trupin gjykues të një gjyqtari i cili kishte shprehur paraprakisht dhe publikisht mbështetjen për një prej palëve civile. Frika e kërkuesit në lidhje me mungesën e paansësisë mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar.

Neni 41: 15.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar; 270 Euro në lidhje me dëmin financiar.

NENI 13

Mjet i efektshëm

Mungesa e mjeteve të brendshme për të përshpejtuar gjykimin në lidhje me kontaktet me prindërit: *shkelje*

Kuppinger kundër. Gjermanisë - 62198/11 Vendimi 15.1.2015 (Seksioni V)

Faktet – Në kërkesën e tij në Gjykatën Evropiane, kërkuesi u ankua, ndërmjet të tjerash, për kohëzgjatjen e gjykimit të brendshëm që ai kishte nisur për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor që i jepte atij të drejtën e vizitës me fëmijën e tij dhe për mungesën e një mjeti efektiv për të përshpejtuar zbatimin e atij vendimi (Neni 13 i Konventës në lidhje me Nenin 8). Ai u ankua gjithashtu në bazë të Nenit 8 që gjoba prej 300 Euro e vendosur nga gjykatat e brendshme për nënën e fëmijës pas refuzimit të saj të përsëritur për të përmbushur një vendim që i jepte atij të drejtën e vizitës ishte tepër e ulët për të patur efekt detyrues.

Ligji – Neni 8: Gjykatat e brendshme kishin vendosur një gjobë administrative për nënën, pasi asnjë prej gjashtë vizitave që ishin vendosur nga një vendim paraprak nuk kishin ndodhur sipas planifikimit. Megjithatë Gjykata nuk kishte informacion në lidhje me gjendjen financiare të nënës, ajo nuk kishte si të mos vinte re që një gjobë e përgjithshme prej 300 Euro dukej tepër e ulët, duke ditur që ligji i zbatueshëm lejonte vendosjen e një gjobe deri në 25 000 Euro për secilin rast të mos-përmbushjes. Pra ishte e dyshimtë nëse sanksioni mund të pritej që normalisht të kishte efekt detyrues për nënën, e cila kishte mënjeluar në mënyrë të përhershme kontaktin ndërmjet kërkuetit dhe fëmijës. Përveç kësaj, gjykimi i ekzekutimit kishte zgjatur më shumë se dhjetë muaj ndërmjet datës që kërkuesi kërkoi fillimisht caktimin e një gjobe deri sa gjoba u pagua. Një numër vonesash u takojnë gjykatave të brendshme. Autoritetet kishin dështuar në marrjen e masave të efektshme për të ekzekutuar vendimin paraprak për vizitat të majit 2010.

Përfundim: *shkelje* (njëzëri).

Gjykata në mënyrë unanime nuk gjeti shkelje të Nenit 8 të lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit të mëtejshëm për të drejtën e vizitës ose rishikimin e rregullimit të vizitave. Neni 13 në lidhje me Nenin 8: Qeveria kishte argumentuar që kërkuesi mund të kishte ngritur padi për kompensim në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit sipas Ligjit të Gjykimeve dhe Hetimeve Penale të Tejzgjatura të vitit 2011 (“Ligji i Mjeteve të Mbrojtjes”). Gjykata përsëriti që një mjet mbrojtës do të jetë normalisht ‘i efektshëm’ brenda kuptimit të Nenit 13 në çështjet në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit nëse mund të përdoret për të përshpejtuar një vendim nga gjykatat që trajtojnë çështjen ose mund t’i japë palës kompensim të mjaftueshëm për vonesat që kanë ndodhur. Megjithatë, në gjykimet në të cilat kohëzgjatja e gjykimit ka një ndikim të qartë në jetën familjare të kërkuetit kërkohet një qëndrim më rigoroz dhe kjo i detyron Shtetet të krijojnë mundësinë e një mjeti mbrojtës i cili është në të njëjtën kohë parandalues dhe

kompensues. Detyrimi pozitiv i Shtetit për të marrë masa të përshtatshme për të siguruar respektimin e jetës familjare do të rrezikonte të bëhej iluzive nëse gjithçka që ofrohet është një mjet mbrojtës i cili çon në dhënien *a posteriori* të kompensimit monetar. Gjykimi në rastin e kërkuarit kishte të bënte me të drejtën e kërkuarit për të kontaktuar fëmijën e tij të vogël dhe në këtë mënyrë futej në kategorinë e çështjeve që rrezikonin të paracaktoheshin nga kohëzgjatja e tyre. Pra duhet të përcaktohet nëse ligji gjerman parashikonte një mjet mbrojtës i cili jep jo vetëm kompensim monetar, por të jetë i efektshëm për të përshpejtuar gjykimin para gjykatës së çështjeve familjare. Ligji i Mjeteve Mbrojtëse kishte hyrë në fuqi vetëm një vit e gjysmë pas fillimit të gjykimin për të drejtën e vizitës. Përveç kësaj, Gjykata nuk ishte e bindur që mjeti i mundshëm kompensues që ai parashikon mund të konsiderohet sikur të ketë efekt përshpejtues të mjaftueshëm për gjykimet e filluara në çështjet në lidhje me të drejtat e vizitës së prindërve me fëmijët e vegjël. Në këtë mënyrë ligji nuk përmbush kërkesat specifike për një mjet mbrojtës të destinuar për të përmbushur detyrimet e Shtetit sipas Nenit 8 në gjykime të tilla. Asnjë prej të dy mjeteve mbrojtëse që ishin sugjeruar nga Qeveria nuk mund të konsideroheshin si të efektshme.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Ankimi i kërkuarit për kohëzgjatjen e gjykimin sipas Nenit 6 par 1 të Konventës u deklaruar e papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve ligjore të brendshme pasi kërkuari mund të kishte kërkuar kompensimin e drejtë sipas Ligjit të Mjeteve Mbrojtëse pas hyrjes së tij në fuqi. Gjykata kishte konstatuar më parë që Ligji ishte në parim në gjendje për të dhënë kompensim të përshtatshëm për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Neni 41: 15.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Neni 1 Protokolli 1

Detyrime pozitive: mos-mbrojtja e nga Shteti i të drejtave pasurore të të miturve në një kontratë këmbimi të pasurive të patundshme: shkelje

S.L. dhe J.L. kundër Kroacisë - 13712/11 Vendimi 7.5.2015 (Seksioni I)

Faktet – Në vitin 1997, kërkuarët, dy të motra të mitura, të përfaqësuar nga nëna e tyre, blenë një vilë për 60.000 Euro. Nëna Z.L., e cila ishte kujdestare ligjore e kërkuarëve, dhe babai i kërkuarës së dytë investuan 40.000 Euro në rinovimin e pronës.

Në tetor 2001, Z.L. u dënua me gjashtë vjet burg dhe familja përjetoi vështirësi financiare. Avokati i Z.L.-së kërkoi autorizim nga Qendra e Mirëqenies Social për një marrëveshje shkëmbimi të pasurisë së patundshme sipas së cilës vila mund t'i kalohej vjehrrës së avokatit për një hyrje në palla me vlerë rreth 55.000 Euro. Kërkuarët duhej të merrnin edhe 5.000 Euro kompensim për diferencën në vlerën ndërmjet dy pronave.

Qendra e dha autorizimin – i cili kërkohej pasi kërkuetit, të cilat ishin pronare të vilës, ishin akoma të mitura – pas intervistimit të nënës. Pronat u shkëmbyen në dhjetor 2001. Më vonë kërkuetit ngritën padi civile për anulimin e marrëveshjes së këmbimit për shkak se Qendra e Mirëqenies Sociale nuk kishte marrë parasysh vlerën e pasurive dhe natyrën e rrethanave të tyre familjare, veçanërisht ndalimin e Z.L.-së dhe abuzimin me drogë nga ana e nënës. Kjo padi dhe ankimet e mëvonshme të kërkuetëve u rrëzuan për shkak se vendimi i Qendrës mund të kundërshtohet vetëm në një shqyrtim administrativ.

Ligji – Neni 1 i Protokollit nr. 1: Gjykatës iu kërkuat të vendoste nëse Shteti nuk kishte marrë parasysh si duhet interesat e lartë të fëmijëve kërkuet dhe nuk kishte mbrojtur të drejtat e tyre pasurore. Shqetësimi fillestar kishte të bënte me vlerën faktike relative të pronave të këmbyerat, meqenëse gjykatat vendase nuk kishin shpjeguar se si vlera e vilës (100.000 Euro) mund të përputhej me atë të një apartamenti (55.000 Euro).

Në lidhje me sjelljen e Qendrës së Mirëqenies Sociale, i vemi veprim që ajo kishte ndërmarrë për të vlerësuar rrethanat e çështjes ishte intervistomi i së ëmës. Asnjë nga kujdestarët e tjerë ligjorë nuk u intervistuan ose informuan në lidhje me projekt marrëveshjen e këmbimit. Për më tepër, Qendra normalisht do të pritej të vlerësonte gjendjen faktike ose vlerën e pronave të këmbyerat, por nuk e kishte bërë këtë. Megjithatë, megjithëse ishte në dijeni të burgosjes së Z.L.-së dhe problemeve financiare të familjes, ajo nuk e kishte trajtuar gjendjen familjar të kërkuetëve me kujdesinë nevojshëm në kuptimin e vlerësimit nëse interesat pasurore të kërkuetëve ishin mbrojtur si duhet ndaj veprimeve neglizhente dhe/ose keqdashëse të prindërve të tyre. Qendra nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të marrë informacione të tjera mbi situatën familjare ose për të vlerësuar nëse duhej të caktohej një kujdestar i posaçëm për të mbrojtur interesat e kërkuetëve. Në tërësi, jo nuk kishte vlerësuar nëse marrëveshja e këmbimit ishte në interesin më të lartë të kërkuetëve si fëmijë.

Përveç kësaj, i vetmi mjet i diponueshëm për kërkuetit ishte ngritja e një pretendimi civil në gjykatat civile, Megjithatë, gjykatat civile nuk kishin shqyrtuar rrethanat specifike të çështjes dhe e rrëzuan padinë civile të kërkuetëve vetëm për shkak se vendimi i Qendrës i cili autorizonte marrëveshjen e këmbimit nuk ishte kundërshtuar në një shqyrtim administrativ. Duke vepruar kështu, ato injoruan provat në lidhje me konfliktin e mundshëm të interesit, rrethanat familjar dhe financiare të kërkuetëve dhe pretendimet që Qendra nuk kishte mbrojtur interesat më të larta të kërkuetëve, kur i takonte asaj sipas ligjit të brendshëm të shqyrtonte pretendimet me kujdes në pajtim me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Autoritetet e brendshme nuk kishin marrë masat e nevojshme për të garantuar interesat pasurore të kërkuetëve, si fëmijë, në marrëveshjen e kundërshtuar të këmbimit të pasurive të paluajtshme dhe nuk u kishte dhënë atyre një mundësi të arsyeshme për të kundërshtuar efektivisht masat që ndërhyjnë në të drejtat e tyre të garantuara nga Neni 1 i Protokollit nr. 1.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: rezervuar.

NENI 46

Vendim Pilot– Masat e përgjithshme

Shtetit të paditur i kërkohet të marrë masa të përgjithshme në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit dhe mungesën e mjeteve mbrojtëse të brendshme.

Neshkov dhe të Tjerë kundër Bullgarisë - 36925/10 et al. Vendimi 27.1.2015 (Seksioni IV)

Faktet – Çështja kishte të bënte me kushtet në mjediset e vuajtjes së dënimit në disa institucione të vuajtjes së dënimit në Bullgari. Kërkuessit pretenduan shkeljen e Nenit 3 të Konventës dhe kërkuessi i parë (Z Neshkkov) pretendoi gjithashtu shkeljen e Nenit 13 për shkak të mungesës së mjeteve mbrojtëse të efektshme të brendshme. Gjykata i ka shqyrtuar edhe më parë kushtet e vuajtjes së dënimit në Bullgari sipas Nenit 3 në më shumë se 20 çështje të tjera. Nga ana e vet, Komiteti Ministrave të Këshillit të Europës kishte theksuar vazhdimisht nevojën e masave shtesë për të sjellë kushtet e vuajtjes së dënimit të institucionet e vuajtjes së dënimit të Bullgari në pajtim me standardet e Konventës. Në vitin 2008, duke e bindur nga informacioni i paraqitur nga Qeveria në vitin 2003 gjykatat bullgare kishin filluar t'u jepnin kompensim personave që mbaheshin në kushte të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit sipas një rregulli të përgjithshëm ligjor që rregullon detyrimin e autoriteteve në lidhje me veprime ose mosveprimet e paligjshme, Gjykata filloi duke i deklaruar të papranueshme këto ankime të sjella nga personat të cilët nuk vazhdonin të ishin në të tilla kushte në rastet kur mjetet mbrojtëse nuk ishin shteruar. Megjithatë, ajo nuk e ka bërë këtë në lidhje me personat të cilët vazhdonin të qëndronin në kushte të papërshtatshme, për shkak se në këto rrethana dhënia e kompensimit është i pamjaftueshëm.

Ligji – Neni 13

- (a) *Mjeti kompensues* – Gjykata kishte pranuar më parë se gjykimet për kompensim sipas Seksionit 1 të Ligjit për Detyrimet e Shtetit dhe Bashkive për Dëmet të vitit 1988 mund të konsideroheshin si një mjet i brendshëm i efektshëm në lidhje me ankesat sipas Nenit 3 të Konventës në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në rastet kur shkelja e pretenduar kishte përfunduar. Megjithatë, duke patur parasysh mënyrën se si është zhvilluar praktika gjyqësore në bullgari, Gjykata nuk vazhdon ta konsiderojë këtë mjet të efektshëm. Të dy çështjet e brendshme të sjella nga kërkuessi i parë theksonin një sërë problemesh: mosbërja e qartë e veprimeve ose mosveprimeve specifike që i burgosuri duhej të vërtetonte, barra tepër e prerë e provës, një tendencë për të vlerësuar aspektet individuale të kushteve të vuajtjes së dënimit dhe jo ndikimin në

tërësi, mosnjohja që edhe kushtet e papërshtatshme edhe për një kohë të shkurtër duhet të prezumohen sikur shkaktojnë dëm jo-financiar dhe zbatimin e afateve kohore të brendshme pa marrë parasysh natyrën e vazhdueshme të situatës në tërësi. Të dy pretendimet për kompensim dëmi që kërkuesi i parë i paraqiti sipas Seksionit 1 të Ligjit të vitit 1988 nuk mund të konsiderohen si mjet mbrojtës i efektshëm. Problemet e hasura nga kërkuesi i parë duket se përfaqësojnë ato që hasen nga në numër personash të cilët kishin kërkuar kompensim dëmi sipas Ligjit të vitit 1988 në lidhje me kushtet e ndalimit të tyre. Faktikisht, vetëm 30% i këtyre çështjeve kanë rezultuar në njohje. Gjykata vuri re veçanërisht që, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të këtij lloji, gjykatat e brendshme shpesh nuk merrnin parasysh rregullin e përgjithshëm që ndalon trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues, por vetëm dispozitat konkrete ligjore ose nënligjore që rregullojnë kushtet e vuajtjes së dënimit. Përveç kësaj, gjithmonë e më shumë ata nuk njihnin që kushtet e papërshtatshme të vuajtjes së dënimit duhet të prezumohen të shkaktojnë dëm jo-financiar për personin përkatës. Po ashtu ka patur pasiguri në lidhje me të pandehurit e duhur në lidhje me këto pretendime. Mjeti mbrojtës sipas Seksionit 1 të Ligjit të vitit 1988 nuk ka qenë i sigurt dhe i efektshëm në masën e duhur.

- (b) *Mjeti parandalues* – Të burgosurve të cilët vazhdonin të mbaheshin në kushte të papërshtatshme u duhej një mjet parandalues që të ishte në gjendje të përfundonte një shkelje që është në vazhdim. Megjithatë, sipas ligjit bullgar nuk kishte mjet të tillë. Veçanërisht, megjithëse në teori Nenit 250, par 1, 256 dhe 257 i Kodit të Procedurës Administrative të vitit 2006 mund të ofronte mbrojtje të përkohshme, ata dukej se nuk interpretoheshin nga gjykatat administrative në një mënyrë që t'u mundësojë të burgosurve të kenë një përmirësim të përgjithshëm të kushteve të tyre të vuajtjes së dënimit. Në çdo rast, masat e përkohshme kishin rëndësi të vogël praktike kur mbipopullimi ishte sistemik dhe kërkonte një reformë thelbësore. Forma të tjera të mbrojtjes, si një ankesë tek prokurori përgjegjës për mbikëqyrjen e institucionit ose një ankesë tek Ombudsmani nuk konsideroheshin efektive.

Përfundim: shkelje (njëzëri). Gjykata konstatoi gjithashtu njëzëri një shkelje të Nenit 3 të Konventës në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit të pësuar nga katër prej kërkuesve.

Neni 46 (a) Kushtet e vuajtjes së dënimit – Qysh nga Vendimi i saj i parë në lidhje me kushtet çnjerëzore dhe poshtëruese në institucionet e vuajtjes së dënimit (*Iorgov kundër Bullgarisë*, 40653/98, 11 mars 2004), Gjykata kishte konstatuar një shkelje të Nenit 3 të Konventës për shkak të kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit në këto institucione në 25 raste. Ndërsa shkeljet kishin të bënin me disa institucione, faktet përkatëse në çdo rast ishin tepër të ngjashëm, ku problemet më të shpeshta ishin mungesa e hapësirës e mjaftueshme të jetesës, kufizimet e pajustificuara për aksesin në dritën natyrale dhe ajrim, higjienë e dobët dhe një mungesë e jetës private dhe dinjitetit gjatë përdorimit të mjediseve sanitare. Kështu shkeljet nuk shkaktoheshin nga incidente të izoluar por e kishin origjinën në një problem të përhapur që rezultonte nga keqfunksionimi i sistemit bullgar të vuajtjes së dënimit.

Gjykata vendosi të zbatonte procedurën e vendimit pilot. Problemi sistemik në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit ishte e një game dhe kompleksiteti të konsiderueshëm the ishte si rezultat i një numri faktorësh. Ishin dy çështje që Bullgaria duhej t'i trajtonte. E para kishte të bënte me mbipopullimin për të cilin kishte një numër zgjidhjesh të mundshme duke përfshirë ndërtimin e institucioneve të reja, një sistemim më të mirë të të burgosurve në institucionet ekzistuese, një ulje të numrit të personave që vuanin dënime me heqje lirie, aplikim i kufizuar i burgimit, dënime më të shkurtra me burgim dhe alternativat e burgimit. E dyta kishte të bënte me kushtet fizike të vuajtjes së dënimit dhe higjienën. Megjithëse ishin në dijeni të problemit për vite me radhë, autoritetet nuk kishin bërë mjaftueshëm për ta zgjidhur atë. Në këtë moment, e vetmja zgjidhje ishte punë kolosale renovuese ose zëvendësimi i ndërtesave ekzistuese me të reja. Kjo duhej të bëhej pa asnjë vonesë.

(b) Mjetet e brendshme – Ndryshe nga situatë në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit, problemi sistemik që ishte shkak për shkeljen e Nenit 13 dukej se ishte kryesisht për shkak të legjislacionit dhe interpretimit të tij nga gjykatat. Kështu që në sistemin ligjor bullgar ishin të nevojshme ndryshime të posaçme në formën e (i) mjeteve parandaluese q të jenë në gjendje për t'u dhënë të burgosurve mbrojtje të menjëhershme të cilët mbahen në kushte të papërshtatshme dhe (ii) mjeti kompensues.

(i) *Mjeti parandalues* – Mënyra më e mirë e realizimit të mjetit parandalues ishte ngritja e një autoriteti të posaçëm i cili duhet të mbikëqyrë institucionet e vuajtjes së dënimit. Një autoritet i posaçëm zakonisht jep rezultate më të shpejta krahasuar me procedimet e zakonshme gjyqësore. Për t'u konsideruar mjet i efektshëm, autoriteti duhet të ketë kompetencën të monitorojë shkeljet e të drejtave të të burgosurve, të jetë i pavarur nga autoritetet e ngarkuar me sistemin e vuajtjes së dënimit, të ketë kompetencën dhe detyrën të hetojë ankimet me pjesëmarrjen e ankuesit dhe të jetë në gjendje të japë vendime detyruese dhe të ekzekutueshme. Opsione të tjera do të ishin ngritja e një procedure para autoriteteve ekzistuese si prokurorët publikë (me kusht që të jepen garanci të përshtatshme në lidhje me të drejtën e të burgosurit të bëjë parashtesa dhe detyrën e prokurorit për të dhënë një vendim detyrues dhe të ekzekutueshëm pa vonesë) ose të përshtaten format ekzistues të masave të përkohshme për të trajtuar ankimet në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit. (ii) *Mjeti kompensues* – Edhe nëse Konventa në parim konsiderohej si e zbatueshme drejtpërdrejt në Bullgari dhe si pjesë e ligjit të brendshëm, nuk ka patur mjet të përgjithshëm mbrojtës që të mundësojë mbrojtjen në nivelin e brendshëm për të drejtat dhe liritë e mishëruara në ligjin e brendshëm. Një zgjidhje do të ishte një mjet i përgjithshëm mbrojtjeje që do të mundësonte për ata që ankoheshin në lidhje me shkeljen e Konventës të kërkojnë afirmimin e të drejtave të tyre në një procedura të projektuar për këtë qëllim. Një opsion tjetër do të ishte vendosja e rregullave të veçanta të cilat përcaktonin me hollësi mënyrën në të cilën shqyrtoheshin dhe

vendoseshin pretendimet në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit. Kompensimi mund të merrte formën e kompensimit monetar ose, për ata që vazhdojnë të jenë në vuajtje e sipër, një ulje të arsyeshme të dënimit. Çdo mjet duhet të ketë efekt prapaveprues. Mjetet e kërkuara parandaluese dhe kompensuese duhet të ofrohen brenda tetëmbëdhjetë muajsh pasi të marrë formë të prerë Vendimi i Gjykatës. Kërkesat e tjera të ngjashme në shqyrtim e sipër nuk do të shtyhen ndërkohë.

- (c) *Masat individuale* – Kërkuesi i katërt (Z Zlatev), i cili dukej se ishte tepër i prekur dhe vazhdonte të mbahej në kushte tepër të ashpra, duhet të transferohet me urgjencë në një institucion tjetër të vuajtjes së dënimit, nëse ai e dëshiron këtë.

Neni 41: Kompensimet ndryshojnë nga 6.750 Euro në 11.625 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar (disa pretendime u ulën ose u rrëzuan për shkak se nuk kishin respektuar afatet kohore).

NENI 34

Personi i dëmtuar

Statusi i personit të dëmtuar i kërkuesit të cilit iu dha kompensim nga gjykatat civile për shkak të torturës, por ankimi penal i të cilit nuk iu nënshtrua një hetimi të efektshëm: *statusi i personit të dëmtuar ruhet*

Razzakov kundër Ruisë - 57519/09 Vendimi 5.2.2015 (Seksioni I)

Faktet – Në vitin 2009, kërkuesi u mbajt në ndalim policor për tre ditë dhe iu nënshtrua keqtrajtimit të ashpër me qëllim që të detyrohej të pranonte një krim. Ndaj tij nuk nisi asnjëherë çështja penale. Pas refuzimit fillimisht të hetimit të ankimit të kërkuesit për keqtrajtim, autoritetet eventualisht nisën çështjen penale, por kjo nuk çoi në identifikimin e personave përgjegjës. Në një çështje paralele civile, kërkuesit iu njoh kompensimi.

Ligji – Neni 34: Gjykata përshëndeti faktin që gjykata e brendshme civile shqyrtoi rregullisht çështjen e kërkuesit, konstatoi përgjegjësinë e shtetit në lidhje me keqtrajtimin e tij dhe i njohu atij kompensim për dëmin e vuajtur si rezultat i ndalimit të tij të paligjshëm dhe keqtrajtimit. Megjithatë, Gjykata kujtoi që në rastet e keqtrajtimit të qëllimshëm nga nëpunësit e shtetit, një shkelje e Nenit 3 nuk mund të vihet në vend vetëm nëpërmjet njohjes së kompensimit të viktimës. Nëse autoritetet mund të kufizonin reagimin e tyre në incidentet e këtij lloji në vetëm pagesën e kompensimit, ndërsa nuk do të merrnin masat e duhura për të ndjekur penalisht dhe dënuar personat përgjegjës, do të ishte e mundur që nëpunësit e shtetit të abuzonin me të drejtat e atyre që kishin në kontrollin e tyre duke mos marrë faktikisht asnjë dënim. Kjo do ta bënte ndalimin e përgjithshëm ligjor të torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës të paefektshëm në

praktikë. Kështu, në këtë çështje kërkuesi mund të vazhdonte të pretendonte se ishte person i dëmtuar nga shkelja e Nenit në lidhje me keqtrajtimin e tij të pretenduar.

Përfundim: statusi i personit të dëmtuar i lënë në fuqi (njëzëri).

Neni 3(a) *Aspekti lëndor* – Duke patur njohjen nga Shteti të një shkeljeje të Nenit 3 dhe vendimet e autoriteteve të brendshme në gjykimin penal dhe civil, Gjykata i konstatoi aludimet e kërkuesit në lidhje me atë që kishte ndodhur si të vërtetuara. Gjatë ndalimit të tij arbitrar, kërkuesi i ishte nënshtruar një serie veprimesh të urryera të dhunës fizike dhe psikologjike për një periudhë kohe të gjatë. Nëpunësit e policisë kishin vepruar me qëllim me synimin e detyrimit të kërkuesit të pranonte një krim, i cili ishte në një pozicion delikat dhe kishte një njohje të kufizuar të gjuhës ruse. Kështu, trajtimi të cilit iu nënshtrua kërkuesi ka rezultuar në torturë.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

(b) *Aspekti procedural* – Shteti i paditur kishte njohur mungesën e një hetimi të efektshëm zyrtar në aludimin e besueshëm të kërkuesit në lidhje me keqtrajtimin. Duke vënë re që autoriteti i hetimit kishte hapur çështjen penale vetëm pesë muaj pasi keqtrajtimi i aluduar kishte ardhur në vëmendje të tij, Gjykata përsëriti që në rastet e aludimeve të besueshme të trajtimit të sanksionuar në Nenin 3 vetëm “një hetim paraprak” nuk ishte në gjendje të përmbushte kërkesat e një hetimit të efektshëm sipas asaj dispozite. Vërtet që thjesht fakti i refuzimit të autoritetit hetimor për të hapur një hetim penal në aludimet e besueshme të keqtrajtimin të rëndë në ndalimin hetimor ishte tregues për mospërmbushjen nga ana e Shtetit të detyrimit për zhvillimin e një hetimi të efektshëm. Për më tepër, megjithëse provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak ishin konsideruar të mjaftueshme për gjykatën civile të vendosë përgjegjësinë e Shtetit për veprimet e nëpunësve të policisë dhe për dhënien e kompensimit ndaj kërkuesit, komiteti hetimor e kishte konsideruar atë provë të pamjaftueshme për të filluar ndjekjen penale. Në këtë aspekt, materiali i dosjes së çështjes tregonte faktikisht që përfundimet e hetimit nuk ishin bazuar në një analizë të hollësishme, objektive dhe të paanshme për të gjithë elementet përkatëse. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata nxori përfundimin që autoritetet e brendshme kishin dështuar në zhvillimin e një hetimi të efektshëm në aludimet e kërkuesit për keqtrajtim në ndalimin policor.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: 20,000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar. Gjykata konstatoi gjithashtu që kërkuesi nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e një shkeljeje të Nenit 5 pasi kompensimi i dhënë në gjykimin e brendshëm i kishte ofruar atij një kompensim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm.

NENI 46

Vendimi Pilot– Masa të përgjithshme

Shtetit të Paditur i kërkohet të parashikojë një kuadër kohor për zbatimin e masave parandaluse dhe kompensuese në lidhje me kushtet e papërshtatshme të ndalimit

Varga dhe të tjerët kundër Hungarisë - 14097/12 et al. Vendimi 10.3.2015 (Seksioni II)

Faktet b Kërkuesit ishin të ndaluar faktikë ose të mëparshëm të cilët kishin kaluar një pjesë të ndalimit të tyre në qeli që u mundësonte atyre më pak se 3 metra katrorë si hapësirë jetese, në të cilat mjediset e higjienës ishin të ndara nga zona e banimit vetëm me një perde dhe mjediset e banimit ishin të infektuara me insekte dhe nuk kishin ventilim të përshtatshëm ose mjedise fjetjeje. Ata kishin gjithashtu akses tepër të kufizuar në dushe dhe mund të kalonin vetëm pak kohë jashtë qelisë së tyre.

Ligji – Neni 13 i lexuar në lidhje me Nenin 3: Qeveria sugjeroi dy masa të cilat mund të përdoreshin nga kërkuesit në lidhje me kushtet e ndalimit: një padi civile për kompensim për shkeljen e të drejtave të personalitetit dhe një ankim tek drejtori i burgjeve dhe prokurori publik. Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës asnjë nga këto masa ligjore nuk përbush kërkesat e një mase të efektshme. E para, megjithëse e mundshme, ishte jo efektive në praktikë, në kuptimin që ajo nuk i ofronte paditësit kompensim të përshtatshëm për periudhat e ndalimit të kaluara në kushte të papërshtatshme. Në lidhje me të dytën, kapaciteti i saj për të prodhuar një efekt parandalues nuk ishte demonstruar në mënyrë bindëse në praktikë.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 3: Problemi i mbipopullimit i cili prek burgjet ku ishin apo kishin qenë të mbajtur më parë kërkuesit ishin njohur nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT) dhe nuk ishte kundërshtuar nga Qeveria. Gjykata konstatoi që shumë aspekte të ndalimit të kërkueseve, si higjiena e dobët dhe mungesa e privatësisë, e kombinuar me mungesën e hapësirës personale për shkak të mbipopullimit, tregonin që kushtet e ndalimit shkonin tej pragut të toleruar nga Neni 3. Për më tepër, në rastin e kërkuesit të katërt, mungesa e hapësirës ishte aq e ashpër sa përbënte vetë një trajtim në kundërshtim me Konventën.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 46: Duke parrë parasysh natyrën e përsëritur dhe të qëndrueshme të problemit të kushteve të ndalimit në Hungari, që ishin dënuar nga Gjykata në disa çështje, numrin e madh të njerëzve që kishte prekur kjo ose që mund të prekte dhe nevojën urgjente për t'u dhënë atyre kompensim të përshtatshëm dhe të shpejtë në nivel të brendshëm, Gjykata e konsideroi me vend të aplikonte procedurën e vendimit pilot. Qeveria e paditur u inkurajua të siguronte menjëherë një mjet të efektshëm ose një kombinim mjetesh, parandaluese dhe kompesuese në natyrë dhe që garantonin me vërtetësi masa të

efektshme për shkeljet e Konventës që e kishin origjinën në mbipopullimin e burgjeve. Duke rikujtuar masat e përgjithshme dhe individuale që janë treguar në rastet e mëparshme, Gjykata theksoi që zgjidhja më e përshtatshme për problemin e mbipopullimit do të ishte ulja e numrit të të burgosurve duke zbatuar më shpesh masat ndëshkimore pa heqje lirie dhe duke minimizuar aplikimin e ndalimit paragjyqësor. Për këtë qëllim, Gjykata vuri në dukje rekomandimet e Komitetit të Ministrave që i fton Shtetet të inkurajojnë prokurorët dhe gjyqtarët të përdorin sa më gjerësisht që të jetë e mundur alternativat ndaj ndalimit dhe ta orientojnë politikën e tyre penale drejt përdorimit të reduktuar të burgimit. Në lidhje me opsionet specifike të masave parandaluese dhe kompensuese, një dënim i ulur me burgim ofronte masë të përshtatshme kundrejt kushteve të dobëta fizike të ndalimit, me kusht që ulja të kryhet në një mënyrë të shprehur dhe të matshme. Ndërsa nuk u vendos ndonjë afat kohor specifik për zbatimin e sugjerimeve të propozuara, Qeverisë iu kërkua të veprojë sa më shpejt të jetë e mundur për të përcaktuar një afat kohor duke paraqitur masat brenda gjashtë muajve nga data që Vendimi të ketë marrë formë të prerë. Nuk ishte e përshtatshme të shtyhej shqyrtimi i çështjeve të ngjashme në pritje të zbatimit të masave përkatëse. Neni 41: jep një shumë brenda gamës nga EUR 3,400 në 26,000 për çdo kërkues në lidhje me dëmin jo-financiar.

Gjykatë e paanshme Paanësia e gjykatës në gjykimet në lidhje me sjelljen profesionale të papërshtatshme në ngarkim të një gjyqtari: *shkelje*

II. AKTGJYKIME KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Trajtim poshtëruës

Prangosja e pacientes gjatë transferimit për në një spital psikiatrik: *shkelje*

Ilievska kundër Republikës së Maqedonisë - 20136/11 (Vendimi 7.5.2015 Seksioni I)

Faktet – Kërkuesja iu nënshtrua operacionit për kancer dhe kimioterapisë në prill të vitit 2009. Në tetor 2009 bashkëshorti i saj kërkoi ndihmë mjekësore pasi ajo vuante nga ankthi dhe depresioni. Me këshillën e mjekëve, kërkuesja u transferua në një klinikë psikiatrike në Shkup me ndihmën e dy punonjësve të policisë. Kërkuesja aludoi që gjatë udhëtimit për në spital, duart e saj ishin në pranga prapa shpine dhe ajo u detyrua të shtrihej në shtrat në ambulancë dhe një oficer policie iu ul mbi këmbë, dhe u qëllua, u godit me grushte dhe u kërcënua. Ajo ngriti akuzë penale, ndër të tjera, ndaj dy punonjësve të policisë për keqtrajtim, por ata u shpallën të pafajshëm për mungesë provash. Aludimet e kërkueses u kundërshtuan nga Qeveria.

Ligi – Neni 3: Gjykata nuk mund të vërtetonte tej çdo dyshimi të arsyeshëm që dëmtimet në shpinën e kërkueses, në stomak dhe në këmbë ishin shkaktuar nga punonjësit e policisë gjatë transferimit. Megjithatë, duke patur parasysh provat mjekësore që konfirmojnë praninë e hematomave në kyçet e e kërkueses dhe mungesën e shpjegimit nga ana e Qeverisë për këto dëmtime, Gjykata pranoi që kërkuesja ishte vendosur në pranga. Në shqyrtimin nëse vendosja e prangave ishte e justifikuar, ajo vuri re që në këtë kohë kërkuesja po vuante nga një moment depresioni mendor për të cilën policët ishin në dijeni. Ajo ishte qartësisht nën kontrollin e policisë gjatë transferimit dhe ishte delikate për shkak të gjendjes së saj psikologjike që rridhte nga nevojat mjekësore. Përveç kësaj, ajo ishte fizikisht e dobët pas operacionit dhe kimioterapisë së fundit. Gjykata prezumoi - në mbështetje të deklarimeve nga ana e Qeverisë në lidhje me tendencën e kërkueses për vetë-dëmtim – që vendosja e prangave synonte të parandalonte atë nga vetë-dëmtimi. Megjithatë, ajo vuri re që çështja e proporcionalitetit të vendosjes së prangave nuk ishte marrë parasysh në gjykimin e brendshëm. Qeveria nuk mundi të tregonte që nuk kishte patur masa dhe mjete të tjera më pak të ashpra. Si rezultat, vendosja e prangave kualifikohet si trajtim poshtërues.

Përfundim: shkelje (njëzëri).

Neni 41: 5.000 Euro në lidhje me dëmin jo-financiar.

Nikolova kundër Republikës së Maqedonisë, 31154/07 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 21 maj të vitit 2015)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) solli aktgjykimin për rastin Nikolova kundër RM-së, A. nr. 31154/07, me të cilin u konstatuan shkeljet e nenit 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (KEDNJ) për nga aspekti i kohëzgjatjes së procedurës para organeve vendore.

Lënda pason nga aplikimi (nr. 31154/07) i parashtruar nga ana e nënshtetasit nga Maqedonia, zonja Lubica Nikolova (“ankuese”), më datën 10 korrik të vitit 2007. Në ankesën e saj, ajo ka theksuar se kohëzgjatja e procedurave të kontestuara për përcaktim të vlerës së kompensimit për truallin e eksproprijuar (shpronësuar), nënkupton shkeljen e nenit 6 të Konventës.

Përkatësisht, në pajtim me faktet e parashtruara të lëndës, procedura për përcaktimin e lartësisë së kompensimit, i cili është dashur që të përcaktohet për truallin e eksproprijuar, ka filluar më datën 25 korrik të vitit 1989. Gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurës e cila ka zgjatur pothuajse 20 vite, nuk ka qenë e kontestuar lartësia e kompensimit por ka qenë e kontestuar çështja se kush duhet ta realizojë pagesën e kompensimit të tillë. Për shkak të kësaj, janë miratuar më shumë aktgjykime të shkallës së parë, me të cilat gjykata ka detyruar subjekte të ndryshme që të realizojnë pagesën e përcaktuar. Procedurat

përfundimisht kanë përfunduar më datën 31 mars të vitit 2009, në kohën kur Gjykata supreme e ka refuzuar si të palejuar revidimin e dorëzuar nga ana e komunës.

ARSYETIMI I DHËNË NGA GJEDNJ

Gjykata ka vërejtur se procedurat kanë filluar në muajin korrik të vitit 1989 dhe se kanë përfunduar në muajin mars të vitit 2009. Kështu që, procedurat kanë zgjatur pothuajse njëzet vite dhe janë zhvilluar në tre instanca gjyqësore, prej të cilave dymbëdhjetë kanë qenë në kompetencë të Gjykatës (pas 10 prillit të vitit 1997, data e ratifikimit të Konventës nga ana e shtetit të paditur).

Duke i pasur parasysh kriteret e theksuara në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës, për përcaktim të kërkesës për afate të arsyeshme dhe rationale të paraparë me nenin 6, paragrafin 1 të Konventës, më konkretisht kompleksiteti i rastit në fjalë, sjelljet e palës ankuese dhe sjelljet e autoriteteve relevante, si dhe ajo që ka qenë me rëndësi për palën ankuese, Gjykata konsideron se procedurat kanë qenë të prolonguar pa arsye, për shkak të kësaj, shteti mban përgjegjësi të përcaktuar.

Për shkak të kësaj, ekziston shkelja e nenit 6 të Konventës, për nga aspekti i kohëzgjatjes së procedurave jashtë kontestuese gjyqësore për përcaktim të lartësisë së kompensimit.

Pala ankuese, ka kërkuar shumën prej 50.000 euro si dëmshpërblim për dëmin jo material të cilin e kanë pësuar për shkak të kohëzgjatjes së tepër të procedurave.

Qeveria e RM-së i ka kontestuar kërkesat e tilla, dhe i ka cilësuar si tejet të larta dhe të pabaza.

Gjykata konsideron se ankuesja me siguri ka pësuar dëme të natyrës jo materiale, të cilat nuk mund të kompensohet vetëm përmes detektimit të shkeljeve të Konventës. Duke vendosur në bazë të barabartë, Gjykata palës ankuese i ka përcaktuar shumën prej 3.600 euro, plus cilëndo prej taksave të cilat do të mund të paguhen.

Pala ankuese nuk ka dorëzuar kërkesë të posaçme për mbulim të shpenzimeve dhe harxhimeve tjera, dhe për këtë arsye Gjykata nuk i ka përcaktuar kompensime në këtë bazë.

Eftimov kundër Republikës së Maqedonisë, 59974/08 (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 2 korrik të vitit 2015)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), solli aktgjykim për rastin *Eftimov kundër RM-së*, A. nr. 59974/08, me të cilin janë konstatuar shkeljet e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (KEDNJ) për shkak të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore dhe mungesës së barazisë së instrumenteve juridike në procedurën para Gjykatës supreme.

Përkatësisht, fletë aplikimi ka qenë i dorëzuar më datë 5 dhjetor të vitit 2008 nga ana e zotëri Epaminonda Eftimov, nënshtetas i Maqedonisë i cili jeton në qytetin e Strumicës, ku punon si kirurg në spitalin e qytetit të Strumicës. Më datën 8 qershor të vitit 1997, pala ankuese ka shëruar dorën e lënduar dhe të thyer (me frakturë) të personit Z.R., dhe për

shkak të dhembjeve ndaj të cilave është ankuar i lënduari Z.R. gjatë ditëve të ardhme, ankuesi dhe dy kolegët e tij nga spitali në Strumicës kanë zbatuar trajtime të ndryshme ndaj të lënduarit Z.R., dhe në fund të njëjtin e kanë udhëzuar në klinikën e fëmijëve në Shkup, ku kanë konstatuar ekzistimin e një infeksioni të fuqishëm bakterial, me ç'rast të lënduarit i është amputuar dora e djathtë.

Më datën 25 shtator të vitit 1997, gjykatësi hetues i gjykatës së shkallës së parë në qytetin e Strumicës, në kërkesë të prokurorit publik ka hapur hetimet kundër ankuesit. Më pas, më datën 19 prill të vitit 2000, prokurori publik ka dorëzuar aktakuzën kundër ankuesit për shkaktim të veprave të rënda kundër shëndetit të njeriut. Gjykata themelore, dy herë me radhë, më 10 korrik të vitit 2001 dhe më datën 13 dhjetor të vitit 2004 ka liruar ankuesin nga aktakuzat, dhe më vonë këto aktgjykime kanë qenë të anuluar nga ana e Gjykatës së apelit në qytetin e Shtipit, për arsye se shkalla e fajësisë së ankuesit dhe kualifikimi i veprës penale, nuk kanë qenë të përcaktuara në mënyrë të rregullt gjatë procedurave të zhvilluara para gjykatës gjyqësore.

Më 13 shtator të vitit 2006, Gjykata themelore në qytetin e Strumicës, sërish e ka liruar ankuesin meqenëse nuk ka detektuar dëshmi se vepra penale ka qenë e kryer me qëllim.

Në lidhje me aktgjykimin e lartpërmendur, Gjykata e apelit në qytetin e Shtipit, sipas bindjes së saj, në seancën ku kanë qenë të pranishme dy palët, e ka ri kualifikuar akuzën dhe e ka refuzuar të njëjtin si të vjetruar, duke sajuar konkludimin se veprimet e ankuesit kanë qenë më shumë të pakujdesshme se sa të qëllimta, dhe për këtë arsye akuza penale ka qenë e skaduar.

Më datën 21 mars të vitit 2007, Gjykata supreme në kërkesë të prokurorit publik për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka rikthyer lëndën për vendosje të sërishme në Gjykatën e apelit në qytetin e Shtipit, duke theksuar faktin se me ri kualifikimin e akuzës, Gjykata e apelit edhe njëherë i ka konstatuar faktet, pa mbajtjen e seancës gjyqësore. Gjykata e apelit në qytetin e Shtipit, duke vepruar sipas instruksioneve të dhëna nga Gjykata supreme, ka mbajtur seancën gjyqësorë dhe sërish i ka refuzuar akuzat si të skaduara. Ankuesi dhe prokurori publik kanë dorëzuar ankesa para Gjykatës supreme. Ankuesi gjithashtu ka dorëzuar edhe përgjigjen në lidhje me ankesën e prokurorit publik.

Më datën 26 mars të vitit 2008, Gjykata supreme ka mbajtur seancën në prani të prokurorit publik, gjatë kësaj i ka dëgjuar argumentet e prokurorit publik, me të cilat ai ka kërkuar që të refuzohet ankesa e ankuesit dhe të fuqizohet ankesa e prokurorisë, duke i pasur parasysh parashtrësit me shkrim të palëve, Gjykata supreme e ka refuzuar kërkesën e ankuesit dhe e ka pranuar si të qëndrueshme ankesën e prokurorit publik, gjatë kësaj ajo e ka ndërruar aktgjykimin e miratuar nga Gjykata e apelit. Më pas, Gjykata supreme ka gjykuar ankuesin me dënimin prej një viti burgim, duke u nisur nga argumentet e gjykatësit gjyqësor, se vepra penale duhet të kualifikohet si vepër e rëndë kundër shëndetit të njeriut, e realizuar me qëllim.

Në fletë aplikimin e tij para GJEDNJ, ankuesi ka theksuar se atij nuk i është mundur procedura e drejtë juridike para Gjykatës supreme meqenëse, për dallim nga prokurori

publik, ai nuk ka qenë i pranishëm në seancën e Gjykatës supreme, në të cilën është miratuar vendimi me të cilin ai ka qenë i gjykuar dhe atij i është shqiptuar dënimi me burgim, si dhe procedura penale kundër tij, nuk ka qenë e realizuar në afat të arsyeshëm dhe racional.

Vlerësimet dhe arsyetimet e Gjykatës

Gjykata ka përkujtuar në faktin se parimi i barazisë së instrumenteve juridike, si një prej elementeve të konceptit për gjykim të drejtë, kërkon që secilës prej palëve ti jepet mundësi racionale që ta prezantoj rastin e tij, në kushte në të cilat atë nuk do ta vejnë në pozitë të palakmueshme krahas kundërshtarit të tij. Në rastin konkret, Qeveria ka konsideruar se në seancën e mbajtur më datën 26 mars të vitit 2008, Gjykata supreme as që ka konstatuar fakte të reja, e as që ka shqyrtuar dëshmi të reja, por ka vendosur në bazë të materialeve të disponueshme, dhe më pas as ankuesi e as mbrojtësi i tij kanë kërkuar që të njoftohen për seancën e Gjykatës supreme, dhe përsëri kësaj ata kanë pasur mundësinë që ti shprehin qëndrimet e tyre në ankesën dhe në parashtresat tjera, si përgjigje e ankesës së dhënë nga prokurori publik, gjatë kësaj Gjykata supreme i ka marrë parasysh të gjitha parashtresat e dorëzuara nga prokurori publik. Gjykata, nga ana tjetër, ka vërejtur se ankuesi nuk ka qenë i pranishëm në seancën e mbajtur nga ana e Gjykatës supreme dhe për këtë arsye, nuk ka pasur mundësinë që të ofroj përgjigje për argumentimet e prokurorit publik, ashtu që prokurori publik ka qenë i vendosur në një gjendje të privilegjuar krahas ankuesit dhe se ankuesi nuk ka qenë në gjendje që ti shfrytëzoj të drejtat e veta ligjore.

Përkundër konstatimeve të Qeverisë, se kohëzgjatja e procedurës nuk ka qenë jo racionale, për shkak të faktit se janë miratuar një numër i madh i vendimeve nga ana e instancave gjyqësore të cilat e kanë shqyrtuar rastin konkret, dhe tre seanca gjyqësore kanë qenë të prolonguar për shkak të mungesës së ekspertëve gjyqësorë, Gjykata ka vërejtur se procedura ka filluar më datën 25 shtator të vitit 1997, kurse ka përfunduar më datën 19 qershor të vitit 2008, me këtë mund të konstatohet se kohëzgjatja e tërësishtme e procedurës gjyqësore ka qenë dhjetë vite e nëntë muaj. Duke i marrë parasysh datat dhe vendosjet e përsëritura, Gjykata konstaton se nuk ka qenë i plotësuar kriteri i gjykimit në afate racionale dhe të arsyeshme.

Duke i pasur parasysh Faktet e lartpërmendura, GJEDNJ ka konstatuar ekzistimin e shkeljes së nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ.

Duke i pasur parasysh këto konstatime, Gjykata gjykoi se shteti i paditur duhet ti paguaj ankuesit shumën prej 3.900 euro për dëmet e shkaktuara të natyrës jo materiale, si dhe 1.000 euro për shpenzimet dhe pagesat e krijuara në lidhje me procedurat e përfaqësimit para GJEDNJ.

Andonovski kundër Republikës së Maqedonisë, 24312/10, (aktgjykimi i GJEDNJ i datës 23 korrik të vitit 2015)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) solli aktgjykimin për rastin Andonovski kundër RM-së, A. nr. 24312/10, me të cilin u konstatua shkelja e nenit 3 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive themelore të Njeriut (KEDNJ) për nga aspekti i faktit se ankuesi nuk ka qenë i marrë në pyetje nga ana e tribunalit të paanshëm.

Lënda pason nga fletë aplikimi (nr. 24312/10) i parashtruar nga ana e nënshtetasit nga Maqedonia, zotëri Vlladimir Andonovski ("ankuesi") më datën 20 prill të vitit 2010. Në ankesën e tij, ankuesi ka theksuar se ka qenë lëndë e veprimit dhe procedimit jo përkatës si dhe e maltretimit nga ana e shërbimeve policore dhe se hetimet në lidhje me pohimet e tija për brutalitetin policorë, nuk ka qenë efikase. Ai ka theksuar pohime për shkeljen e nenit 3 dhe 13 të Konventës.

Përkatësisht, më datën 17 shtator të vitit 2004, aplikuesi ka parkuar automjetin e tij në një rrugë në qytetin e Kumanovës. Kur është kthyer, nën larëset e qelqit të parëm të automjetit, ka gjetur dënimin për parkim të gabuar. Ai ka ndezur automjetin dhe është nisur për ti gjetur nëpunësit policorë me qëllim që të bisedoj rreth problemit lidhur me dënimin. Në çastin kur ka vërejtur automjetin e shërbimeve policore, ai ka filluar që ti ndjek derisa nuk i ka ndaluar të njëjtit.

Palët e përfshira në procedurën e lartpërmendur, aplikuesi nga njëra anë, dhe Qeveria nga ana tjetër, në procedurën para GJEDNJ kanë prezantuar versione të ndryshme të ngjarjeve që janë zhvilluar në lidhje me këtë rast. Në çdo rast, është e pakontestuar se pas ngjarjes aplikuesi ka qenë i dërguar në stacionin e policisë në Kumanovë, prej ku atij i është thirrur automjeti i ambulancës, me të cilin aplikuesi ka qenë i transportuar në spitalin e Kumanovës, më pas ai ka qenë i transportuar deri te Qendra klinike në Shkup, dhe pastaj ai ka qenë i dërguar në Spitalin e qytetit në Shkup, ku ka qenë i mbajtur deri më datën 28 shtatorë të vitit 2004.

Versionet e ndryshme të rrjedhojës së ngjarjeve, të cilët i kanë prezantuar aplikuesi dhe nëpunësit e MPB, kanë rezultuar me procedura të ndryshme para gjykatave vendore.

Më 19 shtator të vitit 2004, P.J. dhe M.A. kanë dorëzuar raporte deri te Ministria për punë të brendshme në lidhje me shfrytëzimin e fuqisë mbi aplikuesin. Ata në raportet kanë theksuar se aplikuesi ka shfrytëzuar ofendime dhe ka shkëlmuar mbi automjetin e policisë, ai gjithashtu i ka pështyrë nëpunësit e policisë dhe iu është drejtuar me fjalë fyese. Ata nga aplikuesi kanë kërkuar që të legjitimohet, por aplikuesi u është kundërshtuar. Në ndërkohë, ata janë orvatur që ti vejnë prangat, gjatë këtij veprimi aplikuesi ka rezistuar, kurse më pas, njëri prej nëpunësve të policisë e ka shtyrë aplikuesin anash, ia ka lakuar dy duart prapa shpinës dhe së fundi i ka vënë prangat. Gjatë kësaj, në raportin ka qenë e theksuar se aplikuesi ia ka kafshuar gishtin e dorës nëpunësit të policisë me iniciale M.A. Për këtë arsye Ministria për punë të brendshme ka ngritur padi kundër aplikuesit për sulm mbi personin zyrtarë të Ministrisë së punëve të brendshme.

Aplikuesi, nga ana tjetër ka konstatuar se ka qenë i ekspozuar ndaj dhunës së ushtruar nga ana e policisë, si pasojë e së cilës ai ka pësuar lëndime serioze.

Aplikuesi e ka njoftuar Sektorin për kontrollime të brendshme dhe për standarde profesionale pranë Ministrisë së punëve të brendshme (SKMSP) për incidentin dhe për atë se gjatë incidentit ka qenë i ekspozuar ndaj brutalitetit policor. Me përgjigjen e dhënë më datën 17 dhjetor të vitit 2004, SKMSP e ka njoftuar aplikuesin se kundër tij ka qenë i parashtruar kallëzimi penal, dhe se fuqia e shfrytëzuar kundër tij (shfrytëzimi i prangave dhe lakimi i duarve prapa shpinës) ka qenë i arsyeshëm dhe i domosdoshëm. Në pajtim me këtë, SKMSP ka konkluduar se nëpunësit e policisë kanë vepruar në pajtim me ligjin dhe me rregullat e Ministrisë.

- Procedura penale kundër aplikuesit

Më 18 shtator të vitit 2004, në lidhje me incidentin e lartpërmendur, Ministria për punë të brendshme ka parashtruar kallëzim penal kundër aplikuesit deri te Prokuroria publike në Kumanovë, për sulm ndaj personit zyrtarë, në bazë të kësaj më 19 tetor të vitit 2005, Gjykata themelore në Kumanovë, aplikuesin do të shpall për fajtor për sulmin ndaj personit zyrtarë dhe me këtë rast atij i ka shqiptuar gjykimin e kushtëzuar me burgim në kohëzgjatjen prej pesë muajve. Aplikuesi ka dorëzuar ankesë deri te Gjykata e apelit në Shkup, por ankesa i është refuzuar meqenëse gjykata nuk ka gjetur arsye që të vendos ndryshe krahas gjendjes faktike dhe shkaqeve të ofruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

- Procedura penale kundër nëpunësve të policisë P.J. dhe M.A.

Më datë 3 shkurt të vitit 2005, aplikuesi ka parashtruar kallëzim penal deri te prokurori publik, kundër nëpunësve të policisë P.J. dhe M.A. për shkak të veprave penale; sulm fizik, lëndime të rënda trupore, keqpërdorim të pozitës zyrtare, dëshmi të rreme dhe për shkak të sjelljes degraduese. Më 8 shkurt të vitit 2005, paraqitja ka qenë e dorëzuar deri te Prokuroria publike në Kumanovë. Më 16 shkurt të vitit 2005, aplikuesi ka parashtruar padi penale, me kërkesën për inicim të akuzës kundër P.J. dhe M.A. nga ana e prokurorisë në Kumanovë, për shkak të sulmit dhe lëndimeve të rënda trupore, si dhe për shkak të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Më 25 maj të vitit 2005, prokurori publik në Kumanovë ka refuzuar padinë penale, për shkak të mos ekzistimit të argumenteve të qëndrueshme se të akuzuarit i kanë shkaktuar veprat penale për të cilat janë paditur. Më datën 29 shtator të vitit 2006, aplikuesi përmes avokatit të tij deri te gjykata ka parashtruar akt padinë subsidiare.

Gjatë procedurës, aplikuesi disa herë ka kërkuar që të merren masat e ndjekjes nga ana e prokurorisë. Prokuroria disa herë ka njoftuar se nuk ka qëllime të tilla. Më datën 24 mars të vitit 2009, Gjykata themelore në Kumanovë ka mbajtur seancën gjyqësore në prani të aplikantit, përfaqësuesit të tij juridik, të akuzuarve dhe avokatëve të tyre. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur në atë ditë, aplikuesi ka deklaruar se e tërheq aktin e prokurorisë subsidiare, për këtë arsye gjykata ka ndërprerë procedurën.

Aplikuesi, ka parashtruar parashtresën në lidhje me vendimin e gjykatës, duke deklaruar se ai e ka tërhequr akuzën, duke menduar se prokuroria do ta marrë përsipër ndjekjen, dhe në të njëjtën kohë ai ka pohuar se është palë e pa arsimuar dhe se nuk e ka kuptuar pyetjen e gjykatësit. Më pas ai ka parashtruar ankesën deri te Gjykata e apelit në Shkup, kundër vendimit të gjykatës gjyqësore, duke pohuar se ai asnjëherë nuk ka tërhequr aktin e padisë. Më datën 24 shtator të vitit 2009, Gjykata e apelit në Shkup e ka refuzuar ankesën e aplikuesit si të pabazë dhe e ka konfirmuar vendimin e miratuar nga gjykata gjyqësore. Më datën 29 qershor të vitit 2010, Gjykata supreme e ka refuzuar si të pa lejuar kërkesën e aplikuesit për rishqyrtim të jashtë zakonshëm të vendimit.

Në procedurën para GJEDNJ, aplikuesi ka dorëzuar një dokumentacion të vëllimshëm mjekësorë, i cili si material dëshmues ka qenë i prezantuar edhe gjatë procedurave para organeve vendore, dhe mes tjerash edhe mendimin dhe rezultatet e Institutit për mjekësi ligjore, të përpiluar në kërkesë të organeve vendore, në bazë të dokumentacionit të disponueshëm mjekësorë, në të cilën është konstatuar dhe përcaktuar se lëndimet trupore të aplikuesit paraqesin lëndime të rënda trupore.

- Vlerësimi dhe arsyetimet e Gjykatës

GJEDNJ, konstatoi shkelje të nenit 3 të KEDNJ, përkatësisht shkelje të ndalesës për torturë, veprime jo njerëzore dhe degraduese ose dënime për nga aspektet procedurale dhe materiale.

- Aspekti procedural

Sipas praktikës së GJEDNJ, në rastet ku individit do të prononcoj konstatime të cilat mund të dëshmojnë se ka qenë i torturuar në mënyrë serioze nga ana e shërbimeve policore, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, dispozitat e KEDNJ kërkojnë zbatimin e hetimeve efikase sipas detyrës zyrtare. Standardet minimale të efikasitetit, të përcaktuara në praktikën e Gjykatës, kërkojnë që hetimet të jenë të pavarura, të paanshme dhe nën mbikëqyrjen e opinionit, dhe gjatë kësaj organet kompetente duhet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi të madhe. Hetimet e tilla, do të duhet të rezultojnë me përdëftimin e gjendjes faktike të rastit, dhe nëse dëshmohet se pohimet janë të vërteta, hetimet duhet të vazhdojnë deri në zbulimin dhe dënimin e personave përgjegjës. Me zbatimin e standardeve të tilla të praktikës së saj, në rastin konkret, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se paditë penale të aplikuesit të datës së 3 korrikut dhe 16 shkurtit të vitit 2005, si dhe nga dëshmitë e disponueshme mjekësore në atë çast, kanë argumentuar konstatimin se mund të dëshmohet, në lidhje me atë se lëndimet e aplikuesit mund të jenë shkaktuar nga shfrytëzimi i tepërt i fuqisë, dhe për këtë arsye organet kanë qenë të obliguar që të zbatojnë hetime efektive sipas detyrës zyrtare. Duke pasur parasysh faktin e kompetencave të prokurorisë publike dhe rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se prokurori publik i cili ka pranuar padinë penale nga ana e aplikuesit, edhe se ka poseduar autorizime dhe ka qenë i obliguar, edhe përkaj natyrës serioze të lëndimeve dhe raporteve mjekësore, të cilat kanë dëshmuar për lëndimet e marra dhe të cilat i janë dorëzuar, nuk ka ndërmarrë kurrfarë masa serioze që të siguroj dëshmi për

incidentin në fjalë. Përskaj faktit se ai ka kërkuar informacione nga Klinika në Shkup për disa prej lëndimeve të marra të aplikuesit, ai nuk e ka ftuar aplikuesin dhe të akuzuarit ose ndonjë person të tretë, i cili do të mund të ofroj ndonjë informatë relevante në lidhje me rastin konkret, edhe përskaj faktit se ai ka disponuar kompetenca eksplicite në këtë drejtim. Në vend të kësaj, prokurori publik e ka refuzuar padinë penale të parashtruar nga ana e aplikuesit, për shkak të mos ekzistimit të dëshmive se të akuzuarit i kanë shkaktuar veprat penale për të cilat janë ngarkuar, gjatë kësaj vendimit e tij ai kryesisht e ka mbështetur në bazë të dëshmive të siguruara nga ana e shërbimeve policore.

Nga ana tjetër, Gjykata ka konstatuar se në suaza të procedurës gjyqësore të iniciuar nga ana e aplikuesit, ka qenë i zbatuar hetimi gjyqësorë në të cilin janë marrë në pyetje nëpunësit e akuzuar të policisë, aplikuesi, bashkëshortja dhe djali i tij si dhe është dhënë urdhër që të realizohet ekspertiza e pavarur mjekësore. GJEDNJ gjatë kësaj ka shprehur kënaqësi nga kujdesi i shprehur nga ana e gjykatësit hetues.

Prapëseprapë, duke pasur parasysh faktin se së pari, kjo procedurë ka qenë si rezultat i vendosshmërisë së aplikuesit që ta vazhdoj procedurën kundër nëpunësve të policisë, së dyti se prokurori publik ka mbetur pasiv edhe pse ka mundur të marrë përsipër ndjekjen, edhe pse ka qenë i ftuar disa herë që ta bëjë këtë gjatë procedurës në pajtim me aktin e akuzës subsidiare, së treti, duke pasur parasysh praktikën e saj, sipas cilës nga viktimat nuk kërkohet që vetë të marrin përsipër ndjekjen kundër përfaqësuesve të shtetit, së katërti, se një gjë e tillë është detyrë e prokurorit publik, për këtë arsye hetimi gjyqësorë i iniciuar me rastin e padisë penale të aplikuesit, nuk mund të arsyetohet me mosveprimin nga ana e prokurorit publik, më pas, duke pasur parasysh faktin se nuk është vendosur në lidhje me qëndrueshmërinë e kallëzimit penal të iniciuar nga ana e aplikuesit, për arsye se procedura ka qenë e ndaluar në rrethana jo shumë të qarta edhe atë pas katër viteve nga iniciimi i saj, në bazë të deklaratës së aplikuesit për tërheqjen e aktit akuzues, për të cilën Gjykata ka konkluduar se ka qenë e interpretuar në mënyrë jo racionale nga ana e gjykatave vendore, duke i pasur parasysh rrethanat e rastit, në veçanti kërkesa e mëparshme e përsëritur disa herë nga aplikuesi, për marrjen e ndjekjes nga ana e prokurorisë, kërkesa e tij për kthimin e lëndës në procedurë të mëparshme si dhe ankesa e aplikuesit, në të cilën ai gjithashtu ka konstatuar se gjykata gabimisht ka interpretuar deklaratën e tij, të gjitha këto orvatje kanë përfunduar pa sukses, GJEDNJ përfundimisht ka konstatuar se për dallim nga procedura kundër aplikuesit, organet vendore nuk kanë vepruar sipas lëndës së aplikuesit me mbikëqyrje të kujdesshme, gjë që kërkohet nga neni 3 i Konventës. Për shkakun se organet, detyra e të cilëve ka qenë që të sigurojnë hetime efikase dhe zbatim të procedurës përkatëse kundër nëpunësve të policisë, të akuzuar për veprim kundër ligjorë, nuk kanë vepruar në pajtim me obligimet e tyre procedurale që pasojnë nga neni 3 i Konventës, GJEDNJ ka konstatuar shkeljen e Konventës.

- Aspekti material

Aplikuesi gjatë procedurës para GJEDNJ ka konstatuar se ka qenë lëndë e brutalitetit policorë, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Duke e pasur parasysh ndalesën

absolute të torturës, praktika e GJEDNJ sipas cilës, në rastet kur lëndimet e një personi deri sa ka qenë i privuar nga liria ose në ndonjë mënyrë tjetër ka qenë nën kontrollin e policisë, iniciojnë supozime të fuqishme se personi ka qenë i ekspozuar në trajtime të paligjshme, përkatësisht në maltretime, si dhe fakti se në rrethana të tilla, shteti duhet të siguroj sqarime alternative dhe racionale për atë se si janë shkaktuar lëndimet e marra, GJEDNJ ka konstatuar shkeljet e nenit 3 të KEDNJ, për shkak të veprimit jo njerëzor dhe degradues ndaj të cilit ka qenë i ekspozuar aplikuesi gjatë procedurës policore. Konkluzionet e tilla të GJEDNJ, pasojnë nga fakti se, Gjykata ka konstatuar se aplikuesi ka pësuar lëndime të shumta trupore, të cilat nga ana e ekspertëve të pavarur gjatë procedurave vendore kanë qenë të kualifikuara si lëndime të rënda trupore. Më pas, sqarimi i nëpunësve të policisë, i dhënë gjatë procedurave vendore, ka mundur të sqaroj vetëm një pjesë të vogël të lëndimeve që i ka pësuar aplikuesi, duke i vlerësuar konstatimet e nëpunësve të policisë për mundësinë që lëndimet e shumta janë shkaktuar si rezultat i sjelljes së aplikuesit (me vetë lëndim), si të padëshmuara, dhe të pamjaftueshme që ti sqarojnë të gjitha lëndimet e mara, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se lëndimet mund të sqarohen vetëm me përdorimin e fuqisë nga ana e nëpunësve të policisë.

Për lëndimet konstatuara, GJEDNJ i ka përcaktuar aplikuesit shumën prej 15.000 euro si kompensim të dëmit.

Andonoski kundër Republikës së Maqedonisë, 16225/08 (aktgjykimi i datës 17.09. të vitit 2015)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), më datën 17.09.2015 ka miratuar aktgjykimin për rastin *Andonovski kundër RM-së*. Aplikuesi është ankuar se automjeti i tij ka qenë i konfiskuar gjatë procedurës penale, përskaft faktit se ai nuk ka qenë i gjykuar si shkelës për ndonjë vepër penale. GJEDNJ konstatimet e tilla ankuese nga aplikuesi, i ka shqyrtuar për nga aspekti i nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut (KEDNJ) – e drejta e pronësisë dhe për rastin konkret, janë konstatuar shkeljet e tij.

FAKTET NË LIDHJE ME RASTIN

Në fakt, aplikuesi ka qenë taksit vozitës dhe më datën 25 korrik të vitit 2007, gjatë kohës së transportimit të tre nënshtetasve të Shqipërisë (prej të cilëve njëri ka folur rrjedhshëm gjuhën maqedonase, kurse dy pasagjerët tjerë nuk kanë realizuar kurrfarë komunikimi verbal me aplikuesin), deri në një fshat afër kufirit në mes Maqedonisë dhe Greqisë, ai ka qenë i ndaluar nga policia. Meqenëse, nënshtetasit e Shqipërisë nuk kanë poseduar dokumente të udhëtimit, të njëjtit së bashku me aplikuesin janë privuar nga liria. Në njëjtën kohë, automjeti i aplikuesit ka qenë i konfiskuar nga ana e policisë.

Gjykatësi hetues nga Gjykata themelore në Prilep, ka hapur hetimin kundër aplikuesit dhe njërit prej nënshtetasve të Shqipërisë, për shkak të ekzistimit të dyshimit të qëndrueshëm se kanë kryer veprën penale – kontrabandë me imigrantët.

Më datën 8 gusht të vitit 2007, prokurori publik ka pezulluar ndjekjen penale ndaj aplikuesit, për shkak të mungesës së dëshmive se ai ka kryer këtë veprë. Po të njëjtën ditë, gjykatësi hetues ka pezulluar hetimin kundër aplikuesit.

Me vendimin e gjykatës së lartpërmendur, më datën 3 shtator të vitit 2007, njëri prej nënshtetasve të Shqipërisë ka qenë i shpallur si fajtor për kontrabandë me imigrantët. Me po të njëjtin aktgjykim është realizuar konfiskimi i automjetit të udhëtimit të cilin e ka poseduar aplikuesi, si mjet me të cilin është realizuar vepra penale. Aplikuesi ka parashtruar ankesën deri te Gjykata e apelit në Manastir, duke pohuar se vendimi për konfiskimin e automjetit nuk ka qenë i mbështetur në faktet, për arsye se ai nuk ka qenë i shpallur si fajtor gjatë procedurës së njëjtë. Gjykata e apelit ka refuzuar ankesën e parashtruar.

ARSYETIMET E GJEDNJ

Prej praktikës së qartë dhe pozitive të implementuar nga GJEDNJ, pasojnë këto konkludime vijuese:

Së pari, se pengimi i të drejtave pronësore duhet të parashikohet në pajtim me ligjin.

Së dyti, se pengimi duhet të synoj drejtë realizimit të një ose më shumë qëllimeve legjitime. Qëllimet e lejuara legjitime janë të parapara në paragrafin 2 të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ.

Së treti, se duhet të ekzistoj balancimi, përkatësisht baraspesha juridike në mes kërkesës së interesit të përgjithshëm dhe interesave të individit të përfshirë. Gjatë kësaj sipas GJEDNJ, balancimi i nevojshëm nuk do të sigurohet nëse individi i përfshirë ose individët e përfshirë kanë qenë të detyruar që të bartin barë individuale dhe të tepruar.

Duke i pasur parasysh parimet e tilla të përgjithshme, të zhvilluara gjatë praktikës gjyqësore të GJEDNJ, legjislativi vendor i zbatuar në rastin konkret si dhe vendimet gjyqësore të gjykatave vendore, i njëjti krahas lëndës konkrete sajoi këto konkludime vijuese:

Së pari, se konfiskimi i automjetit ka qenë i mbështetur me dispozitat ligjore, përkatësisht me nenin 418 – b të Kodit penal i cili ka qenë në fuqi në atë kohë;

Së dyti, se konfiskimi është realizuar me qëllim, përkatësisht është synuar drejtë qëllimit legjitim – parandalimit të migrimit jo legal dhe tregtisë me njerëzit;

Së treti, se vendimi për konfiskim të automjetit të aplikuesit, ka qenë jo proporcional meqenëse aplikuesit i është imponuar ngarkesa e tepërt, për këtë arsye GJEDNJ ka konstatuar shkelje të KEDNJ, përkatësisht shkeljen e së drejtës së pronësisë së aplikuesit.

GJEDNJ, konstatimin e fundit e ka sajuar duke i pasur parasysh rrethanat vijuese, në mes të cilave edhe sjelljen e aplikuesit:

Së pari, fakti se automjeti ka qenë i konfiskuar në kontekst të procedurës penale kundër personit të tretë, pasi prokurori publik ka pezulluar ndjekjen penale të aplikuesit, kurse hetimi ka qenë i pezulluar dhe gjatë kësaj prokurori ka konstatuar se aplikuesi nuk ka qenë i vetëdijshëm se automjeti i tij ka qenë i shfrytëzuar për transportim ilegal të imigrantëve.

Së dyti, se aplikuesi ka përfitur për ekzistencën jetësore si vozitës i autotaksit; se i njëjti nuk ka poseduar dosje kriminale, se nuk kanë ekzistuar indikacione se automjeti i tij më parë ka qenë i shfrytëzuar për realizim të veprës penale; se nuk kanë ekzistuar kurrfarë arsye për frikën se automjeti do të shfrytëzohet për realizim të veprave tjera penale.

Së treti, se në pajtim me nenin 418-b të Kodit penal, në bazë të cilit është realizuar konfiskimi i automjeti lëndë e ankesës, konfiskimi i automjeteve të cilat janë shfrytëzuar për transportin e imigrantëve është i detyruar, dhe nuk lejon kurrfarë përjashtime, pavarësisht nga fakti se vallë mjetet e transportimit kanë qenë në pronësi të shkatkarëve të veprës ose në pronësi të personave të tretë, dhe pavarësisht nga sjelljet e personave të tretë ose lidhjeve të tij me veprën e shkatkuar. Prej këtu, GJEDNJ ka sjuar konkludimin se konfiskimi i tillë për marrjen me automatizëm që parashikohet me ligjin, e ka privuar aplikuesin nga çdo mundësi për të arritur sukses gjatë procedurës së konfiskimit, dhe për këtë arsye gjykatat vendore, në rrethana të tilla, nuk kanë pasur mundësinë për zgjedhje alternative, dhe nuk kanë qenë në gjendje që ta shqyrtojnë rastin për nga aspekti i asnjërit prej faktorëve të përshkruar më lartë. Si plotësim, GJEDNJ ka marrë parasysh faktin se neni 418 – b i Kodit Penal, në të cilin mbështetet vendimi për konfiskim, nuk parashikon mundësinë që të kërkohet dëmshpërblim ashtu siç parashikohet me nenin 100 – a të Kodit Penal.

Nëse merren parasysh rrethanat e tilla, GJEDNJ ka konstatuar shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak të mungesës së proporcionalitetit të vendimit për konfiskim të automjetit, gjë që aplikuesit i ka imponuar ngarkesë të tepruar.

DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE PËRCAKTIMI I DËMIT

GJEDNJ ka vendosur se shteti duhet ti rikthejë automjetin e konfiskuar aplikuesit, në gjendjen si ka qenë në kohën e konfiskimit, dhe nëse nuk është i mundur restitucioni i tillë, atëherë aplikuesit duhet ti paguaj shumë prej 10.000 euro si dëmshpërblim material. Gjithashtu, GJEDNJ aplikuesit i ka përcaktuar shumë prej 3.000 eurove në emër të dëmit jo material dhe shumë prej 300 eurove për shpenzimet gjyqësore.

***Mitkova kundër Republikës së Maqedonisë*, 48386/09 (aktgjykimi i datës 15.10. viti 2015)**

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) më datën 15.10. të vitit 2015 ka miratuar aktgjykimin për rastin *Mitkova kundër RM-së*. Aplikuesja është ankuar, se gjatë procedurës drejtuese për realizimin e kompensimit të shpenzimeve për shërim në shtetin e huaj, ka munguar seanca publike gjyqësore dhe njëkohësisht procedura e lartpërmendur ka zgjatuar një periudhë të gjatë kohore, në fund duke rezultuar me sjelljen

e vendimit që të paguhet vetëm një pjesë e shpenzimeve për shërimin e saj në shtetin e huaj.

FAKTET NË LIDHJE ME RASTIN

Aplikuesja është e lindur në vitin 1954 dhe jeton në Ohër. Aplikuesja lëngon nga multipleks skleroza.

Përkatësisht, në datën 1 prill të vitit 1994, Ministria e shëndetësisë ka dhënë vërtetimin me të cilin lejohet që banka, në të cilën babai i aplikantes ka poseduar kursime devizore, të realizoj transferimin e shumë prej 20.000 dollarëve amerikane në llogarinë e spitalit në SHBA, me qëllim që të mbulohen shpenzimet e shërimit të aplikueses që është dashur të pasoj. Vërtetimi ka qenë i dhënë në bazë të mendimit konziliarë të Klinikës për sëmundje nervore dhe shpirtërore në Shkup, në të cilin është theksuar se aplikuesja lëngon nga multipleks skleroza dhe për shkak të kësaj ajo duhet të shërohet në shtetin e huaj, për arsye se janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë për shërim në shtetin tonë.

Në mes datës 17 maj dhe 28 qershor të vitit 1994 aplikuesja është shëruar në spitalin N.N.I. në SHBA.

Më 12 korrik të vitit 1994, nga ana e Klinikës për sëmundje nervore dhe shpirtërore në Shkup është dhënë një mendim tjetër konziliarë, në të cilin është theksuar se gjendja e aplikueses ka qenë kritike dhe se ajo është dashur urgjentisht që të largohet për shërim në shtetet e huaja.

PROCEDURA E PARË DREJTUESE

Më datën 29 nëntor të vitit 1994, aplikuesja nga Fondi për sigurim shëndetësorë ka kërkuar që të sjell aktvendim *ex post facto*, për udhëzimin për tu shëruar në shtetin e huaj në spitalin N.N.I. Fondi ka refuzuar kërkesën e aplikueses, duke theksuar se aplikuesja mund të shërohet në Republikën e Maqedonisë. Më pas, aplikuesja e ka ankuar aktvendimin e FSSH pranë Ministrisë për shëndetësi, e cila pas pranimit të mendimit nga Komisioni i shkallës së dytë, për udhëzimin për tu shëruar në shtetin e huaj, e ka refuzuar ankesën. Aplikuesja ka iniciuar kontestin drejtues para Gjykatës supreme. Gjykata supreme e ka anuluar aktvendimin e Ministrisë së shëndetësisë, duke konstatuar se prej tij, qartë nuk ka mundur që të konstatohet se vallë aplikuesja duhet të shërohet në shtetin e huaj dhe se vallë janë të shfrytëzuar të gjitha mundësitë që aplikuesja të shërohet në Republikën e Maqedonisë. Por, Ministria e shëndetësisë edhe pas miratimit të aktgjykimit nga ana e Gjykatës supreme, sërish e ka refuzuar ankesën e aplikueses.

PROCEDURA E DYTË DREJTUESE

Më 7 korrik të vitit 1995, aplikuesja ka parashtuar kërkesë deri te FSSH për kompensim të shpenzimeve për shërim, meqenëse ajo para se të dorëzoi kërkesën ka qenë e trajtuar në spitalin N.N.I. FSSH ka sjell aktvendimin për mbulimin e 20 % të shpenzimeve të përgjithshme, dhe më pas, aktvendimi i njëjtë ka qenë i ndryshuar dhe është vendosur që

të mbulohen edhe 10 % shtesë të shpenzimeve të përgjithshme. Më pas, FSSH, duke vepruar sipas ankesës së aplikueses, më datën 11 nëntor të vitit 1996, ka vendosur që ta zmadhoj kompensimin për shumën plotësuese prej 50,215 denarë. Aplikuesja, sërish e ka iniciuar kontestin e procedurës drejtues para Gjykatës supreme. Më 25 mars të vitit 1998, Gjykata supreme ka anuluar aktvendimin e Ministrisë së shëndetësisë, të miratuar më datën 11 nëntor të vitit 1996. Gjykata supreme ka konstatuar se Fondi dhe Ministria e shëndetësisë nuk kanë konstatuar se vallë aplikuesja ka pasur mundësinë që të shërohet në institucionet shëndetësore të vendit, në pajtim me Rregulloren për kushtet dhe mënyrën e udhëzimit të personave të siguar për tu shëruar në shtetet e huaja.

Më pas, Gjykata supreme, ka konstatuar se këto organe e kanë interpretuar nenin 15 të Rregullores në mënyrën që ka rezultuar me konstatimin se nuk mund të mbulohet kompensimi i shpenzimeve për shërim, nëse personi më parë nuk ka fituar aktvendimin për udhëzimin për tu shëruar në shtete të huaja. Sipas mendimit të gjykatës, interpretimi i tillë ka qenë në kundërshtim me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.

Më datën 6 janar të vitit 1999, Ministria ka miratuar një vendim të ngjashëm dhe identik me vendimin e përfshirë me aktvendimin e miratuar më datën 11 nëntor të vitit 1996.

PROCEDURA TË BASHKUARA

Aplikuesja, sërish ka iniciuar kontestin e procedurës drejtuese para Gjykatës supreme, kundër aktvendimit të miratuar nga Ministria e shëndetësisë më datën 6 janar të vitit 1999.

Më 22 nëntor të vitit 2000, Gjykata supreme i ka anuluar dy aktvendimet, atë të miratuar më 6 janar të vitit 1999 si dhe aktvendimin e miratuar më 9 korrik të vitit 1999. Gjykata supreme ka konstatuar se Ministria është dashur që ti bashkoj procedurat, procedurën në lidhje me kërkesën për kompensim të shpenzimeve për tu shëruar në spitalin N.N.I. me procedurën në lidhje me kërkesën udhëzimin për tu shëruar në shtetet e huaja.

Më pas, Gjykata supreme dy herë me radhë, përkatësisht më 13 nëntor të vitit 2003 dhe më datën 14 dhjetor të vitit 2006 i ka anuluar aktvendimet e miratuara nga ana e Ministrisë për shëndetësi, të cilat janë miratuar më datën 23 shkurt të vitit 2001 dhe më datën 5 nëntor të vitit 2003, me të cilët kërkesa e aplikueses për ndarjen e kompensimit të shpenzimeve për shërim në shtetet e huaja si dhe për udhëzimin për tu shëruar në shtetet e huaja, janë refuzuar, meqenëse, Ministria e shëndetësisë në aktvendimet e miratuara, sipas mendimit të Gjykatës supreme nuk ka konstatuar se vallë gjatë kohës kur aplikuesja ka qenë në shërim, janë shfrytëzuar mundësitë për tu shëruar brenda shtetit dhe se vallë kanë ekzistuar dëshmi kundërthënëse mjekësore në lidhje me atë se vallë aplikuesja ka mundur që të shërohet në institucionet mjekësore brenda shtetit. Njëkohësisht, Gjykata supreme, nga Ministria e shëndetësisë ka kërkuar që ti marrë në pyetje mjekët të cilët e kanë përpiluar mendimin më datën 12 korrik të vitit 1994 që të konstatoj se vallë kanë qenë të shfrytëzuara mundësitë për shërim të sëmundjes konkrete, në suaza të institucioneve shëndetësore brenda shtetit, gjatë vitit 1994.

Pas konsultimeve me mjekët, më datën 8 tetor të vitit 2007, Ministria e shëndetësisë sërish e ka refuzuar ankesën e aplikueses kundër aktvendimit me të cilin aplikueses i është ndarë kompensimi për të mbuluar vetëm një pjesë të shpenzimeve për shërim.

Aplikuesja ka kontestuar aktvendimin e miratuar nga Ministria e shëndetësisë, duke kërkuar që në pajtim me Ligjin për kontestet drejtuese, Gjykata supreme të përcaktoj seancë publike gjyqësore me qëllim të sajimit të dëshmimeve duke i marrë në pyetje mjekët që kanë dhënë mendimin konziliarë gjatë vitit 1994, Kryetarin e komisionit të shkallës së dytë të Ministrisë së shëndetësisë dhe dr. R.L. – mjekun i cili e ka mjekuar aplikuesen.

Më datën 22 janar të vitit 2009, Gjykata drejtuese e cila në ndërkohë bëhet kompetente që të vendos për kontestet drejtuese, në seancë të mbyllur ka vendosur që të refuzoj ankesën e aplikueses. Në vendimin e saj, Gjykata drejtuese nuk e ka përfillur kërkesën për mbajtjen e seancës publike gjyqësore. Gjykata drejtuese është thirrur në nenin 10 § 1 dhe në nenin 30 të Ligjit për sigurim shëndetësorë të miratuar gjatë vitit 2000, si dhe në nenin 20 të Rregullores për mënyrën e shfrytëzimit të shërbimeve mjekësore në shtetet e huaja, nga personat e siguruar për nga aspekti shëndetësorë. Gjykata drejtuese ka vendosur se organet drejtuese në mënyrë të rregullt e kanë zbatuar ligjin kur aplikueses pjesërisht ia kanë pranuar shpenzimet për shërim në spitalin N.N.I. gjatë vitit 1994.

ARSYETIMI I DHËNË NGA GJEDNJ

Ashtu siç është theksuar më lartë, aplikuesja është ankuar, se gjatë procedurës drejtuese për ndarjen e kompensimit për shpenzimet e realizuara për shërim në shtetet e huaja, ka munguar debati publik gjyqësorë, në të njëjtën kohë procedura gjyqësore ka zgjatur një kohë të gjatë dhe në fund të procedurës gjyqësore është vendosur që të mbulohet vetëm një pjesë e shpenzimeve për shërimin e saj në shtetin e huaj.

Për sa i përket kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut ka konstatuar se procedura drejtuese ka qenë e iniciuar nga ana e aplikueses më datën 29 nëntor të vitit 1994, përkatësisht GJEDNJ ka pranuar datën 21 mars të vitit 1995 si datë e fillimit të afatit të procedurës drejtuese, për arsye se në këtë datë aplikuesja ka parashtruar kërkesën kundër vendimit të shkallës së parë. Përfundimisht procedura ka përfunduar më datën 6 mars të vitit 2009, përkatësisht ajo ka zgjatur trembëdhjetë vite. GJEDNJ gjithashtu ka marrë parasysh edhe pranimin e këtij fakti nga ana e Qeverisë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, me ç'rast ka konstatuar se ekzistojnë shkeljet e nenit 6 § 1 të Konventës.

Aplikuesja gjithashtu është ankuar edhe për mungesën e debatit publik gjyqësorë gjatë procedurës drejtuese për përcaktimin e kompensimit për shpenzimet e realizuara gjatë shërimit në shtetin e huaj, edhe përkaj faktit se ajo ka insistuar për mbajtjen e seancës publike gjyqësore, me qëllim që gjykata të mund ti marrë në pyetje edhe dëshmitarët. Në lidhje me lartpërmendurën, qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut është se gjatë procedurave para një instance të vetme gjyqësore, e drejta për “debat publik gjyqësorë” që pason nga neni 6 § 1 e përfshin edhe të drejtën e “debatit publik gjyqësorë” me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat do të

arsyetonin mungesën e një debati të tillë. GJEDNJ nuk ka qenë e bindur për ekzistimin e çfarëdo prej rrethanave të jashtëzakonshme të cilat do të arsyetonin mungesën e zbatimit të debatit publik gjyqësorë dhe të njëjtën kohë ka konstatuar se Gjykata drejtuese nuk ka ofruar arsytetime për shkaqet e mos mbajtjes së debatit publik gjyqësorë, për shkak të saj, Gjykata konstaton ekzistimin e shkeljes së nenit 6 § 1 të Konventës.

Në fund, aplikuesja është ankuar se vendimi i organeve vendore, në lidhje me kompensimin e pjesshëm të shpenzimeve për shërim, duke u thirrur në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, i cili mbron të drejtën e pronësisë. Sipas GJEDNJ, pronësia mund të jetë ose ekzistuese ose në trajtë të pronës, duke i përfshirë edhe kërkesat pronësore, në lidhje me të cilën aplikuesja ka pohuar se së paku posedon prirje legjitime që të përfitoj posedimin efektiv të së drejtës së pronësisë, por GJEDNJ thekson faktin se po i njëjti nen nuk e garanton të drejtën e përfitimit të pronësisë. GJEDNJ ka vërejtur se aplikuesja ka parashtruar kërkesën për udhëzimin për tu shëruar në shtetin e huaj, pas shërimit në shtetin e huaj, pasi që është rikthyer në vend. Gjykata drejtuese e ka refuzuar kërkesën e saj për arsye se aplikuesja ka vepruar në kundërshtim me nenin 30 të Ligjit për sigurim shëndetësorë të miratuar gjatë vitit 2000, duke theksuar argumentimet se aplikuesja ka pasur mundësinë që të shërohet në institucionet shëndetësore të vendit. GJEDNJ, duke shfrytëzuar të drejtën e mbikëqyrjes në lidhje me interpretimin e legjislativit vendor nga ana e gjykatave vendore, ka sajuar konstatimin se në lidhje me rastin konkret nuk ekzistojnë shkaqe për dyshime në lidhje me interpretimin e ligjeve nga ana e Gjykatës drejtuese, për këtë arsye ka konstatuar se nuk mund të bëhet fjalë për prirje legjitime që aplikuesja të përfitoj të drejtën e gëzimit efektiv të të drejtave të pronësisë. Për këtë arsye, sipas GJEDNJ kjo pjesë e aplikimit ka qenë e pa bazuar në mënyrë evidente. 64

DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE PËRCAKTIMI I DËMIT

GJEDNJ, ka vendosur se shteti aplikueses duhet ti paguaj shumën prej 5.000 euro si dëmshpërblim jo material dhe shumën prej 850 euro për shpenzimet gjyqësore.

***Hajrullahu kundër Republikës së Maqedonisë*, 37537/07 (aktgjykimi i datës 29.10. të vitit 2015)**

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) më datën 29.10. të vitit 2015 ka sjell aktgjykimin në lidhje me rastin *Hajrullahu kundër RM-së*. Aplikuesi është ankuar se ka qenë i mbajtur në izolim dhe se ka qenë i torturuar nga ana e shërbimeve policore, dhe se nuk është zhvilluar hetimi efektiv për pohimet e veta lidhur me maltretimet e ushtruara, si dhe se gjykimi i tij ka qenë i pabazuar me pranimin e fituar në mënyrë të dhunshme. GJEDNJ, pohimet e tilla ankuese nga ana e aplikuesit i shqyrtoi për nga aspekti i neneve 3 dhe 6 § 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) – ndalesa e torturës dhe e drejta e procedurës së drejtë gjyqësore.

FAKTET NË LIDHJE ME RASTIN

Gjatë procedurës penale, ankuesi ka prezantuar tre versione të ndryshme të ngjarjeve, përkatësisht më datën 16 gusht të vitit 2005, në ora 00:30 ankuesi Ferdi Hajrullahu i cili ka lindur në vitin 1985 dhe jeton në Gjermani, ka qenë i arrestuar në afërsi të qendrës tregtare në një vendbanim të qytetit të Shkupit nga ana e dy nëpunësve të policisë për shkak të mos posedimit të dokumenteve për identifikim dhe për shkak të lëvizjes së dyshimtë në afërsi të objekteve, sjellje që kanë për qëllim të ushtrimit të veprës penale. Në datën e lartpërmendur, gjykatësi hetues nga Gjykata themelore Shkup 1, ka dhënë urdhër për bastisje në shtëpinë dhe në pronën tjetër e cila ka qenë në pronësi të babait të ankuesit dhe në pronësi të babait të F.R. bashkë i akuzuari gjatë procedurës penale, e cila është zhvilluar për shkak të terrorizmit dhe kontrabandës me armë. Bastisja është realizuar në prani të babait të ankuesit i cili më vonë është nënshkruar në vërtetimin e sendeve të konfiskuara dhe nga dy fqinjët në veti të dëshmitarëve të cilët nuk kanë dhënë vërejtje për punën e shërbimeve policore. Në shtëpinë e ankuesit janë gjetur armë, një pushkë, proektile dhe harta e Shqipërisë së Madhe. Pas bastisjes, babai i ankuesit ka qenë i dërguar në stacionin policor për bisedë informative.

Më datën 16 gusht të vitit 2005, ankuesi ka qenë i dërguar para gjykatësit hetues nën dyshimin se ka qenë i përfshirë në incidentin e datës 15 korrik të vitit 2005, kur në oborrin e stacionit të policisë në Shkup, ka eksploduar një minë kundër tankiste me ç'rast e njëjta ka shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. Sipas procesverbalit gjyqësorë, ai ka deklaruar se do të dëshmoj pa praninë e mbrojtjes, dhe njëherit ka pranuar se e ka kryer veprën dhe ka deklaruar se mjetin eksplodues e ka furnizuar nga personi R.S. kurse gjatë kohës së kryerjes së veprës me të ka qenë edhe personi F.R. Më pas, gjykatësi hetues ka hapur hetimet kundër R.S. dhe F.R. dhe ka përcaktuar avokatin D.N. me qëllim që ta përfaqësoj ankuesin.

Më datën 19 gusht të vitit 2005, ankuesi ka kërkuar që të jap deklaratë para gjykatësit hetues. Po të njëjtën ditë, ankuesi në praninë e prokurorit publike dhe në prani të avokatit të tij, ka dhënë deklaratë me gojë para gjykatësit hetues. Në deklaratën, ankuesi ka theksuar se më datën 16 gusht të vitit 2005, ka qenë i rrahur dhe i detyruar ta jap deklaratën e lartpërmendur duke theksuar se i mohon të gjitha deklaratat e dhëna nga ana e tij më parë. Më pas, gjykatësi hetues, është bindur për ekzistimin e lëndimeve që i ka pasur ankuesi dhe po të njëjtën ditë ka urdhëruar që të realizohet ekspertizë mjekësore mbi të njëjtin. Dy ekspert nga Instituti i mjekësisë ligjore e kanë kontrolluar ankuesin dhe kanë konstatuar të mavijosura nëpër trupin e ankuesit, të cilat sipas mendimit të tyre janë shkaktuar së paku para shtatë ditëve para kontrollimit të realizuar nga ana e tyre, dhe kjo ka nënkuptuar se lëndimet atij i janë shkaktuar para datës 16 gusht të vitit 2005.

Më datën 9 shtator të vitit 2005, prokurori publik ka parashtruar aktpadinë kundër ankuesit dhe kundër F.R. për veprën penale – terrorizëm. Më 26 shtator të vitit 2005 është parashtruar aktakuza edhe kundër R.S.

Në seancën gjyqësore të mbajtur më datën 8 nëntor të vitit 2005, ankuesi ka deklaruar se i konteston akuzat e përshkruara në aktin e akuzës, mes tjerave sërish i ka zëvendësuar deklaratat e mëparshme të dhëna nga ana e tij dhe e ka njoftuar gjykatësin se në datën 12 gusht të vitit 2005 ai ka qenë i kidnapuar, i rrahur dhe i ekspozuar ndaj torturave të ushtruara nga ana e nëpunësve të forcave speciale në një shtëpi në Veles, me qëllim që të pranoj para gjykatësit hetues se i njeh personat F.R. dhe R.S. dhe të pranoj se e ka kryer veprën penale prej datës 15 gusht deri në natën e datës 16 gusht. Ankuesi ka emëruar katër persona që të dëshmojnë se në datën e shfaqjes së incidentit kanë qenë së bashku me të dhe të njëjtit kanë ofruar prova me gojë para gjykatës gjyqësore.

Në datën 17 janar të vitit 2006, Gjykata themelore Shkup 1 e ka gjykuar ankuesin, F.R. dhe R.S. me ç'rast atyre u ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë, dhjetë dhe dymbëdhjetë viteve, në mënyrë përkatëse. Ankuesi ka qenë i shpallur si fajtor për terrorizëm dhe kontrabandë me armë.

Ankuesi është ankuar deri te instancat më të larta gjyqësore në lidhje me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, por të njëjtit e kanë konfirmuar qëndrimin e miratuar nga Gjykata themelore Shkup 1.

Më datën 7 mars të vitit 2007, ankuesi ka parashtruar kallëzim penal deri te Prokuroria publike, në të cilën ai ka pohuar se ka qenë lëndë e brutalitetit policorë. Duke e marrë parasysh faktin se organet kompetente nuk ka vepruar në lidhje me kallëzimin e iniciuar nga ana e tij, më datën 25 maj të vitit 2010 ankuesi sërish i është drejtuar Prokurorisë publike me kërkesën që të ndërmerren masa me qëllim që personat përgjegjës të dënohen, por nuk ka pranuar përgjigje nga ana e prokurorit publik.

ARSYETIMET E DHËNA NGA GJEDNJ

Ashtu siç është theksuar më lartë, aplikuesi është ankuar se ka qenë i mbajtur në izolim dhe se ka qenë i torturuar nga ana e shërbimeve policore, dhe se nuk është realizuar hetimi efektiv për pohimet e dhëna nga ai që kanë të bëjnë me maltretime, dhe se gjykimi i tij ka qenë i mbështetur nga pranimi i veprës i marrë me dhunë.

Në lidhje me pohimet serioze për maltretime të dhëna nga aplikuesi se torturat janë realizuar nga ana e shërbimeve policore ose nga ana e agjentëve të ngjashëm shtetërorë, parimet e përgjithshme të zhvilluara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, theksojnë për obligimin e shtetit që të zbatoj hetime të shpejta, efektive dhe zyrtare për identifikim dhe dënim të shkaktuesve të veprës së lartpërmendur penal, e cila si e tillë është pranuar nga ana e kodit penal të Maqedonisë.

Në të njëjtën kohë, gjykata përkujton në lidhje me nenin 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, i cila prej çdo shteti nënshkrues të Konventës, kërkon obligimin për respektim të drejtave të njeriut. Më pas, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, kur bëhet fjalë për nenet 2 dhe 3 të Konventës, përkatësisht për drejtën e jetës dhe ndalesës së torturës, kur ngjarjet e shqyrtuara u janë të njohura vetëm organeve të pushtetit, siç është rasti me personat që janë nën kontrollin e tyre në kushte të paraburgimit, në raste të tilla, përgjegjësia për sigurimin e dëshmisë bie mbi organet të cilat duhet të ofrojnë

arsyetime bindëse dhe të kënaqshme. Gjykata përkujton se roli i saj nuk është që të sjell vendim për fajësinë penale ose për përgjegjësinë civile, por për përgjegjësinë e shteteve nënshkruese të Konventës, përkatësisht çështja më esenciale që duhet të shqyrtohet sipas mendimit dhe qëndrimit të GJEDNJ është çështja se vallë shtetet nënshkruese të Konventës veprojnë në pajtim me përcaktimet e Konventës. GJEDNJ nga argumentet e dorëzuara nga palët e përfshira, ka vërejtur se shteti nuk ka ofruar sqarime bindëse dhe të kënaqshme në lidhje me prejardhjen e lëndimeve të ankuesit dhe për vërtetësinë e rrethanave në të cilat janë shkaktuar të njëjtit, si dhe mos veprimi i prokurorit publik i cili ka qenë i pranishëm në datën 19 gusht të vitit 2005, në kohën kur ankuesi e ka njoftuar gjykatësin për ndodhitë e periudhës së izolimit, prej datës 12 deri në datën 16 gusht, ai nuk është orvatur që ti dëgjoj dëshmitë dhe nuk ka iniciuar nisjen e hetimit. Si plotësim të kësaj është edhe fakti i mos veprimit të organeve kompetente nga prokuroria publike sipas kallëzimit penal të iniciuar nga ankuesi për maltretime, i parashtuar gjatë vitit 2007.

Më pas, ankuesi ka theksuar se deklarata e dhënë më 16 gusht të vitit 2005, me të cilët ka pranuar se ai e ka vendosur mjetin shpërthyes në oborrin e stacionit të policisë në Bit Pazar, ka qenë e paligjshme meqenëse ajo është dhënë nën presion në rrethana të frikës serioze dhe në rrethana të kërcënimeve mbi jetën e tij dhe mbi jetën e prindërve të tij, dhe saktë kjo deklaratë është marrë si provë gjatë procedurës penale kundër tij dhe për këtë arsye e gjithë procedura ka qenë e padrejtë. Gjykata e përsërit qëndrimin se çdo dëshmi dhe provë e fituar përmes torturës, nuk mund të shfrytëzohet në procedurën penale. Gjithashtu, këtë e ndalon edhe neni 15 i Konventës së Kombeve të bashkuara, kundër torturës dhe dënimit si dhe veprimit tjetër të dhunshëm, jonjerëzorë ose nënçmues. Nga ana e Gjykatës është konstatuar se deklarata e dhënë nga ana e aplikuesit, më datën 16 gusht të vitit 2005 ka qenë e shfrytëzuar si dëshmi në procedurën penale kundër tij, dhe për këtë arsye Gjykata konsideron se procedura ka qenë e padrejtë.

Duke i marrë parasysh rrethanat e tilla, GJEDNJ ka konstatuar shkeljet e nenit 3 dhe 6 të Konventës, për shkak të lëshimeve nga ana e autoriteteve, që ti hulumtojnë pohimet e ankuesit lidhur me maltretimet nga ana e policisë dhe për shfrytëzimin e deklaratës së ankuesit, të dhënë më datën 16 gusht të vitit 2005 në procedurën penale kundër tij.

DËMSPËRBLIMI JURIDIK OSE PËRCAKTIMI I DËMIT

GJEDNJ ka vendosur se shteti duhet ti paguaj aplikuesit shumën prej 7.000 euro si dëmshpërblim për dëmet e natyrës jo materiale dhe shumën prej 1.010 euro për shpenzimet gjyqësore.

Asllani kundër Republikës së Maqedonisë, 24058/13 (aktgjykimi i datës 10.12. viti 2015)

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) më datën 10.12. të vitit 2015 solli aktgjykimin për rastin *Asllani kundër RM-së*. Aplikuesi është ankuar se ka qenë i torturuar

nga shërbimet policore dhe se hetimet që kanë pasuar në lidhje me konstatimet e tij për brutalitetin policorë kanë qenë jo efektive.

FAKTET NË LIDHJE ME RASTIN

Aplikuesi ka lindur në vitin 1962 dhe jeton në qytetin e Ohrit.

Në fakt, aplikuesi ka qenë i punësuar në furrën e cila është në pronësi të personit Z.C. Më datën 20 mars të vitit 2008 disa polic kanë arritur në hapësirat e furrës me qëllim të konstatimit se vallë të gjithë të punësuarit posedojnë lejet e punës dhe të qëndrimit. Pasi që aplikuesi ka qenë i ftuar nga ana e pronarit të furrës, ai dhe pronari i furrës janë dërguar në stacionin policor dhe me të njëjtit është zhvilluar bisedë në zyrën e M.G. i cili ka qenë komandat kryesor i policisë në Resnjë. Aplikuesi ka pohuar se e ka braktisur stacionin policor rreth orës 04:15 të datës 21 mars të vitit 2008, dhe se atje ka qenë i sulmuar fizikisht dhe se atë e ka ofenduar polici Gj.S. Të njëjtën gjë e ka pohuar edhe Z.C. kur është kthyer në hapësirat e furrës, përkatësisht se aplikuesi ka qenë fizikisht i sulmuar dhe i ofenduar nga ana e punonjësit të policisë Gj.S. Aplikuesi menjëherë pas braktisjes së hapësirave të stacionit policor, ka vizituar mjekun dhe ka siguruar vërtetimin mjekësor, me ç'rast atij i janë konstatuar lëndimet në pjesën e hundës. Përkatësisht, në vërtetimin mjekësorë të dhënë nga mjeku L.D.B., nga spitali i Ohrit, është theksuar se personit i janë bërë incizime të rëntgenit në piramidën nazale të aplikuesit dhe se është kryer rivendosja dhe imobilizimi i kësaj pjese. Aplikuesi pas kësaj ngjarjeje, në dy data të ndryshme ka qenë i kontrolluar nga mjekët e spitalit të Ohrit dhe të Shkupit, gjatë kësaj atij i është përcaktuar terapia dhe i janë diagnostifikuar të mavijosje në pjesën e fytyrës dhe i është konstatuar fraktura e hundës.

Në datën e pa caktuar në mes 21 dhe 27 marsit të vitit 2008, aplikuesi ka parashtruar kallëzim penal deri te prokurori publik për shkak të maltremit nga ana e policisë. Më pas, në datën 27 mars të vitit 2008 aplikuesi dhe Z.C. janë ankuar deri te Sektori për kontrollime të brendshme dhe për standarde profesionale pranë Ministrisë së punëve të brendshme (SKMSP) se kanë qenë të torturuar nga policët gjatë kohës së shfaqjes së incidentit në mes datës 20 dhe 21 mars të vitit 2008. Më datën 17 qershor të vitit 2008, Sektori për kontrollime të brendshme dhe për standarde profesionale pranë Ministrisë së punëve të brendshme (SKMSP) ka dorëzuar "raport të posaçëm" për lëndën përkatëse deri te prokurori publik dhe i njëjti ka përfshirë vërejtje zyrtare për bisedat e zhvilluara me Gj.S. dhe me nëpunësit tjerë të policisë si dhe materiale tjera të dorëzuara nga personat Z.C. dhe aplikuesi.

Procedura penale kundër Gj.S.

Në kërkesë të prokurorit publik, më datën 12 qershor të vitit 2008, më datën 30 tetor të vitit 2008. Gjykatësi hetues në Gjykatën themelore në Resnjë ka iniciuar hetime në lidhje me pohimet se personi Gj.S. i ka torturuar, iu është kërcënuar dhe i ka ofenduar Z.C. dhe aplikuesin. Në Gjykatën themelore në Resnjë, janë marrë në pyetje dëshmitarët, përkatësisht punëtorët tjerë në furrën si dhe nëpunësit e policisë të cilët kanë qenë të pranishëm në hapësirat e furrës, më pas në kërkesë të gjykatës është përpiluar mendimi i

forenzikës mjekësore dhe se atje janë konstatuar lëndimet e mara të aplikuesit, por për shkak të mungesës së dëshmimeve se Gj.S. e ka shkaktuar veprën e lartpërmendur penale më datën 24 shkurt të vitit 2009, prokurori publik e ka njoftuar gjykatësin hetues se anulon ndjekjen. Më pas aplikuesi ka qenë i këshilluar që të vazhdoj ndjekjen penale në veti të paditësit subsidiarë. Aplikuesi e ka shfrytëzuar të drejtën e lartpërmendur dhe më 13 prill të vitit 2009, ka parashtruar aktakuzën subsidiare kundër Gj.S. por procedura ka qenë e ndaluar nga ana e Gjykatës themelore në Resnjë pas parashtrësës së dorëzuar nga Gj.S. Gjykata e apelit në Manastir e ka anuluar aktvendimin për pezullim të procedurës dhe i ka urdhëruar Gjykatës themelore në Resnjë që të realizon ballafaqimin në mes aplikuesit dhe nëpunësit tjerë të policisë, të cilët kanë qenë të pranishëm në hapësirat e furrës dhe në stacionin policorë, kur aplikuesi ka qenë në bisedime, dhe ti hetoj pohimet të cilat janë shprehur në ndërkohë, përkatësisht se aplikuesi ka pësuar lëndime të caktuara gjatë një fatkeqësie të komunikacionit që ka ndodhur para incidentit të datës 21 mars të vitit 2008. Gjykata themelore në Resnjë e ka realizuar ballafaqimin dhe i ka hetuar pohimet në lidhje me fatkeqësinë e komunikacionit që ka pësuar aplikuesi, por më pas të gjithë gjykatësit e Gjykatës themelore në Resnjë kanë kërkuar përjashtimin e tyre nga shqyrtimi i lëndës, meqenëse ata tani më kanë qenë të përfshirë në procedurën e lartpërmendur, në veti të ndryshme. Më datën 1 qershor të vitit 2010, Gjykata e apelit në Manastir ia ka caktuar lëndën Gjykatës themelore në Manastir. Më pas, tre herë me radhë Gjykata themelore e Manastirit e ka liruar nga akuzat personin Gj.S., për shkak të mungesës së provave, por Gjykata e apelit në Manastir i ka pranuar ankesat e dhëna nga aplikuesi dhe e ka rikthyer lëndën në gjykim të sërishëm, për shkak të bindjes se Gjykata themelore në Manastir, në mënyrë të parregullt dhe të paplotë e ka përcaktuar gjendjen faktike në lidhje me lëndimet e marra të aplikuesit.

Më datën 18 mars të vitit 2015, Gjykata themelore në Manastir e ka liruar personin Gj.S. nga akuzat për maltretime dhe e ka refuzuar akuzën për lëndime trupore, kurse në lidhje me bazën e dytë, gjykata ka konstatuar shfaqjen vjetërsisë e saj. Më pas, Gjykata e apelit në Manastir e ka fuqizuar ankesën e aplikuesit dhe e ka rikthyer lëndën në Gjykatën themelore në Manastir, për arsye se gjykata nuk i ka përfillur udhëzimet e dhëna nga Gjykata e apelit.

Në aktgjykimin e datës 12 nëntor të vitit 2013, Gjykata supreme e ka pranuar kërkesën e aplikuesit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afate racionale dhe të arsyeshme dhe ka pranuar faktin se procedura penale kundër personit Gj.S. ka qenë tejet e gjatë, dhe për këtë arsye ka miratuar gjykimin që aplikuesi ti paguhet kompensimi në shumën prej 500 euro dhe ka përcaktuar që Gjykata themelore e Manastirit ta përfundoj procedurën penale sa më shpejtë të jetë e mundur, por jo më vonë se gjashtë muaj pas pranimit të aktgjykimit.

ARSYETIMET E DHËNA NGA GJEDNJ

Ashtu siç është theksuar më lartë, aplikuesi është ankuar se ka qenë i torturuar nga ana e policisë dhe se hetimet që kanë pasuar pas pohimeve nga ana e tij për brutalitetin policorë, kanë qenë jo efektive.

Në lidhje me pohimet e aplikuesit për hetimet jo efektive, të cilat janë zhvilluar nga ana e gjykatave vendore, në lidhje me pohimet e dhëna nga ai për brutalitetin policor, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkujton se praktika e përcaktuar në nenin 2 dhe 3 të Konventës, përkatësisht nenet të cilët e garantojnë të drejtën e jetës dhe të cilat e ndalojnë torturën, dhe se në rastet kur për ndonjë rast të caktuar ekzistojnë njohuri ekskluzive të cilat i posedon pushteti, si në rastet e personave të arrestuar që janë nën kontrollin e tyre, do të shfaqen supozime të fuqishme për faktin e lëndimeve ose vdekjes së manifestuar gjatë privimit nga liria. Në lëndët e tilla, mund të konsiderohet se përgjegjësia e ofrimit të dëshmimeve bie mbi autoritetet, të cilët duhet të siguroj sqarime të kënaqshme dhe bindëse. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastet kur individi në gjendje të mirë shëndetësore është i privuar nga liria nga ana e policisë dhe pas lirimimit të tij është konstatuar se ai ka qenë i lënduar, shteti është i detyruar që të siguroj sqarime bindëse se si janë shkaktuar ato lëndime, dhe në mungesë të sqarimeve të tilla, shfaqet dilema e qartë në pajtim me nenin 3 të Konventës.

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, është e bindur se ekzistojnë dëshmi në favor të versionit që ka ofruar aplikuesi, përkatësisht kallëzimi penal i aplikuesit dhe dëshmitë mjekësore të cilat kanë qenë në diskutim në kohën e ngjarjeve, kanë qenë argumente të mjaftueshme për pohimet e dhëna nga aplikuesi, se ai ka qenë i torturuar nga ana e punonjësit të policisë dhe për këtë arsye, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përgjegjësia e sigurimit të dëshmisë duhet ti bartet shtetit. Megjithatë, shteti sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk ka siguruar sqarime të kënaqshme dhe bindëse për prejardhjen e lëndimeve të cilat i ka marrë aplikuesi, që janë theksuar në dokumentet mjekësore si dhe rrethanat reale se si ata janë shkaktuar.

Njëkohësisht, aplikuesi ka pohuar se ka qenë i nënshtruar ndaj brutalitetit policor. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka konstatuar se aplikuesi ka pësuar frakturë të hundës dhe të mavijosura në fytyrë për shkak të shfrytëzimit të "forcës brutale" mbi fytyrën e tij. Këto lëndime kanë qenë të përshkuara në dokumentet mjekësore, të cilat janë parashtruar si dëshmi gjatë gjykimit dhe kanë prezantuar dëshmitë për ekzistimin e lëndimeve trupore. Në mungesë të çfarëdo lloji të arsytimit të këtyre lëndimeve, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konsideron se veprimi ndaj të cilit ka qenë i nënshtruar aplikuesi, atij i është shkaktuar dhembje fizike, frikë, shqetësim të madh dhe vuajtje shpirtërore.

Për shkaqet e lartpërmendura, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka vendosur se ekzistojnë shkelje të nenit 3 të Konventës, për shkak të lëshimit të autoriteteve që të realizojnë hetime efektive në lidhje me pohimet e dhëna nga ana e aplikuesit për brutalitetin policor. Mes tjerave, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës për shkak të veprimit nënçmues dhe jo njerëzorë nga ana e policisë, gjatë kohës së marrjes në pyetje të aplikantit në stacionin policorë në Resnjë, më datën 21 mars të vitit 2008.

DËMSHPËRBLIMI JURIDIK OSE PËRCAKTIMI I DËMIT

GJEDNJ ka vendosur që shteti duhet ti paguaj dëmshpërblimin aplikuesit në shumën prej 11.700 euro, për dëmet e natyrës jo materiale.